

Eneida Pema

Irida Hoti

Libër për mësuesin

GJUHA SHQIPE

12

BOTIME



BOTIME



Korrektor letrar: Arlon LIKO
Paraqitja grafike: Elvis BEJTJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë

© Botime Pegi, Qershor 2018

Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Spektori i shpërndarjes: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Mësues të dashur!

'Libër për mësuesin- Gjuha shqipe 12', ju vjen në ndihmë në punën tuaj të përditshme me anë të planifikimeve dhe modelimeve të orëve mësimore që ofron. Udhëzimet e tij mbështeten në programin e IZHA-s, miratuar nga MAS-i. Libri i mësuesit, ashtu, si edhe vetë teksti mësimor, janë hartuar në frymën e të nxënit me kompetenca. Ju do t'i orientoni nxënësit tuaj drejt krijimit të kompetencave, drejt punës kërkimore, gjetjes dhe zgjidhjeve të situatave.

Ky libër mësuesi vjen me mësimet të modeluara sipas nismës '3 në 6', ku autoret kanë bashkërenduar temat dyorëshe përgjithësisht brenda së njëjtës rubrikë: *'Morfologji-Morfologji'*, *'Të lexuarit- Të lexuarit'*, *'Drejtshkrim-Drejtshkrim'* etj., por edhe në variantin e integritit brendalëndor: *'Morfologji-Sintaksë'*, *'Të folurit-Morfologji'*, *'Morfologji- Të shkruarit'*, *'Të folurit- Të dëgjuarit'* etj.

Libri shoqërohet me teknika të larmishme mësimore, të cilat zbërthejnë pjesën teorike të tekstit mësimor, materiale ndihmëse për mësuesit si edhe me teste për çdo tremujor.

Mësimet e rubrikës *'Gramatikë: Morfologji, Sintaksë, Leksikologji dhe Drejtshkrim'* dhe testet për çdo tremujor janë përgatitur nga Dr. Irida Hoti, ndërsa mësimet e rubrikave: *Të folurit, Të dëgjuarit, Të lexuarit, Të shkruarit*, janë përgatitur nga Msc. Eneida Pema.

Përveç udhëzimeve që të ofron dhe të detyron programi mësimor, në këtë libër sugjerohen planifikimet vjetore, 3- mujore dhe ditore. Ju mund t'u përmbaheni atyre planifikimeve, por jeni të lirë të bëni planifikimet tuaja, në përputhje me kërkesat e programit dhe nivelin e nxënësve tuaj.

Mirëpresim çdo këshillë e mendim nga Ju.

Punë të mbarë!

PËRMBAJTJE

Programi lëndor	5
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:	6
Testojmë njohuritë gramatikore nga klasa XI	28
Planifikimi i oreve mesimore, tremujori I	31
Testojmë njohuritë gramatikore tremujori I	76
Planifikimi i oreve mesimore, tremujori II	79
Testojmë njohuritë gramatikore tremujori II	114
Planifikimi i oreve mesimore, tremujori III	116
Testojmë njohuritë gramatikore tremujori III	131

Programi lëndor

Lënda e gjuhës shqipe bën pjesë në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Në arsimin e mesëm të lartë, kjo fushë përbëhet nga lëndët: Gjuhë shqipe, Letërsi, Gjuhë e huaj e parë dhe Gjuhë e huaj e dytë. Të gjitha lëndët e kësaj fushe synojnë zhvillimin gjuhësor e letrar që është boshti themelor për rritjen intelektuale, shoqërore, estetike dhe emocionale të nxënësve. Më konkretisht, fusha “Gjuhët dhe komunikimi” i aftëson nxënësit që ta përdorin gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interesat e tyre personale, për kënaqësi estetike, për të marrë informacion, si dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të vendit të punës. Lënda e gjuhës shqipe ka një rëndësi të veçantë në kurrikulën e arsimit të mesëm të lartë.

Nëpërmjet kësaj lënde, nxënësit:

- fitojnë njohuri dhe demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime rreth sistemit gjuhësor të shqipes;
- fitojnë njohuri dhe demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime për të komunikuar në mënyrën e duhur (të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit).

Lënda e gjuhës shqipe, gjithashtu, siguron mundësi që nxënësit të ndiejnë fuqinë e gjuhës si një mënyrë për të shprehur përvojat e tyre dhe për të shmangur vështirësitë që ndajnë individët. Nxënësit, gjatë zhvillimit të kësaj lënde, ndërtojnë dhe zhvillojnë kompetencat gjuhësore, në mënyrë që të bëhen anëtarë kritikë dhe aktivë në shoqëri. Duke u mbështetur në studimin e teksteve të llojeve dhe tematikave të ndryshme, programi nxit vlerësimin e trashëgimisë së pasur kulturore dhe letrare. Nëpërmjet këtyre teksteve, nxënësit dallojnë dhe vlerësojnë jo vetëm strukturën dhe karakteristikat e vetë teksteve, por edhe mesazhet dhe kuptimet e tyre.

Gjuha shqipe, si çdo lëndë tjetër, mundëson zotërimin e kompetencave kyçe, të përcaktuara në kornizën kurrikulare. Këto kompetenca janë të domosdoshme për një individ, i cili duhet të përmbushë me sukses kërkesat personale, shoqërore dhe profesionale. Këtë “mision” lënda e realizon nëpërmjet ndërtimit dhe zhvillimit të kompetencave të saj. Duke u bazuar në synimet dhe specifikat e lëndës, pesë kompetencat e saj janë:

- Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar.
- Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme.
- Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.
- Të lexuarit e teksteve të ndryshme
- Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit.

Puna për ndërtimin e kompetencave kyçe dhe të kompetencave lëndore ka nisur që në arsimin bazë. Në këtë cikël arsimi, nxënësit janë pajisur me njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e domosdoshme për jetën dhe për tregun e punës. Mirëpo kompetenca zhvillohet dhe përsoset gjatë gjithë jetës dhe nuk ka pikëmbërritje. Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit përballen me sfida të reja. P.sh., nga kontekste familjare dhe informale (me shokët e shoqet e klasës dhe me mësuesit), nxënësit tani do të flasin e do të diskutojnë në kontekste më formale (në një debat në shkollë, në aktivitete me mësues, në veprimtari të ndryshme) dhe do të ushtrohen edhe për të folurit në publik.

Programi i gjuhës shqipe bazohet në parimin e integritetit të njohurive dhe në parimin e rimarrjes së tyre, vit pas viti, duke i zgjeruar dhe duke i thelluar ato.

Qëllimet e lëndës së Gjuhës shqipe

Lënda e gjuhës shqipe synon t’u japë nxënësve mundësi që:

- të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre për gjuhën dhe komunikimin;
- të pasurojnë fjalorin e tyre, të fitojnë njohuri gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit, të zbatojnë rregullat e gjuhës së folur dhe të shkruar, si dhe të krijojnë marrëdhënie të qëndrueshme me leximin, nëpërmjet të cilit fitojnë kënaqësi dhe marrin informacion;
- të diskutojnë dhe të ndërveprojnë me të tjerët, të komunikojnë, të shprehin qartë dhe të argumentojnë

mendimet dhe idetë e tyre, të zotërojnë “artin” e të folurit dhe të dëgjuarit, të marrin pjesë në diskutime dhe në debate të ndryshme, duke dhënë kontributin e tyre në të gjitha fushat e jetës;

- të përvetësojnë aftësitë e duhura për të analizuar, për të interpretuar, për të vlerësuar dhe për të prodhuar tekste për një larmi funksionesh, të zbatojnë njohuritë dhe strategjitë e procesit të të lexuarit për t’u bërë lexues të pavarur, si dhe për të kuptuar dhe për të gjykuar tekste dhe materiale të llojeve të ndryshme;
- interpretojnë dhe vlerësojnë informacione të ndryshme për botën në përgjithësi.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (*Nxënësi komunikon në mënyrë efektive*).

Nxënësi:

- shprehet, përmes një forme komunikimi, për një temë të caktuar në një material (prezantim) prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore të ngritura në atë material;
 - diskuton në grup, jo më shumë se 10 minuta, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar nga fushat e të nxënit ose nga jeta e përditshme;
 - lexon rrjedhshëm një tekst të përbërë prej 3 paragrafesh, u përgjigjet pyetjeve të shtruara për llojin e tekstit dhe stilet e të shkruarit;
 - përdor drejt strukturën dhe rregullat e drejtshkrimit të gjuhës në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, e-mail (postë elektronike), letër formale dhe joformale etj.;
 - shkruan një tekst për një temë nga jeta e përditshme, me 3 paragrafë, duke respektuar strukturën, drejtshkrimin dhe elementet e tjera, pastaj e prezanton para të tjerëve me shqiptim të drejtë;
 - shkruan një ese, jo më shumë se dy faqe, për vlerat estetike të pjesëve të caktuara artistike (poezi, prozë, pjesë muzikore, pjesë arti, vallëzim etj.), duke respektuar organizimin dhe hapat e shkrimit të një eseje;
 - prezanton një projekt artistik, humanitar, eksperimentues etj. nga fusha të ndryshme mësimore, të hartuar individualisht dhe në grup, duke përdorur teknologjinë e informacionit dhe teknologji të tjera.

Kompetenca e të menduarit (*Nxënësi mendon në mënyrë krijuese*)

Nxënësi:

- prezanton, në forma të ndryshme të të shprehurit, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh.: temë nga shkenca, nga kultura, nga arti, nga sporti etj.);
- krahason, të paktën, tri burime të ndryshme të informacionit për trajtimin e së njëjtës temë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur TIK-un;
- modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga një fushë mësimore;
- krijon një vepër artistike me pamje dy- dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore.

Kompetenca e të nxënit (*Nxënësi mëson për të nxënë*)

Nxënësi:

- demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në ndonjë fushë të caktuar mësimore;

- shfrytëzon, në mënyrë efektive, përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme;
- përgatit me sukses një përmbledhje të dosjes personale (portofolit), për vetëvlerësimin e përparimit të vet në një fushë mësimore të caktuar, dhe veçon disa nevoja të domosdoshme për përmirësimin e avancimit të mëtijshëm;
- paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar, duke dhënë mendime në formë skice, grafi ku, vizatimi etj.;
- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna në ndonjë burim informacioni për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë, sipas qëllimeve që i cakton vetes.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive*)

Nxënësi:

- harton një projekt duke shkëmbyer informacion me të tjerët, duke u konsultuar me ta dhe duke i informuar të tjerët, si dhe duke identifikuar e vlerësuar burimet njerëzore, materiale e monetare, në përputhje me rezultatet e pritshme;
- analizon gjendjen e mjedisit (në klasë, në shkollë, në komunitet apo më gjerë) dhe pasojat e ndotjes, propozon alternativa për mbikëqyrje dhe menaxhim të drejtë të gjendjes së vlerësuar më të ndjeshme;
- merr pjesë në aktivitete të ndryshme në nivel klase, shkolle, bashkie dhe më gjerë (p.sh., konkurse mësimore, gara sportive, aktivitete kulturore, muzikore etj.), diskuton me të tjerët për rezultatet e arritura dhe për procesin e organizimit dhe jep argumente në forma të ndryshme shprehëse se si të rritet pjesëmarrja në aktivitete dhe si të përmirësohet procesi i organizimit të tyre.

Nxënësi:

- analizon përparësitë dhe dobësitë personale duke evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështetë avancimin personal;
- merr pjesë aktivisht në lojëra, në gara sportive dhe në aktivitete të tjera kulturore, duke menaxhuar emocionet e veta;
- ilustron, me shembuj para të tjerëve, modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.

Kompetenca qytetare (*Nxënësi përkushtohet ndaj së mirës së përbashkët*)

Nxënësi:

- demonstroi shembuj të pjesëmarrjes demokratike dhe drejton forma të ndryshme të diskutimit për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes demokratike në nivele të ndryshme (p.sh., në familje, në shkollë, në komunitet, në nivel vendor dhe qendror);
- demonstroi veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe më gjerë);
- diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj.

Kompetenca digjitale (*Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin*)

Nxënësi:

- përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive;

- përdor mjetet digjitale për të përpunuar, krijuar, realizuar dhe demonstruar tema mësimore nëpërmjet pamjeve të filmuara apo të animuara;
- gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash;
- zhvillon aftësitë krijuese, duke zbatuar njohuritë e marra në shkencën kompjuterike dhe mediat digjitale.

Lidhja e Gjuhës shqipe me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema që integrojnë fushat e të nxënës dhe që i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë e të interpretojnë botën dhe të lidhin dijet e marra në shkollë me jetën dhe me interesat e tyre. Në kornizën kurrikulare janë përcaktuar temat ndërkurrikulare të mëposhtme.

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave
- Të drejtat e njeriut
- Vendimarrja morale
- Bashkëjetesa paqësore

Mësimi i gjuhës shqipe, për specifi kat dhe hapësirat që ka, lejon krijimin e situatave mësimore nëpërmjet të cilave mundësohet trajtimi i këtyre temave. Kështu p.sh., leximi dhe studimi i teksteve të ndryshme zhvillojnë te nxënësit identitetin kombëtar, si dhe njohjen e vlerësimit të kulturës botërore. Tema, si të drejtat e njeriut, vendimarrja morale, mjedisi, zhvillimi i qëndrueshëm etj., mund të realizohen gjatë diskutimeve dhe bashkëbisedimeve në grup që mund të zhvillohen gjatë orëve mësimore. Mësuesi mund të krijojë edhe situata mësimore gjatë të cilave nxënësit shprehin në formë të ndryshme: ese dhe shkrime të krijuara me tematikë rreth çështjeve të mësipërme. Punët në grupe, të zhvilluara në lëndën e gjuhës e shqipe, ndihmojnë aftësimin e nxënësve për të jetuar në mënyrë paqësore me të tjerët.

Lidhja e Gjuhës shqipe me fushat e tjera të të nxënës

Gjuha shqipe, duke qenë jo vetëm disiplinë, por edhe gjuhë e procesit të mësimdhënies dhe e të nxënës, ka lidhje të qarta dhe plotësuese me fushat dhe lëndët e tjera mësimore.

Në mënyrë të veçantë, lënda e gjuhës shqipe lidhet me lëndët e fushës “Gjuhët dhe komunikimi”:

- Letërsia i ofron gjuhës një model të përsosur të përdorimit të gjuhës, ndërsa studimi i gjuhëve të huaja siguron transferimin e njohurive gjuhësore nga një lëndë në një tjetër, por edhe vlerësimin e mundësive shprehëse të gjuhës shqipe.
- Lënda e gjuhës shqipe (aftësitë e të lexuarit) mbështet kuptimin e ushtrimeve dhe të **teksteve matematikore**. Kjo lëndë është e nevojshme për formimin e koncepteve dhe proceseve matematikore. Aftësitë e mira gjuhësore e lejojnë nxënësin të përmirësojë elementet pamore, përfshirë edhe organizimin e grafi këve të informacionit, planifi kimin, organizimin e ideve dhe përcaktimin e një procedure; të dyja lëndët e ndihmojnë nxënësin të zhvillojë aftësinë për të paraqitur një argument ose për të kryer një analizë nga këndvështrime të ndryshme; të dyja lëndët përdorin një qasje deduktive.
- Kuptimi ose analiza e teksteve **të shkencave të natyrës** kërkon aftësi të mira leximi. Po kështu, p.sh., leximi i një teksti i ndihmon nxënësit të marrin njohuri rreth natyrës, siç njohuritë e marra në shkencat e natyrës nxitin imagjinatën për të realizuar me shkrim një përshkrim të natyrës.
- Në mënyrë të veçantë, lënda e gjuhës shqipe është e lidhur me **historinë** dhe **shkencat shoqërore**, përderisa të gjitha tekstet që studiohen nga nxënësit kanë një kontekst historik dhe socio-kulturor.
- Mësimi i **arteve** të ndryshme mbështetet nga lënda e gjuhës shqipe. Kështu, analiza e teksteve të ndryshme me tematikë nga arti ndihmon nxënësit për lëndët e arteve. Gjithashtu, studimi dhe krijimi i teksteve të ndryshme, si p.sh., i reklamave, kërkon integrim me artet për elementet pamore të reklamave etj. Duke pasur parasysh gjithçka më sipër, mësuesit, me pasion dhe përkushtim, mund të realizojnë pa fund integritet mes fushave dhe lëndëve në situata të ndryshme të nxënë. Ky integritet i lejon nxënësit të mos marrin njohuri të fragmentuara dhe të shkëputura nga jeta.

Kompetencat e lëndës dhe përshkrimi i tyre

Puna për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave të lëndës nuk është e copëzuar dhe fragmentare. Çdo orë mësimore kontribuon për to.

Kompetencat ndërlidhen dhe plotësojnë njëra-tjetrën. Kështu, kompetenca e të lexuarit të teksteve të ndryshme (njohuritë, shkathësitë, vlerat dhe qëndrimet e kësaj kompetence) ndikon në aftësimin e nxënësve për të shkruar, ndërsa formimi i nxënësve rreth sistemit gjuhësor ë shqipes ndikon në zhvillimin e kompetencave të tjera. Më poshtë janë dhënë përshkrimet e kompetencave të lëndës.

a) Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

Të folurit është mjeti themelor i komunikimit me të tjerët dhe gur themeli i të mësuarit në të gjitha lëndët mësimore. Duke folur dhe duke biseduar, nxënësit jo vetëm japin informacion, por edhe sqarojnë kuptimin dhe domethënien e koncepteve të ndryshme, identifikojnë dhe zgjidhin probleme, zgjerojnë njohuritë, si dhe shprehin mendimet, ndjenjat e opinionet e tyre. Kur ata diskutojnë rreth një informacioni, njohin dhe pranojnë edhe këndvështrimet e bashkëbiseduesve të tjerë, si dhe mjetet gjuhësore apo stilin që ata përdorin. Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit përmirësojnë aftësitë e tyre për të komunikuar dhe për të prezantuar ide në klasë dhe në situata formale. Nëpërmjet këtyre situatave, nxënësit aftësohen edhe për të folurit në publik. Ata mësojnë të flasin qartë, bindshëm e me vetëbesim dhe të jenë tërheqës për të tjerët:

- duke përdorur gjuhën standarde, sidomos kur këtë e dikton situata dhe dëgjuesit;
- duke diskutuar në grupe të vogla dhe të mëdha, duke marrë role të ndryshme në menaxhimin dhe në moderimin e diskutimeve e të debateve, si dhe duke përfshirë e angazhuar të tjerët për të përmbushur afatet e qëllimet;
- duke respektuar, gjatë prezantimeve me gojë, karakteristikat e një fjalimi, shpjegimi, raportimi, debati etj.;
- duke përzgjedhur fjalët e fjalitë e përshtatshme dhe duke përdorur mjete retorike e të figurshme;
- duke përdorur dhe duke vlerësuar TIK-un gjatë prezantimeve në aktivitete të ndryshme në shkollë dhe jashtë saj.

b) Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Gjatë arsimit të mesëm të lartë, nxënësit reflektojnë ndaj informacioneve të llojeve dhe të fushave të ndryshme; përmbledhin, parafrzojnë dhe vlerësojnë përmbajtjen e informacionit të dëgjuar; analizojnë stilin dhe strukturën e një fjalie ose të një teksti të dëgjuar; përqendrohen te folësi, diskutojnë dhe zgjerojnë idetë e dëgjua; mbajnë shënime të tilla që demonstrojnë të dëgjuarit e qëllimshëm etj.

c) Të lexuarit e teksteve të ndryshme

Edhe pse disa nxënës që hyjnë në klasën e njëmbëdhjetë, janë lexues të pavarur, shumë prej tyre mund të kenë nevojë për mbështetje, me qëllim që të zhvillojnë më tej aftësitë në lexim. Pra, ky proces duhet të vijojë edhe në arsimin e mesëm të lartë. Përveç kësaj, të gjithë nxënësit përballen me sfidat që shtrën programi i gjuhës shqipe, i cili kërkon nga nxënësit të përvetësojnë koncepte gjithnjë e më abstrakte, të përdorin struktura gjuhësore më komplekse, si dhe të kenë fjalor më të pasur se në arsimin bazë.

Lënda e gjuhës shqipe i ndihmon nxënësit që të lexojnë në mënyrë aktive dhe kritike, si dhe ta përthithin mirë e shpejt informacionin. Një lexues aktiv dhe kritik është ai që jo vetëm i kupton njohuritë në një tekst, por edhe i përdor ato në kontekste të reja. Për ta realizuar këtë, nxënësit zbatojnë një sërë strategjish të të kuptuarit, si dhe njihen me një shumëllojshmëri dhe prirjet e tyre dhe, gjithashtu, ta kenë më të lehtë të zgjedhin orientimin e karrierës së tyre.

d) Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Të shkruarit u jep mundësi nxënësve të mësojnë për veten e tyre dhe të lidhen me botën. Një nga qëllimet e programit të gjuhës shqipe është që nxënësit të demonstrojnë siguri dhe saktësi kur shkruajnë, të hulumtojnë para se të shkruajnë një tekst, si dhe të komunikojnë me kompetencë, duke përdorur forma dhe stile të ndryshme të shkruarit. Gjatë tri viteve, nxënësit krijojnë, organizojnë dhe përzgjedhin ide për të shkruar për qëllime, audienca dhe situata të ndryshme. Ata zbatojnë hapat e domosdoshëm të procesit të shkrimit (planifikimi, organizimi i punës me shkrim, rishikimi, redaktimi etj.). Nxënësit zbatojnë gjatë të shkruarit karakteristikat e teksteve dhe rregullat gramatikore e drejtshkrimore.

e) Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit

Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit demonstrojnë ndërgjegjësim dhe saktësi në përdorimin e njohurive rreth sistemit gjuhësor të shqipes. Ata i konsolidojnë njohuritë gjuhësore, aftësohen ta përdorin gjuhën saktë dhe brenda rregullave gramatikore. Nxënësit i përdorin njohuritë gjuhësore për të organizuar, për të redaktuar dhe për të përmirësuar shkrimet e tyre, për të folur qartë dhe saktë, për të gjykuar gjuhën e një teksti që dëgjojnë ose lexojnë etj. Në këtë cikël, nxënësit përcaktojnë dallimet mes gjuhës së folur e gjuhës së shkruar, analizojnë regjistrat e gjuhës, vlerësojnë pasurinë leksikore të gjuhës shqipe dhe zbatojnë rregullat drejtshkrimore dhe të pikësimit.

PLANI SINTETIK DHE ANALITIK***Fusha: GJUHA DHE KOMUNIKIMI******Lënda: Gjuhë Shqipe******Shkalla: 6******Klasa: XII******Viti shkollor: 2019-2020***

Njohuri të reja	48
Përpunim njohurish	20
Gjithsej	68

Plani sintetik

Tabelë e detajuar e planit mësimor			
Njohuri të reja		Përpunim njohurish	Kohëzgjatja
Të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit e teksteve të ndryshme: - përshkuese - rrëfyese - udhëzuese - argumentuese - informuese-paraqitëse	35 orë	Përsëritje 6 orë Punë me shkrim 2 orë Punë me projekt 4 orë Testime 3 orë	Tremujori i parë 14 javë/28 orë Tremujori i dytë 12 javë/24 orë Tremujori i tretë 8 javë/16 orë Gjithsej: 34 javë/68 orë
Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit Leksikologji Morfologji Sintaksë Drejtshkrim	27orë	Portofoli i nxënësit 3 orë Gjithsej 18 orë	
Përgatitja e nxënësve për provimet e Maturës Shtetërore	6 orë		
Gjithsej:	68orë		

Plani analitik
Sipas ndarjes në TREMUJORË

TREMUIJORI I PARË								
SHTATOR-DHIJETOR (28 ORË)								
Nr. Plan.	Nr. Sem/jave/Moduli	TEMATIKA	Kompe fushës	TEMAT MËSIMORE	SITUATA E TË NXËNIT	METODOLOGJI A DHE VEPRIMTARITË	VLERËSIMI	BURIMET DHE MJETET MËSIMORE
1	Java I	Moduli 1: Tekste përshkruese dhe njohuri gjuhësore	Lex.	Tekstet përshkruese	Përshkruani me një paragraf një personazh nga letërsia ose kinematografia.	Përvijim i mendimit Të nxënit ndërveprues Stuhi mendimi Hartë konceptesh Diagramë Veni Punë në grup Praktikë e drejtuar	Vlerësim për pjesëmarrjen në diskutime - fjalorin e përdorur gjatë diskutimit	Materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive)
2			Lex.	Analizë teksti përshkrues	Përshkruani me një paragraf një personazh nga letërsia ose kinematografia.	Përvijim i mendimit Të nxënit ndërveprues Stuhi mendimi Hartë konceptesh Diagramë Veni Punë në grup Praktikë e drejtuar	Vlerësim për: - pjesëmarrjen në diskutime; - materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja; - fjalorin e përdorur gjatë diskutimit, pas zhvillimit të punës në grupe.	Materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive)
3	Java II	Moduli 2: Tekste rrëfyese dhe njohuri gjuhësore	Morf	Fjala dhe morfëma	Tekst, N. Prifti	Stuhi mendimi, Diagramë Veni, Punë në grup	Vlerësim për: -dallimin e llojeve të morfemave; - analizë morfemore të fjalëve . -krijimin e fjalëve të reja me parashtesa	Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë, Fjalori i gjuhës Shqipe, FESH, Videoprojektor

4	Morf	Llojet e morfemave	Fragment	Stuhi mendimi, <i>Diagramë Veni,</i> <i>Punë në grup</i>	Vlerësim për: - analizën morfemore të fjalëve; - krijimin e fjalëve të reja me prapashitesa dhe prapashitesa njëkohësisht.	Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, Fjalori i gjuhës Shqipe, FESH, Videoprojektor
5	Shkr	Përshkrimi i një personi	Lexohen fragmente të shkurtra përshkruese.	Të nxënit <i>ndërveprues</i> <i>Stuhi mendimi</i> <i>Leksion i përqendruar</i> <i>Punë në grup</i>	Vlerësim për: - shkrimin e esesë sipas formatit të kërkuar; - fjalorin e përdorur gjatë shkrimit të esesë; - përdorimin e mjeteve stilistike në paragrafët subjektivë përshkrues	Materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, <i>sleep-charter</i> , shkumësa me ngjyra etj.
6	Dëgj	Të dëgjuarit për të kuptuar dhe për të reflektuar	Në formën e një loje, nxënësit i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit dhe reflektojnë rreth përgjigjeve të dëgjuara.	Diskutim njohurish <i>paraprake</i> <i>Stuhi mendimi</i> <i>Punë në grup</i> <i>Leksion i përqendruar</i> <i>Përmbledhje e strukturuar</i>	Vlerësim për - tregimin e respektit, empatisë (ndjeshmërisë) dhe interesit ndaj folësit; - demonstrimin e vullnetit gjatë kryerjes së detyrave; - përdorimin e imagjinatës dhe kreativitetit për zgjidhjen e problemeve së të tjerëve	Materiale dëgjimore, CD dëgjimore, libri i nxënësit, tabela, <i>sleep-charter</i> , shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive)

7	Java 4	Morf.	Fjalë e thjeshtë dhe fjalë e përbërë	Tekst	<i>Stuhi mendimi, Puna me fisha, Pëmë mendimi, Diskutim, Punë e pavarur/në grup.</i>	Vlerësim për - dallimin e marrëdhënieve kuptimore dhe lidhjeve sintaksore që realizohen në fjalë e thjeshtë dhe në fjalë e përbërë.	Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë, videoprojektor.
8		Sint.	Fjalë e përbërë me bashkërenditje	Tekst	<i>Stuhi mendimi, Pëmë mendimi, Diskutim, Punë e pavarur/në grup.</i>	Vlerësim për - dallimin e llojeve të fjalëve me bashkërenditje; - ndërtimin e fjalëve të përbëra me bashkërenditje këpujore, kundërshtore, veçuese, përmbyllëse dhe shkakore-motivuese.	Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë, videoprojektor.
9	Java 5	Lex.	Tekstet rrëfyese	Rrëfëni shkurtimisht një ngjarje të ditëve të fundit. Si vepruat?	<i>Të nxënë ndërveprues Stuhi mendimi Hartë semantike Diagramë Veni Punë në grup Përmbledhje e strukturuar</i>	Vlerësim për - pjesëmarrjen në diskutime; - materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja; - fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna.	Materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-charter</i> , shkurtesa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive)
10		Lex.	Analizë teksti rrëfyese	Rrëfëni shkurtimisht një ngjarje të ditëve të fundit. Si vepruat?	<i>Të nxënë ndërveprues Stuhi mendimi Hartë semantike Diagramë Veni</i>	Vlerësim për - pjesëmarrjen në diskutime; - materialet e sjella në mbështetje të	Materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-charter</i> , shkurtesa me

						<i>Punë në grup</i> <i>Përmbledhje e strukturuar</i>	njothurive të reja; - fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna.	ngjyra (kur është e mundur projektore ose tabelë interaktive)
11	Java 6	<i>Drejtsh.</i>	Drejtshkrimi i emrave të përveçëm të huaj	Gazeta	<i>Stuhi mendimi, Diskutim, Punë e pavarur / në grup.</i>		Vlerësim për -dallimin e fjalëve të huaja të shkruara gabim.	Teksti mësimor, videoprojektor, tabelë, gazeta, “Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe”.
		<i>Drejtsh.</i>	Drejtshkrimi i fjalëve me prejardhje të huaj	“Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe”	<i>Stuhi mendimi, Diskutim, Punë e pavarur / në grup, Ese 5-10’</i>		Vlerësim për - gjetjen e gjegeve në gjuhën shqipe të fjalëve të huaja.	Teksti mësimor, videoprojektor, tabelë, gazeta, “Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe”.
13	Java 7	<i>Flas.</i>	Përshtatja e gjuhës gjatë të folurit me qëllimin, temën dhe dëgjuesin	Prezantohet një sekuençë e të folurit në publik nga një personazh i njohur publik.	<i>Diskutim në bazë të fjalëve kyçe, Leksion i përqendruar, Punë në grupe, Rrjeti i diskutimit.</i>		Vlerësim për: - pjesëmarrjen në diskutime; - fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna	Materiale për diskutim, materiale audiovizive, teksti mësimor, CD shoqëruese e librit të mësuesit.
14		<i>Morf</i>	Mënyrat e formimit të fjalëve	Teksti “Dështaku”	<i>Stuhi mendimi, Pemë mendimi</i>		Vlerësim për: - përcaktimin e mënyrave të formimit të fjalëve në gjuhën shqipe; - dallimin dhe analizën e fjalëve që janë formuar me prejardhje si dhe ato që krijojnë fjalë të reja me prejardhje.	Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë.

15	Java 8		Shkr	Shkruajmë një artikull	Cilat janë tematikat tuaja të pëlqyera të artikujve?	<i>Rrjeti i diskutimit, Leksion i përqendruar, Demonstrim analitik, Punë e pavarur me shkrim.</i>	Vlerësim për planifikimin, draftimin, hartimin dhe rishikimin e esesë.	Gazeta, artikuj revistash, CD audiovizive, teksti mesimor, tabela interaktive, fletore të punëve me shkrim.
16			Shkr	Shkruajmë një artikull	Shkrimi i artikullit	<i>Punë e pavarur me shkrim.</i>	Vlerësim për shkrimin e esesë	Gazeta, artikuj revistash, CD audiovizive, teksti mesimor, tabela interaktive, fletore të punëve me shkrim.
17	Java 9		Morf	Përngjithja dhe kompozimi	Teksti “Don Kishoti”	<i>Stuhi mendimi, Punë e pavarur/ në grup</i>	Vlerësim për: -dallimin e fjalëve të formuara me kompozim dhe fjalëve të formuara me mënyra të tjera.	Teksti mesimor, skeda, bllok gramatike, tabelë.
18			Morf	Nyëzimi dhe konversioni	Tekst nga Kasem Trebeshina	<i>Stuhi mendimi, Punë e pavarur/ në grup</i>	Vlerësim për: -përcaktimin e pjesëve të ligjëratës (klasa fjalësh) që formohen me nyëzim; - përcaktimi i pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës që formohen me konversion.	Teksti mesimor, skeda, bllok gramatike, tabelë.
19	Java 10		Dëgj	Të dëgjuarit kritik	Kërkohet nga nxënësit të reflektojnë rreth një materiali të shkurtër dëgjimor.	<i>Loja gjuhësore, Harta semantike, Punë në grupe, Rrjeti i diskutimit</i>	Vlerësim për reagimin në mënyrë të përshtatshme duke treguar	Teksti mesimor, Cd me këngë dhe fragmente dëgjimore, materiale të

					Planifikim			mirëkuptim ndaj folësit;	ndryshme dëgjimore.
20			Përp. njohurish	Punë me projekt mësimit i maturantit			Diskutim	Vlerësim për dhënie e ideve dhe pjesëmarrjen në diskutime	Gazeta, artikuj revistash, projekte të viteve të shkuara.
21	Java 11	Moduli 3: Tekste udhëzuese dhe njohuri gjuhësore	Lex.	Tekstet udhëzuese	Ku dallon teksti udhëzues nga ai shpjegues?	Tabela semantike, Diskutim njohurish paraprake, Stuhi mendimi, Organizuesi logjik i analogjisë, Punë në grup, Praktikë e drejtuar	Nxënësit do të vlerësohen: -për pjesëmarrjen në diskutime; -për analizën e strukturës së tekstit udhëzues;	Teksti mësimit, tekste udhëzuese, materiale ilustruese, telefon celular për leximin e librave elektronikë.	
22			Lex.	Analizë teksti udhëzues	Tiparet e tekstit udhëzues	Tabela semantike, Diskutim njohurish paraprake, Stuhi mendimi, Organizuesi logjik i analogjisë, Punë në grup, Praktikë e drejtuar	Nxënësit do të vlerësohen: -për pjesëmarrjen në diskutime; -për analizën e strukturës së tekstit udhëzues;	Teksti mësimit, tekste udhëzuese, materiale ilustruese, telefon celular për leximin e librave elektronikë.	
23	Java 12		Morf	Mënyrat e përziera të formimit të fjalëve	Ismail Kadare, “Ura me tri harqe”	Stuhi mendimi, Pemë mendimi,	Vlerësim për: - dallimin e fjalëve të formuar me përngjitje dhe prapashtesim, me kompozim dhe prapashtesim, me nyjëzim dhe prapashtesim etj.; - formimin e fjalëve të reja duke përdorur mënyrat e formimit të fjalëve.	teksti mësimit, skeda, bllok gramatike, tabelë, videoprojektor.	

24				Shkrimi i udhëzimeve për përdorimin e një pajisjeje ose programi kompjuterik	Lexohen fragmente të shkurtra udhëzuese.	Diskutim paraprak, Udhëzime shkrimi, Punë me shkrim sipas grupeve	Vlerësim për shkrimin e tekstit udhëzues	Fletore të punëve me shkrim, modele tekstesh udhëzuese.
25	Java 13			Shkr. Sint.	Fragment	<i>Stuhi mendimi, Pemë mendimi, Diagramë veni, Diskutim, Di, Dua të di, mësova, Punë e pavarur/ në grup</i>	Vlerësim për: -dallimin e llojeve të fjalive të përbëra me nënrenditje ffilluese; -ndërtimin e fjalive të përbëra me nënrenditje ffilluese.	Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë.
26				Përp. njohurish	Portofoli i nxënësit për tremujorin e parë			
27	Java 14			Përp. njohurish	Përsëritje			
28				Përp. njohurish	Testim për tremujorin e parë			

TREMUIORI I DYTË JANAR-MARS (24 ORË)								
Nr. Plan.	Nr. Sem/jave	TEMATIKA/M oduli	Komp e fush.	TEMAT MËSIMORE	SITUATA E TË NXËNIT	METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË	VLERËSIMI	BURIMET DHE MJETET MËSIMORE
1			Sint.	Fjalë e përbërë me pjesë të nënrenditur rrethore	Fjalë të përbërë me nënrenditje, të ndara në fisha ose të paraqitura me videoprojektor.	Suhi mendimi, Pëmë mendimi, Diskutim, Diagramë Veni, Punë e pavarur/ në grup.	Vlerësim për: -dallimin e llojeve të fjalëve të përbërë me nënrenditje rrethore; - veçimin e mjeteve lidhëse (lidhëzat dhe fjalët lidhëse) në fjalitë e përbërë me nënrenditje rrethore; -ndërtimin e fjalëve të përbërë me nënrenditje rrethore.	Teksti mësimor, Gramatikë e gjuhës shqipe II, skeda, bllok gramatike, tabelë, FESH, videoprojektor.
2			Sint..	Fjalë e përbërë me pjesë të nënrenditur përcaktore	Fjalë të përbërë me nënrenditje, të ndara në fisha ose të paraqitura me videoprojektor.	Suhi mendimi, Pëmë mendimi, Puna me fisha, Diskutim, Diagramë Veni, Punë e pavarur/ në grup, Minitest	Vlerësim për: -dallimin e llojeve të fjalëve të përbërë me nënrenditje përcaktore. - veçimin e mjeteve lidhëse (lidhëzat dhe fjalët lidhëse) në fjalitë e përbërë me nënrenditje përcaktore. -ndërtimin e fjalëve të përbërë me nënrenditje përcaktore.	Teksti mësimor, Gramatikë e gjuhës shqipe II, skeda, bllok gramatike, tabelë, FESH, videoprojektor.
3			Dëgj	Shkaqet kryesore të dëgjimit të dobët	Gjatë të dëgjuarit shpesh të dëgjuesi vihen re disa shprehje të papërshtatshme, të cilat dëmtojnë marrjen	Puna me fisha, Stuhi mendimi, Leksion i	Vlerësim për reagimin në mënyrë të përshtatshme duke	Materiale dëgjimore, CD, albume fotografike, piktura, libri i

				dhe kuptimin e informacionit. Po ju a jeni një dëgjues i mirë?	<i>përqendruar , Punë në grup</i>	treguar mirëkuptim ndaj folësit;	nxënësit, tabela, <i>sleep-charter</i> , etj.
4				Të folurit për të informuar dhe të folurit për të bindur	<i>Flas.</i>	Vlerësim për - demonstrimin e vullnetit dhe gatishmërisë në detyrat individuale dhe në punët në grup;	Materiale dëgjimore, CD, albume fotografike, piktura, libri i nxënësit, tabela, <i>sleep-charter</i> , etj.
5				Raste të përdorimit të nyjave “të” dhe “së”	<i>Drejtsh.</i>	Vlerësim për: -përdorim të drejtë të nyjës të dhe nyjës së; -dallimin e nyjës së rasës gjinore nga nyja e fjalës.	Teksti mësimor, Gramatikë e gjuhës shqipe, skeda, bllok gramatike, tabelë, videoprojektor.
6		Moduli 4: Tekste argumentuese dhe njohuri gjuhësore		Tekstet argumentuese	<i>Lex.</i>	Vlerësim për - rrjedhshmërinë gjatë të lexuarit; - ndarjen e përvojave të tij të leximit me të tjerët;	Teksti mësimor, materiale burimore informuese, tabela interaktive, videoprojektor, fletore shënimesh etj.
7				Analizë teksti argumentues	<i>Lex.</i>	Vlerësim për - rrjedhshmërinë gjatë të lexuarit; - ndarjen e përvojave të tij të leximit me të tjerët;	Teksti mësimor, materiale burimore informuese, tabela interaktive, videoprojektor, fletore shënimesh etj.
8				Ligjërimet në gjuhën shqipe	<i>Leks.</i>	Vlerësim për: -analizën e tipareve të ligjërit të thjeshtë, të ligjërit bisedor dhe të ligjërit libror.	Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë, Fjalori i gjuhës Shqipe, FESH, videoprojektor.

								- krahasimin e ligjëtimeve bisedor me ligjërimet e thjeshta.		
9				Stilet funksionale të gjuhës: stili i letërsisë artistike dhe stili politiko-shoqëror	Faik Konica “Malli i Atdheut”	<i>Suhi mendimi, Penë mendimi, Diagramë Vëni, Punë e pavarur/ në grup</i>		Vlerësim për: -përcaktimin e kuptimit të termit “stil funksional”; - përcaktimin e llojit të stilit të një teksti; - krahasimin e stileve me njëri-tjetrin.	Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë, Fjalori i gjuhës Shqipe, FESH, videoprojektor.	
10				Studim tekstesh të dëguara	Komentoni titullin e kësaj interviste: “Gjuha shqipe një nga makinat më të përsosura të Evropës” .	<i>Punë në grupe dyshe, Dëgjim i fragmentuar dhe pyetje-përgjigje, Punë e pavarur në grupe</i>		Vlerësim për demonstrimin e aftësive të domosdoshme të të dëgjuarit kritik.	Teksti i nxënësit, Cd dëgjimore me intervistën e Kadaresë, sekuenca të shkurtra nga opinione rreth temës.	
11				Leks Përsëritje. Stili i letërsisë artistike	Gazeta, revista	<i>Suhi mendimi, Diskutim, Ese 5-10 min., Di, dua të di, mësova, Diagramë Vëni, Punë e pavarur/ në grup</i>		Vlerësim për: - ndërtimin e një teksti në stilin e letërsisë artistike dhe në stilin politiko-shoqëror.	Teksti mësimor, tabelë, fletë A4, gazeta, revista.	
12				Flas. Fjalimi bindës	A e dini se fuqia e fjalës së njerëzve të mëdhenj ka ndryshuar historinë?	<i>Diskutim i lirë rreth situatës, Leksion i përqendruar hap</i>		Vlerësim për - demonstrimin e vullnetit dhe gatishmërisë në detyrat	Teksti i nxënësit, Fjalime bindëse, materiale informuese, tabela	

					<i>pas hapi, Punë e pavarur në grupe</i>	<i>individuale dhe në punët në grup;</i>	<i>interaktive, videoprojektor etj.</i>
13		Leks	Stilet funksionale të gjuhës: stili shkencor-teknik dhe stili juridiko-administrativ	Neni 14	<i>Stuhi mendimi, Pemë mendimi, Puna me fisha, Diagramë Veni, Punë e pavarur/ në grup</i>	Vlerësim për: - analizën e elementeve kryesore të stilit shkencor-teknik dhe stilit juridiko-administrativ; - krahasimin e stileve me njëri-tjetrin.	Teksti mësimor, tabelë, tablo, <i>fleep-chart</i> , videoprojektor.
14		Leks	Përsëritje.Stilet funksionale të gjuhës.	Mendimi politiko-shoqëror, shkrimi dhe shkolla shqipe. Sami Frashëri Normat juridiko-administrative. Veçoritë specifike të tyre.	<i>Stuhi mendimi Diskutim</i>	Vlerësim për: - përcaktimin e stilit të një teksti; - krahasimin e stileve me njëri-tjetrin.	Interneti Gazeta, revista
15		Shkr.	Shkruajmë ese argumentuese	Mbani një qëndrim dhe jepni 2 argumente mbështetëse rreth tij.	<i>Demonstrim, Stuhi mendimesh, Leksion i përqendruar, Punë e pavarur me shkrim.</i>	<i>Vlerësim për skicimin e esesë argumentuese</i>	Ese të ndryshme model, materiale burimore informative, teksti i nxënësit, fletore të punëve me shkrim.
16		Shkr.	Shkruajmë ese argumentuese	Ora e dytë e shkrimit të esesë argumentuese	<i>Punë e pavarur me shkrim.</i>	<i>Vlerësim për shkrimin e esesë argumentuese</i>	Fletore të punëve me shkrim
17		Përpunimi njohuri	Punë me projekt. Manuali mësimor i maturantit	Ndjekje e ecurisë së punës	<i>Diskutim</i>	Vlerësim për ecurinë e mirë të punës dhe pjesëmarrjen në diskutime	Puna me projekt në fazën përgatitore

18	Moduli 5: Tekstet informuese- paraqitëse dhe njohuri gjuhësore	Lex	Tekstet informuese- paraqitëse	Lexohen fragmente procesverbale të ndryshme dhe diskutohet rreth strukturës së tyre.	<i>Stuhi mendimesh, Leksion i përqendruar , Pyetja sjell pyetjen, Punë e pavarur në grupe</i>	Vlerësim për analizën e technikave dhe strukturës së teksteve informuese- paraqitëse	Teksti i nxënësit, tekste informuese, tabela interaktive, videoprojektor, fletore shënimesh etj.
19		Lex	Analizë teksti informues- paraqitës (Procesverbali)	Lexohen fragmente procesverbale të ndryshme dhe diskutohet rreth strukturës së tyre.	<i>Stuhi mendimesh, Leksion i përqendruar , Pyetja sjell pyetjen, Punë e pavarur në grupe.</i>	Vlerësim për analizën e technikave dhe strukturës së teksteve informuese- paraqitëse	Teksti i nxënësit, tekste informuese, tabela interaktive, videoprojektor, fletore shënimesh etj.
20		Drejtsh.	Rregulla për shkrimin e bibliografisë	Shenjat e pikësimit në gjuhën shqipe Shkrim akademik	<i>Stuhi mendimi, Përmendimi, Diagramë Vëni, Punë e pavarur/ në grup.</i>	Vlerësim për: -zbatimin e rregullave të përcaktuara në shkrimin e bibliografisë; -përdorimin e drejtë të shenjave të pikësimit dhe shkronjën e madhe në shkrimin e bibliografisë.	Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë, Fjalori i gjuhës Shqipe, FESH, videoprojektor.
21		Flas.	Përdorimi dhe përparësitë e mjeteve pamore gjatë një prezantimi	Sa rol mendoni se luan përdorimi i mjeteve pamore gjatë një prezantimi?	<i>Lexim i grafikëve dhe tabelave, Harta semantike, Punë e pavarur në grupe.</i>	Vlerësim për demonstrimin e vullnetit dhe gatishmërisë në detyrat individuale dhe në punët në grup.	Teksti i nxënësit, pamje, fotografi me mjete pamore, materiale informuese, tabela interaktive, videoprojektor etj.

22			Përpuni m njohuris h	Portofoli i nxënësit për tremujorin e dytë					
23			Përpuni m njohuris h	Përsëritje					
24			Përpuni m njohuris h	Testim për tremujorin e dytë					

TREMUIORI I TRETË PRILL-MAJ (16 ORË)								
Nr. Plan.	Nr. Sem/jave	TEMATIKA /Moduli	Komp e fush.	TEMAT MËSIMORE	SITUATA E TË NXËNIT	METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË	VLERËSIMI	BURIMET DHE MJETET MËSIMORE
1			Sint.	Fjalitë e ndërmjetme	Tekste Fjali të ndërmjetme	Stuhi mendimi, Penë mendimi, Diskutim, Punë e pavarur/ në grup	Vlerësim për: - dallimin e fjalive të ndërmjetme; - ndërtimin e fjalive të ndërmjetme në mes, në krye dhe në fund të fjalisë.	Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë, videoprojektor, Gramatika e gjuhës shqipe II.
2			Shkr.	Shkrimi i letrës së motivimit	Cilat informacione mendoni se janë kyçe për t'u përfshirë në një letrë motivimi? Pse?	Diskutim paraprak i njohurive, Leksion i përqendruar, Punë e pavarur me shkrim	Vlerësim për shkrimin e letrës së motivimit	Teksti mësimor, letra të ndryshme motivuese, tabela interaktive, videoprojektor.
3			Sint.	Fjalitë e ndërkallura	Rregulla drejtshkrimore	Stuhi mendimi, Penë mendimi, Diagramë veni, Diskutim, Punë e pavarur/ në grup	Vlerësim për: - analizën dhe ndërtimin e fjalive të ndërkallura; - krahasimin e	Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë, videoprojektor, Gramatika e gjuhës shqipe II.

						fjalive të ndërkallura me fjalitë e ndërmjetme.	
4				Përdorimi i shenjave të pikësimit të fjalitë e ndërmjetme dhe te fjalitë e ndërkallura	Rregulla drejtshkrimore	<i>Stuhi mendimi, Diskutim, Punë e pavarur/ në grup</i>	Vlerësim për: - përdorim të drejtë të presjes te fjalitë e ndërmjetme dhe shenjave të pikësimit në fjalitë e ndërkallura. Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë, videoprojektor
5				Përsëritje për drejtshkrimin	F. Konica “Vepra I” R. Dibra “Stina e Ujku” K. Blushi “Më shiko në sy”	<i>Stuhi mendimi, Pemë mendimi, Diagramë Veni, Punë e pavarur/ në grup</i>	Vlerësim për: - përdorim të drejtë të presjes te fjalitë e ndërmjetme dhe shenjave të pikësimit në fjalitë e ndërkallura. Tabelë, videoprojektor, fragmente tekstesh letrare Gramatika e gjuhës shqipe II, Rregullat e pikësimit në fjalitë e ndërkallura.
6				Punë me projekt. Manuali mësimor i maturantit	<i>Vlerësim/Prezantim</i>	<i>Prezantim i produktit</i>	Vlerësim për realizimin e projektit Tabelë, videoprojektor, projekti si produkt
7				Punë me projekt. Manuali mësimor i maturantit	<i>Vlerësim/Prezantim</i>	<i>Prezantim i produktit</i>	Tabelë, videoprojektor, projekti si produkt
8				Përsëritje për maturën shtetërore	<i>Analizë e veprave të maturës shtetërore sipas programit</i>	<i>Prezantim në slajde</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen në diskutime dhe përgjigjet e dhëna Materiale për maturën shtetërore
9				Përsëritje për maturën shtetërore	<i>Analizë e veprave të maturës shtetërore sipas programit</i>	<i>Prezantim në slajde</i>	Vlerësim për pjesëmarrjen në diskutime dhe Materiale për maturën shtetërore

							përgjigjet e dhëna		Materiale për maturën shtetërore
10			Përpunim njohurish	Përsëritje për maturën shtetërore		Analizë e veprave të maturës shtetërore sipas programit	Prezantim në slajde	Vlerësim për pjesëmarrjen në diskutime dhe përgjigjet e dhëna	Materiale për maturën shtetërore
11			Përpunim njohurish	Përsëritje për maturën shtetërore		Analizë e veprave të maturës shtetërore sipas programit	Prezantim në slajde	Vlerësim për pjesëmarrjen në diskutime dhe përgjigjet e dhëna	Materiale për maturën shtetërore
12			Përpunim njohurish	Përsëritje për maturën shtetërore		Analizë e veprave të maturës shtetërore sipas programit	Prezantim në slajde	Vlerësim për pjesëmarrjen në diskutime dhe përgjigjet e dhëna	Materiale për maturën shtetërore
13			Përpunim njohurish	Përsëritje për maturën shtetërore		Analizë e veprave të maturës shtetërore sipas programit	Prezantim në slajde	Vlerësim për pjesëmarrjen në diskutime dhe përgjigjet e dhëna	Materiale për maturën shtetërore
14			Përpunim njohurish	Portofoli i nxënësit për tremujorin e tretë		Analizë e veprave të maturës shtetërore sipas programit	Prezantim në slajde	Vlerësim për pjesëmarrjen në diskutime dhe përgjigjet e dhëna	Materiale për maturën shtetërore
15			Përpunim njohurish	Përsëritje				Vlerësim për pjesëmarrjen në diskutime dhe përgjigjet e dhëna	
16			Përpunim njohurish	Testim për tremujorin e tretë					

TESTOJMË NJOHURITË GRAMATIKORE

NGA KLASA XI

❖ Qarkoni alternativën e shkruar saktë

- | | |
|--------------------|--------------------|
| a. proces verbal | b. procesverbal |
| a. disavjeçar | b. disa vjeçar |
| a. së bashku | b. sëbashku |
| a. kështuqë | b. kështu që |
| a. grupmoshë | b. grup-moshë |
| a. njëmijë | b. një mijë |
| a. ashtusi | b. ashtu si |
| a. aty këtu | b. aty-këtu |
| a. përveçqë | b. përveç që |
| a. herëpashere | b. herë pas here |
| a. këto libra | b. këta libra |
| a. ata personazhe | b. ato personazhe |
| a. jetës sime | b. jetës time |
| a. lapsi jot | b. lapsi yt |
| a. qyteti jonë | b. qyteti ynë |
| a. shtëpisë sime | b. shtëpisë time |
| a. ata pjesëmarrës | b. ato pjesëmarrës |
| a. pritjes sate | b. pritjes tënde |
| a. ata satelitë | b. ato satelitë |
| a. këto qytete | b. këta qytete |
| a. derës tuaj | b. derës suaj |
| a. ata njerëz | b. ato njerëz |
| a. këta vende | b. këto vende |

Përemra të pacaktuar

- | | |
|-----------------|-----------------|
| a. gjithçka | b. gjithëçka |
| a. gjithësecili | b. Gjithsecili |
| a. kurrëgjë | b. kurrëgjë |
| a. shumkush | b. shumëkush |
| a. njëri tjetri | b. njëri-tjetri |
| a. kurrëfarë | b. kurrfarë |
| a. çfarëdo | b. çfardo |
| a. njëri | b. njeri |
| a. ndonjëri | b. ndonjeri |

❖ Qarkoni përgjigjen e saktë me Po/Jo

- Fjala drejtuese e drejton kundrinorin në një rasë të caktuar. Po Jo
- Numri i kundrinorëve në fjali nuk është i kufizuar. Po Jo

- Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë rimerret nga trajtat e shkurtra përemërore. Po Jo
- Kundrinori i drejtë varet nga folja dhe plotëson kuptimin e saj. Po Jo
- Mes rrethanorit dhe kallëzuesit nuk vendoset lidhje drejtimi. Po Jo
- Kundrinori i zhdrejtë nuk mund të shprehet me ndajfolje të emëruar. Po Jo
- Kundrinori i drejtë mund të shprehet me ndajfolje të emëruar. Po Jo
- Kundrinori i drejtë rimerret nga trajtat e shkurtra përemërore. Po Jo
- Mes rrethanorit dhe kallëzuesit vendoset lidhje drejtimi. Po Jo
- Përemrat dëftorë ky/kjo, ai/ajo vendosen para emrave që përcaktojnë. Po Jo
- Përemrat dëftorë i/e atillë, i/e këtillë, i/e tillë, vendosen para emrave që përcaktojnë. Po Jo
- Përemri *kush* ka vetëm kategorinë gramatikore të rasës, por përdoret kryesisht në rasën emërore dhe dhanore. Po Jo
- Përemri *kush* mund të përdoret edhe në rasën gjinore. Po Jo
- Përemrat *dikush*, *ndokush*, përdoren në të gjitha rasat dhe shoqërohen me parafjalë. Po Jo
- Fjalët sinonime i përkasin së njëjtës pjese të ligjëratës. Po Jo

❖ Plotësoni

- Shto sipas modelit lokucione ndajfoljore të tipit: *përsëritja e të njëjtit emër me ndërmjetësinë e parafjalës.*

- | | |
|--------------------|-------------------|
| a. nga viti në vit | nga çasti në çast |
| b. javë për javë | _____ |
| c. hap pas hapi | _____ |
| d. dita me ditë | _____ |
| e. skaj më skaj | _____ |

- Shto sipas modelit lokucione të tipit:

- | | |
|--|-------|
| a. <i>parafjala me + emër me natë</i> | _____ |
| b. <i>parafjala për + mbiemër të emëruar</i> | _____ |
| c. <i>parafjala me + mbiemër të emëruar</i> | _____ |
| d. <i>parafjala me + emër i pashquar</i> | _____ |
| e. <i>parafjala me + numëror për dy</i> | _____ |

3. Biografia rrëfhet në vetën e _____.

4. Autobiografia rrëfhet në vetën e _____.

5. Kronika është tekst _____.

6. Rregulloret janë tekste _____.

7. Në shkrimin e një biografie përdoren përgjithësisht kohët _____, por edhe _____.

8. Rrethanori në fjalinë: “Krimi ishte bërë vetëm me një qëllim: për të krijuar tmerr.” është rrethanor _____ dhe shprehet me _____.

9. Zëvendësoni ndajfoljen në fjalinë: “Kthehesha prapë atje, prej nga isha nisur, endja e çendja të njëjtën gjë.” me lokucion ndajfoljor.

ndajfolja _____

lokucion ndajfoljor _____

(2 pikë)

10. Zëvendësoni ndajfoljen në fjalinë: “Çfarë bëjmë tani në këtë çast në këtë Asamble?” me lokucion ndajfoljor.

ndajfolja _____

lokucion ndajfoljor _____

11. Përemrin “Ai” në fjalinë: “Ai është fizikani më i madh i të gjitha kohërave.”, përdoreni si përemër dëftor.

12. Në fjalinë: “Kthehesha prapë atje, prej nga isha nisur, endja e çendja të njëjtën gjë.”

antonimia _____

është formuar me _____

Qarkoni përgjigjen e saktë

1. Fjala e nënvizuar në fjalinë.

“U ulën buzë detit.” është:

- a. Emër
- b. parafjalë

2. Fjala e nënvizuar në fjalinë:

“I mbeti buzëqeshja në buzë.” është:

- a. emër;
- b. parafjalë.

3. Parafjalët: “me anë, me anën, në drejtim, në saje të, për shkak” janë të rasës:

- a. emërore
- b. gjinore
- c. kallëzore
- d. rrjedhore

4. Fjala e nënvizuar në fjalinë.

“Dielli kishte perënduar në rrëzë të malit.” është:

- a. ndajfolje
- b. parafjalë
- c. emër

5. Cilat fjalë mund të përdoren edhe si emra, dhe si parafjalë?

- a. buzë, anë, majë
- b. afër, para, prapa

6. Në fjalinë: “Shikimin e kishte të mjegullt.”, përcaktori kallëzuesor është?

- a. përcaktor kallëzuesor i kryefjalës
- b. përcaktor kallëzuesor i kundrinorit

7. “Përcaktori kallëzuesor”:

- a. vendoset gjithnjë pas kallëzuesit
- b. vendoset zakonisht pas kallëzuesit, por ai mund të zhvendoset lirshëm në fjali

8. Fjala e nënvizuar në fjalinë: “Gjithçka ndodhi papritur, kur ai erdhi afër.” është:

- a. ndajfolje
- b. parafjalë

9. Fjala e nënvizuar në fjalinë: “Afër shkollës ishte hapur një librari e re.” është:

- a. ndajfolje
- b. parafjalë

10. Fjala e nënvizuar në fjalinë: “Ai është i afërt me mua.” është:

- a. ndajfolje
- b. mbiemër

11. Fjala e nënvizuar në fjalinë: “Ai e gjeti afërsisht përgjigjen.” është:

- a. ndajfolje
- b. mbiemër

12. Parafjalët: “nga, tek (te)” janë të rasës:

- a. emërore
- b. gjinore
- c. kallëzore
- d. rrjedhore

13. Cila parafjalë përdoret vetëm në një rasë të caktuar (jo me dy rasa)?

- a. ndaj
- b. me
- c. për

14. Në fjalinë: “Këtë libër e kishte mikun më të ngushtë.” përcaktori kallëzuesor është?

- a. përcaktor kallëzuesor i kryefjalës
- b. përcaktor kallëzuesor i kundrinorit

15. Parafjalët: “*me, mbi, nën, nëpër*” janë të rasës:
- emërore
 - gjinore
 - kallëzore
 - rrjedhore
16. Rrethanori në fjalinë “*Përse më shikon me habi*” është:
- shkaku;
 - qëllimi
 - mënyre
17. Gjymtyra e nënvizuar në fjalinë: “*Mësimi u kuptua nga nxënësit.*” është:
- rrethanor mënyre
 - kundrinor i zhdrejtë me parafjalë
 - kryefjalë
18. Gjymtyra e nënvizuar në fjalinë e “*Shkruan me kujdes.*” është:
- rrethanor mënyre
 - kundrinor i zhdrejtë me parafjalë
19. Fjala e nënvizuar në fjalinë “*U shtang nga frika.*” është:
- rrethanor shkaku
 - rrethanor qëllimi
 - kundrinor i zhdrejtë me parafjalë
 - kryefjalë
20. Rrethanori i nënvizuar në fjalinë: “*Sot për sot kështu janë rezultatet.*” shprehet me:
- formë të pashtjelluar foljore
 - grup emëror
 - lokucion ndajfoljor
21. Trajta e shkurtër përemërore në fjalinë: “*Mbyllini dritaret.*” është:
- para foljes
 - pas foljes
 - në mes të foljes
22. Trajta e shkurtër përemërore në fjalinë: “*Merre shtruar.*” është:
- para foljes
 - pas foljes
 - në mes të foljes
23. Përemri “*Ajo*” në fjalinë: “*Ajo atje është shkolla ime.*” është:
- përemër vetor
 - përemër dëftor
24. Përemrat e pacaktuar “*një, ndonjë, njëfarë, çdo*” janë:
- të ndryshueshëm
 - të pandryshueshëm
25. Përemrat e pacaktuar “*dikush, kush, njëri, ndonjëri*” janë:
- të ndryshueshëm
 - të pandryshueshëm
26. Trajta e shkurtër përemërore në fjalinë: “*Pra, merrmë o lundër dhe vrapo*” është:
- para foljes
 - pas foljes
 - në mes të foljes
27. Fjala e nënvizuar në fjalinë: “*Rrezet e tij përflaknin sipër me ngjyra të ndezura qytetin.*” është:
- ndajfolje
 - parafjalë
28. Fjala e nënvizuar në fjalinë: “*Rri gjithë ditën sipër librave.*” është:
- ndajfolje
 - parafjalë
29. Fjala e nënvizuar në fjalinë: “*Njëri nga nxënësit prezantoi projektin.*” është:
- emër
 - parafjalë
 - përemër i pacaktuar
30. Fjala e nënvizuar në fjalinë: “*Bëri dy hapa prapa.*” është:
- emër
 - ndajfolje
 - parafjalë

PLANIFIKIMI ORËS MËSIMORE 1, 2

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tematika: - Të lexuarit - Tekstet përshkruese Ora I Tema mësimore: Tekstet përshkruese Ora II Tema mësimore: Analizë teksti përshkrues		Situata e të nxënit: - Përshkruani me një paragraf një personazh nga letërsia ose kinematografia.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none">• Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit• Kompetenca e të menduarit• Kompetenca e të nxënit• Kompetenca personale• Kompetenca qytetare• Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- dallon karakteristikat strukturore të tekstit përshkrues;- dallon karakteristikat stilistike dhe gjuhësore të tekstit përshkrues;- krahason tiparet midis teksteve përshkruese;- analizon realizimin e përshkrimit sipas perceptimit shqisor;- interpreton ndërtimin gjuhësor të tekstit përshkrues.		Fjalët kyçe: - përshkrim objektiv; përshkrim subjektiv; detaje përshkrimi; teknika përshkrimi; strukturë e tekstit përshkrues; perceptim shqisor.	
Burimet: materiale të shtypit të shkruar, modele komunikimi, libri i nxënësit, tabela, fleep-charter, shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë ndërveprimi).		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - TIK; Qytetari; Histori.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Përvijim i mendimit, Të nxënit ndërveprues, Stuhi mendimi, Hartë konceptesh, Diagrame Veni, Punë në grup, Praktikë e drejtuar.</i>			
ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT			
Pjesa e parë e orës: (45 minuta) Veprimtari paraprake: Stuhi mendimi			
Dëgjoni fragmentin dhe përgjigjuni pyetjeve. ...Kur Robert Elsie erdhi për herë të parë në Shqipëri më 1978 për qëllime studimore, ai ishte 27-vjeçar dhe e dinte gjuhën shqipe, e kishte mësuar në mënyrë autodidakte. Nga ajo kohë e deri në tetor të 2017-s, kur Robert Elsie iku nga kjo jetë, janë mbushur 40 vjet. Këto 40 vjet Robert Elsie i ka mbushur me shumë përkushtim, zell, punë, pasion, mbi të gjitha me shumë dashuri për shqiptarët, për gjuhën e kulturën e tyre, për të shkruarën e të tashmen e tyre. Këtë më së miri e dëshmojnë veprat e tij të botuara në gjuhën shqipe, por më të shumtat në gjuhë të huaja, në anglishte...			



- Cili është referenti në fragmentin e mësipërm?
- Mbi bazën e cilave shqisa përshkruhet në fragment?

- **Ndërtimi i njohurive të reja:** Përvijim i mendimit

Përkufizimi	Përshkrimi objektiv	Përshkrimi subjektiv
Tekstet përshkruese janë tekste, në të cilat përshkruhen karakteristikat dhe tiparet e njerëzve (dhe të veprimtarive të tyre), të objekteve, vendeve (peizazheve, dukurive), mjediseve etj.	Përshkrimi në mënyrë teknike ose shkencore, dukuri apo sende të ndryshme.	Përshkrimi realizohet nisur nga këndvështrimi dhe përshtypjet personale e ndjenjat e tekstshkruesit, kemi të bëjmë me përshkrim subjektiv .

- **Hartë konceptesh**

Detaje të përshkrimit	Karakteristika gjuhësore e stilistike të teksteve përshkruese
Paraqitja e personit: Kush është? Çfarë moshe ka? Me çfarë merret?	Përdorimi i mbiemrave që shënojnë cilësitë e tiparet e personit/personazhit që po përshkruhet.
Përshkrimi i paraqitjes së jashtme: gjatësia, fytyra, flokët, tiparet fizike të trupit.	Përdorimi i foljeve në kohën e tashme ose në të pakryerën, për të treguar dukuri e tipare që zgjasin në kohë.
Përshkrimi i veshjes që mban zakonisht ky njeri.	Përdorimi i ndajfoljeve dhe i lokucioneve ndajfoljore.
Përshkrimi i karakterit, i humorit, i gjendjes shpirtërore.	Përdorimi i fjalëve, i frazave dhe i fjalive të larmishme.
Përshkrimi i disa cilësive dhe të metave.	Përdorimi i krahasimeve dhe i metaforave.
Përshkrimi i sjelljes dhe i zakoneve në situata të ndryshme.	Përdorimit i kursyer i figurave letrare.

- **Punë e pavarur/ Punë në grup**

- **Grupi i parë:** Gjeni dhe nënvizoni në tekstin e dhënë pjesët ku përshkruhen cilësitë morale, sjellja dhe zakonet e Robert Elsie-t.

- **Grupi i dytë:** Argumentoni nëse përshkrimi në tekstin për R. Elsie-n është objektiv apo subjektiv.

- **Grupi i tretë:** Cilat karakteristika gjuhësore e stilistike të teksteve përshkruese shfaqen në tekstin e mësipërm.

ORA II: Analizë teksti përshkrues

Veprimtari paraprake: Praktikë e drejtuar

Trajta patetike e heroit. E tillë mund të përfytyrohet gënjeshtria e tij e mermertë, një legjendë piktoreske: kryet e heroit që pritet ngultas përpara, një ballë i lartë, i fryrë, i brazduar tejendane prej mendimesh të zymta, një perçe e valëzuar flokësh që i derdhet qafës së plote e muskuloze. Përmes vetullave vëngoshe i shkrepin një vështrim fajkoi, çdo muskul mbi atë fytyrë energjike shpreh vullnet, shëndet, fuqi. Mustaqet që i gremisen buzëve të rrepta burrërore dhe gusha simpatike, të ngjallin në kujtesë fizionominë e luftëtarit të hordhive barbare, ashtu si, padashur, ajo kokë e madhe prej luani të ndërmend portretin e frikshëm e kanosës të një vikingu, me bri, mburojë dhe shtizë ndër duar.

Nën drejtimin e mësueses analizohen mbiemrat e përdorur. Cili është funksioni i tyre në përshkrim?

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim dhe koment

Lexohet fragmenti në faqen 11. Gjatë leximit komentohen fjalitë e paqarta për nxënësit. Shkruhen në tabelë fjalët e reja dhe përdoren në kontekste të ndryshme si shembuj.

vetullave vëngoshe – këtu: të pjerrëta.

portretin e frikshëm e kanosës – kërcënues.

heremit – njeri i vetmuar, që rron larg njerëzve, duke hequr dorë nga qejfet e kënaqësitë e tjera.

hamendas – në mënyrë të përafërt.

spazmodik – tkurrje e menjëhershme, e zgjatur dhe e pavullnetshme e një muskuli.

- **Punë e pavarur/ Punë në grup**

- **Grupi i parë:** Gjeni në “Fjalorin e gjuhës shqipe” kuptimin e fjalëve të nënvizuara në tekst.

Grupi i dytë: Ushtrimi 3

Aspekti fizik	Karakter, humori, gjendja shpirtërore
Kryet e heroit që pritet ngultas përpara, një ballë i lartë, i fryrë, i brazduar tejendane prej mendimesh të zymta, një perçe e valëzuar flokësh që i derdhet qafës së plotë e muskuloze.	Vetëm nervat i ka tejet të brishtë përkundrejt fantazisë vullkanike, andaj dhe gjithmonë e gjen të acaruar (kjo gjendje, megjithatë nuk ia lëkund dot vullnetin e hekurt).

Grupi i tretë: Ushtrimi 4

I b. njerëzit që nuk i besojnë sa duhet Niçes.

II b. në ballë i lexohen mendime të zymta.

III c. syzeve.

IV a. Niçja nuk ka kohë të mjaftueshme që të kujdeset për rregullat...

Vlerësimi:

Nxënësit/et do të vlerësohen:

- për pjesëmarrjen në diskutime;
- për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;
- për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;
- për përgjigjet e dhëna për ushtrimet e punuara.

Detyrë shtëpie:

- **Grupi i parë:** Përshkruani këngëtarin Rita Ora, pasi të keni kërkuar në internet informacione për të dhe karrierën e saj.

- **Grupi i dytë:** Gjeni nga një libër filozofie ose nga interneti më tepër informacion rreth konceptit të “Mbinjeriut” të Niçes. Mandej gjeni dhe shpjegoni se si e ndërkall Cvajgu këtë koncept në përshkrimin e tij për vetë Niçen.

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Morfologji Ora I Tema mësimore: Fjala dhe morfema Ora II Tema mësimore: Llojet e morfemave		Situata e të nxënit Tekst nga Naum Prifti	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore 1: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">veçon tiparet e përbashkëta dhe të veçanta të fjalës dhe morfemës;dallon morfemat në një fjalë. Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore II: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">dallon morfemat trajtëformuese nga morfemat fjalëformuese.		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none">morfemë, fjalë, morfemë ndajshesore, morfemë trajtëformuese, morfemë fjalëformuese;parashtesë, prapashtesë, nyjë, rrënjë, mbaresë.	
Burimet: Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë, Fjalori i gjuhës Shqipe, FESH, videoprojektor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Stuhi mendimi, Pemë mendimi, Diagrame Veni, Hulumtim, Punë e pavarur/në grup</i>			
<div>ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</div> <div><i>Pjesa e parë e orës (45 minuta)</i></div> <div><i>Veprimtari paraprahe</i></div> <div>Me teknikën “Stuhi mendimi” u kërkohet nxënësve të shprehin çfarë dinë për <i>fjalën</i> si njësi më e vogël e mëvetësishme e gjuhës.</div>			

Njësi themelore e gjuhës

Kryen funksione sintaksore në fjali.

FJALA

Mund të ndahet në njësi më të vogla me
kuptim (morfema).

Ndërtimi i njohurive të reja:

Mësuesi/ja paraqet në tabelë veçoritë e fjalës dhe të morfemës, të cilat më pas vendosen në Diagramë Veni.

Fjala	Morfema
Është njësi e mëvetësishme.	Nuk është njësi e mëvetësishme.
Mund të ndahet në njësi më të vogla me kuptim (morfema).	Është e pandashme në njësi më të vogla me kuptim.
Kryen funksione sintaksore në fjali.	Nuk mund të kryejë funksione sintaksore në fjali.

**Të mbajmë mend!**

- ✚ Shumica e fjalëve mund të ndahen në morfema, që janë bartëse të kuptimeve leksikore ose gramatikore.

Nxënësit shkruajnë diagramet dhe tabelat në skedë ose në bllokun e gramatikës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Në mënyrë të pavarur nxënësit punojnë:

- Ushtimi 1. fq. 16 - Veçojnë fjalët që përbëhen nga një morfemë e vetme, duke i ndarë në emra dhe folje.
- Ushtimi 6. fq. 17 - Nxënësit gjejnë nga sa morfema përbëhen fjalët e nënvizuara duke treguar se cilës klase fjalësh i përket.

Punë në grup Usht. 5, f. 17.

Dy grupe nxënësish me nga dy vetë u jepet *Fjalori i Gjuhës shqipe* dhe u kërkohet të gjejnë disa fjalë që përbëhen nga një morfemë e vetme. Më pas ato shkruajnë disa shprehje të figurshme.

(Në rastet kur në klasë ka videoprojektor, mësuesi/ja paraqet Fjalorin Elektronik (FESH) dhe punon së bashku me nxënësit për të gjetur disa fjalë që përbëhen nga një morfemë e vetme.

Pjesa e dytë e orës (45 minuta)

Ndërtimi i njohurive të reja: “Punë në grup”, “Stuhi mendimi”.

Lexohet fragmenti në faqen 21 nga nxënësit dhe të ndarë në grupe u kërkohet të nënvizojnë morfemat në disa fjalë të zgjedhura.


Ai flamur kishte qenë gjithmonë aty, mbi atë tokë. S’ ishte valëzuar mbi ndërtesa qytetare, mbi ballkone shtëpish e strehë dyqanesh, po për të qenë ishte kudo, i gdhendur, i qëndisur, i vizatuar, i skulpturuar, i endur e i filigramuar gjendej në qytat e pushkëve të gjata, në dorezat e revoleve, në kutitë e duhanit në jelekët e nuseve, në pajat e çupave, te koka e djepave të fëmijëve, në qilimat e odave, te dorezat e bastunëve të pleqve.... tek shpresat e maleve ku fluturonte e lirë në qiell e në yjet, sipër tokës amtare. Ajo që edhe e mbërthyer, edhe e lirë, edhe e ngurosur, edhe e lëvizshme. Që një shqipe që nuk vritej se rronte në ëndrrat, në qelizat, në zemrat e njerëzve.

(N. Prifti)

Ndërkohë që nxënësit punojnë në grupe, mësuesi/ja me teknikën “Stuhi mendimi” specifikon disa veçori për morfemën si njësi e kuptimshme e gjuhës dhe ndërton diagramin e llojeve të morfemave.


Njësi e kuptimshme e gjuhës

Çdo fjalë ka të paktën një morfemë rrënjore.




Morfema rrënjore mbart kuptimin leksikor të fjalës.

Diagrami i llojeve të morfemave.



Morfema ndajshesore



Të mbajmë mend!

✚ Morfema rrënjore mbart kuptimin leksikor të fjalës.


Morfemat ndajshesore shërbejnë për të formuar forma të reja fjalësh dhe fjalë të reja.

Kujdes!

Duhet dalluar morfemat ndajshesore fjalëformuese (që formojnë fjalë të reja) nga morfemat ndajshesore trajtëformuese (që formojnë forma fjalësh).

Nxënësit shkruajnë diagramet dhe rregullat në skedë ose në bllokun e gramatikës.

Diskutohet puna në grupe me nxënësit, nënvizimi i morfemave në fjalët e përzgjedhura në tekst. Më pas ndërtohet Diagrami i Venit për të treguar rolin që luan parashtesa dhe prapashtesa.



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Në mënyrë të pavarur dhe në grup zhvillohen ushtrimet:

- Ushtrimi. 2, f. 22. Gjeni prapashtesën dhe përcaktoni nëse është trajtëformuese apo fjalëformuese.
- Ushtrimi. 7, f. 23. Analizoni nga pikëpamja morfemore fjalët e nënvizuara.

Dy nxënës zhvillojnë ushtrimin 5 në tabelë: Formimi i fjalëve të prejardhura nga mbiemrat e nyjshëm, nënvizimi i morfemave ndajshesore dhe përcaktimi se cilës klase fjalësh i përkasin fjalët e krijuara.

Për mësuesit material ndihmës për këtë temë mësimore.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 135-137.

Fjalëforma është forma konkrete gramatikore e një fjale në një fjali të dhënë.

Në fjalinë “Njeriu zbukuron vendin dhe vendi njeriun” ka pesë fjalëforma: *njeriu e njeriun* (fjalëforma të emrit njeri), *vendi e vendin* (fjalëforma të emrit vend) dhe *zbukuron* (fjalëformë e foljes zbukuroj). Megjithëse fjala dhe morfema janë të dyja njësi të kuptimshme të gjuhës, ato kanë dallime të qenësishme ndërmjet tyre.

Fjala është njësi leksiko-gramatikore (ka kuptim leksikor, formë gramatikore dhe në një fjali të dhënë kryen një funksion sintaksor të caktuar. Në varësi nga këto tri tipare çdo fjalë klasifikohet në një nga pjesët e ligjëratës.

Fjala është njësi e mëvetësishme e gjuhës, morfema nuk e ka këtë mëvetësi, ajo ekziston brenda strukturës së fjalës. Fjala mund të ndahet në morfema, kurse morfema është e pandashme në njësi më të vogla të kuptimshme.

Morfema, si njësi e fjalës, nuk ka kuptim të plotë, nuk është e formësuar morfologjikisht ashtu si fjala dhe nuk mund të kryejë funksione sintaksore.

Format e ndryshme të së njëjtës morfemë quhen *alomorfe*.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit, që dallojnë llojet e morfemave, bëjnë analizën morfemore të fjalëve si dhe ato nxënës që krijojnë fjalë të reja me parashtesa dhe prapashtesa njëkohësisht.

Detyrë shtëpie:

Usht. 9, f. 23. – Shkruani një kronikë të shkurtër, duke përdorur sa më shumë fjalë jo të thjeshta.

PLANIFIKIMI ORËS MËSIMORE 5, 6

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tematika: Të shkruarit Ora I Tema mësimore: Përshkrimi i një personi		Situata e të nxënit: Lexohen fragmente të shkurtra përshkruese.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none">• Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit• Kompetenca e të menduarit• Kompetenca e të nxënit• Kompetenca personale• Kompetenca qytetare• Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- shkruan një ese përshkruese për një person duke respektuar temën e shkrimit;-shkruan një ese përshkruese për një person duke respektuar strukturën e saj përkatëse;- shkruan një ese përshkruese për një person duke synuar stil dhe origjinalitet krijues.		Fjalët kyçe: hyrje-zhvillim-mbyllje; mbiemra dhe ndajfolje; detajet përshkruese.	
Burimet: - materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-charter</i> , shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë ndërveprimi).		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - TIK; Qytetari; Histori.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Të nxënit ndërveprues, Stuhi mendimi, Leksion i përqendruar, Punë e pavarur</i>			
ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT			
Pjesa e parë e orës (45 minuta) <ul style="list-style-type: none">• Veprimtari paraprake: Stuhi mendimi• Lexohet një fragment i shkurtër përshkrues dhe shkruhet në tabelë informacioni i marrë nëpërmjet përshkrimit.			
”Një trup i përsosur, e hirshme e me zemër fisnike, me mendje artisti e mendimtari. Këto tri veti të marra së bashku janë të rralla për t’u gjetur te një njeri, madje edhe vetëm njëra prej tyre, por të gjitha së bashku përbëjnë diçka të veçantë. Vetëm fati mund ta krijojë këtë mrekulli; dhe kjo mrekulli që kishte krijuar natyra ishte në gjendje t’i përhapte të gjitha ato virtyte të mëdha dhe të ndryshme, kjo mrekulli e kishte emrin Elena Gjika, e cila më pas e pagëzoi veten, në botën e letërsisë, me një emër të dytë edhe më të njohur, Dora D’Istria”.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Leksion i përqendruar Planifikimi i esesë përshkruese Hartimi i esesë përshkruese			
Eseja përshkruese informuese		Eseja përshkruese shprehëse	
Nuk duhet të jepni në asnjë mënyrë opinione, përshtypje apo ndjesi personale. Përdorni gjuhë		Gjallëria e përshkrimit arrihet duke përshkruar ndjesitë që merrni nga të pesta shqisat. Mos u	

asnjanëse, pa e tepruar me figura letrare, dhe fraza sa më të qarta e të ngjeshura.	kurseni për të shprehur ndjenjat, përshtypjet, opinionet dhe vlerësimet vetjake.
<p>Rishikimi i esesë përshkruese</p> <p>- Leximi i parë: kontrolli i përmbajtjes</p> <p>- Leximi i dytë: kontrolli i formës</p> <p>Lexohet esesa përshkruese “Dora D’Istria në Firenze” dhe analizohen elementet e saj strukturore.</p> <p>Punë e pavarur/ Punë me shkrim: Eseja përshkruese</p> <p>Përzgjidhni një nga temat e mëposhtme për të shkruar një ese përshkruese subjektive.</p> <p>- “Njeriu që ka ndikuar pozitivisht në jetën time”</p> <p>- “Miku im”</p> <p>- “Karakter i personazhit që më pëlqen më shumë”</p>	
<p>Vlerësimi:</p> <p>Nxënës/et do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • për shkrimin e esesë sipas formatit të kërkuar; • për shkrimin e esesë duke përdorur gjuhë korrekte; • për fjalorin e përdorur gjatë shkrimit të esesë; • përdorimi i mjeteve stilistike në paragrafë subjektivë përshkrues. 	
<p>Tematika: Të dëgjuarit</p> <p>Ora II</p> <p>Tema mësimore: Të dëgjuarit për të kuptuar dhe për të reflektuar</p>	<p>Situata e të nxënit:</p> <p>- Në formën e një loje, nxënës/et drejtojnë pyetje njëri-tjetrit dhe reflektojnë rreth përgjigjeve të dëguara.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit • Kompetenca e të menduarit • Kompetenca e të nxënit • Kompetenca personale • Kompetenca qytetare • Kompetenca digjitale 	
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënës/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor strategjitë e të dëgjuarit dhe kupton tekste të llojeve të ndryshme; - bën identifikimin e tipareve të formës e të përmbajtjes së teksteve; - mban shënime të atilla që demonstrojnë të dëgjuarit e qëllimshëm; - analizon qëllimin e folësit ose të mesazhit që dëgjon. 	<p>Fjalët kyçe:</p> <p>- komunikim i përditshëm; vëmendje; reagim emocional; dëgjues i efektshëm; përmbledhje informacioni.</p>
<p>Burimet:</p> <p>- materiale dëgjimore, CD, libri i nxënës/it, tabela, <i>fleep-charter</i>, shënimë me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë ndërveprimi (interaktive).</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>- TIK; Qytetari; Histori.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p><i>Diskutim njohurish paraprake, Stuhi mendimi, Punë në grup, Leksion i përqendruar, Përmbledhje e strukturuar.</i></p>	

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT

Pjesa e parë e orës (45 minuta)**Veprimtari paraprahe/ Diskutim njohurish paraprahe**

A e kuptojmë gjithmonë atë që dëgjojmë? A e lidhim informacionin e dëgjuar me jetën e përditshme dhe me përvojat tona personale?

Dëgjoohen mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Përmbledhje e strukturuar

Përkufizim konceptor: Të dëgjuarit është një aftësi e rëndësishme. Përgjithësisht, ne jemi përballur me pyetje që verifikojnë aftësinë tonë për të mbajtur mend atë që kemi dëgjuar.

Tiparet e të dëgjuarit për të kuptuar dhe për të reflektuar

Kuptojmë edhe ndjenjat dhe emocionet e folësit.

Ne mund ta ritregojmë me fjalët tona tekstin e dëgjuar.

Toni i zërit, ndalesa midis fjalëve, theksi i fjalës dhe i fjalisë, ritmi dhe mënyra e të folurit ndikojnë te dëgjuesi.

Të dëgjuarit është një burim i pasur për ta përdorur informacionin e marrë prej tij

Punë e pavarur/ Punë në grupe

Grupi i parë: Ushtrimi 1 dhe 2

Grupi i dytë: Ushtrimi 3

Grupi i tretë: Dëgjoni fragmentet e teksteve dhe përgjigjuni pyetjeve të ushtrimit 4.

Teksti përshkrues

A. Xhuvani ka qenë i rrafshët e i thjeshtë në jetë e në marrëdhëniet e tij me të tjerët. Besnik i parimit tonë për të vënë të gjitha forcat në shërbim të shoqërisë, duke i dhënë gjithnjë më shumë asaj sesa t'i marrë, ai ka vepruar gjithherë ashtu që interesi i përgjithshëm tek ai e ka lënë shumë mbrapa interesin personal, si në jetë, si në fushë të dijes. ...Punëtor metodik e i palodhur deri në fund të jetës së tij, ai, më anë tjetër, në bashkëpunim e në diskutime ka qenë gjithmonë i matur e i durueshëm në dëgjim të mendimit edhe të të tjerëve, gjë që e lejonte të arrinte në përfundime shkencore objektive, dhe që e bënte të lehtë bashkëpunimin me të...

Ai si njeri mbeti një humanist i vërtetë, një burrë përparimtar në kuptimin fisnik të kësaj fjale. Të dy këta dijetarë ishin të një brumi moral.

Teksti argumentues

Emrin shqip, Shqiptar G. Meyer e lidh me foljen shqiptoj dhe këtë e nxjerr nga latinishtja: *excipio* "ndiej, dëgjoj", kështu që Shqiptar do të thotë: "ai që kupton".

Përkundrazi M. Lamberti emrin e sheh të ardhur nga shqiponja, prej kohës së Skënderbeut. Mendimi i këtij dijetari austriak ka të ngjarë të jetë i drejtë, dhe është i pranuar prej të shumtëve. Me të vërtetë shqiponja gëzon një nderim ndër Shqiptarë dhe konsiderohet si shpendi kombëtar i tyre: emrin e saj shqip e gjejmë te Buzuku, te Bardhi, si dhe te shqiptarët e Greqisë.

Teksti informues

Dokumenti më i rëndësishëm i gjuhës së shkruar (letrare) në këtë etapë, është vepra "**Meshari**" (1555), e **Gjon Buzikut**, kopja origjinale e së cilës ruhet në Bibliotekën e Vatikanit. Libri përmban meshat e të kremteve kryesore të vitit, pjesë të Ungjillit e të katekizmit etj., të përkthyer ose të përshtatura mirë në shqip. Duke vëzhguar gjuhën e veprës së Buzikut, vërejmë se ajo është shkruar në gegërisht, me alfabetin latin. Bie në sy pasuria e formave në strukturën gramatikore, përdorimi i një drejtshkrimi të qëndrueshëm, ndërsa alfabeti nuk duhet të jetë krijuar prej autorit, sepse në *Pasthënie*, atje ku ai na rrëfen qëllimin pse e shkroi veprën dhe na jep pak të dhëna për jetën e vet, nuk flitet fare për vështirësi të hasura prej tij në punë të alfabetit.

Teksti udhëzues

Përdorni faqe interneti të njohura. Përdorni një faqe të sigurt, pa u shpërndarë prej motorëve të kërkimit. Rezultatet në motorët e kërkimit mund të manipulohen, duke ju dërguar kështu në një rrugë të gabuar, sidomos kur keni kaluar disa faqe tek ky i fundit.

Kontrolloni llogarinë tuaj bankare.

Përdorni fjalëkalime të forta.

Tekst jolettrar

Asgjë nuk është më e zorshme për një të huaj sesa të njohë thelbin e karakterit të një populli. Për të njohur karakterin e një populli, natyrën e tij të vërtetë, duhen njohur fare mirë gjuha e tij, doket dhe zakonet. Vetëm atëherë para vëzhgongjësit populli mund të shfaqet natyrshëm, thjesht, pa artificialitet dhe shpenguar.

Jetova shumë vjet midis shtresash të ndryshme të popullit të Shqipërisë së Veriut. Malësorët e këtij vendi më shikonin më në fund plotësisht si njeriun e tyre, kështu që më pranonin në lodrat e tyre dhe më jepnin të drejtën të shprehja lirisht mendimin tim në çështje private.

Tekst letrar

Po lumtërija e Tatës nuk ish e plotë. Një sëmundje e ligë i bluante ças për ças jetën Kalijes, së shoqes. Dhe si ia bluante e bënte dita ditës më të ëmbël, sa nuk e shihnte dot me sy as sa të nëmëronje një, dy, tri. Sepse fytyra e saj vishej në një pah drite si drita e hënës mbi ujra. Po drita e hënës është pa jetë, kurse drita që mbulonte fytyrën e Kalijes ish e gjallë. Ajo kish po në atë kohë edhe bukurinë e të vdekurit edhe të të gjallit.

Vlerësimi:

Nxënësit do të vlerësohen për:

- tregimin e respektit, empatisë (ndjeshmërisë) dhe interes ndaj folësit;
- demonstrimin e vullnetit gjatë kryerjes së detyrave;
- përgjigjet e tyre të sakta rreth fragmenteve të dëgjuara;
- respektimin e parimeve, vlerave, bindjeve dhe kulturës së të tjerëve.

PLANIFIKIMI ORËS MËSIMORE 7, 8

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Sintaksë Ora I: Tema mësimore: Fjalja e thjeshtë dhe fjalja e përbërë Ora II: Tema mësimore: Fjalja e përbërë me bashkërenditje		Situata e të nxënit Teksti “ <i>Fizionomia e dyfishtë</i> ”	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore 1 Nxënësi/ja: - përcakton tiparet e fjalisë së thjeshtë dhe ato të fjalisë së përbërë;		Fjalët kyçe: Fjali e thjeshtë, fjali e përbërë, fjali e përbërë me bashkërenditje; lidhëza, fjalë lidhëse; marrëdhënie këpujore, kundërshtore, veçuese, përmbyllëse.	

<p>- analizon tiparet e përbashkëta dhe tiparet e veçanta mes fjalisë së thjeshtë dhe fjalisë së përbërë;</p> <p>- dallon marrëdhëniet kuptimore dhe lidhjet sintaksore që realizohen në fjalinë e thjeshtë dhe në fjalinë e përbërë.</p> <p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore II</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <p>- dallon llojin e fjalive me bashkërenditje;</p> <p>- ndërton fjali të përbëra me bashkërenditje këpujore, kundërshtore, veçuese, përmbyllëse.</p>	
<p>Burimet:</p> <p>Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë, videoprojektor.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Letërsi, TIK</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p><i>Stuhi mendimi, Puna me fisha, Pemë mendimi, Diskutim, Punë e pavarur/në grup.</i></p>	
<p style="text-align: center;">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p><i>Pjesa e parë e orës (45 minuta)</i></p> <p><i>Veprimtari paraprake</i></p> <p style="padding-left: 40px;">– (Puna me fisha)</p> <p>U shpërndahen nxënësve fisha me fjali të ndryshme. Fishat mund të paraqiten edhe në videoprojektor, ose flipçart. U kërkohet nxënësve të gjejnë kallëzuesit dhe të përcaktojnë nëse fjalia është e thjeshtë apo e përbërë.</p> <p>Fisha 1.</p> <div style="border: 1px solid black; padding: 10px; margin: 10px 0;"> <p>Dëshira për t’u kthyer sërish në atë qytet të lashtë, të ndërtuar rrëzë mali si me magji e <u>mbërthente</u> herë pas here e gjithnjë e më shpesh, sidomos kohëve të fundit.</p> </div> <p>Fisha 2.</p> <div style="border: 1px solid black; padding: 10px; margin: 10px 0;"> <p>Nuk <u>shkonte</u> ditë pa menduar për atë vend.</p> </div> <p>Fisha 3.</p> <div style="border: 1px solid black; padding: 10px; margin: 10px 0;"> <p><u>Vendosi të kthehej.</u></p> </div>	

Fisha 4.

Nga një cep i dritares vështronte me kureshtje kalimtarët e shumtë.

Fisha 5.


Sa herë i afrohej dritares, vështronte që andej me kureshtje kalimtarët e shumtë.

Nxënësit nënvizojnë kallëzuesit dhe së bashku me mësuesin/en analizohen:

Fjalja I	- E thjeshtë	(mbërthej-kallëzues)
Fjalja II	- E thjeshtë	(shkoj-kallëzues)
Fjalja III	- E përbërë	(vendosi, të kthehej-kallëzues)
Fjalja IV	- E thjeshtë	(vështronte-kallëzues)
Fjalja V	- E përbërë	(afrohej, vështronte-kallëzues)

Ndërtimi i njohurive të reja: “Diagram Veni”

Me Diagram Veni tregohen tipare të përbashkëta mes fjalisë së thjeshtë dhe fjalisë së përbërë.



Nxënësit shkruajnë diagramet dhe shembujt në skedë ose në bllokun e gramatikës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Në mënyrë të pavarur lexohet teksti në ushtrimin 1 fq. 26, dallohen fjalitë e thjeshta nga ato të përbëra, duke u nënvizuar kallëzuesit.

Punë në grup

Usht.4, f. 26 - Në tekstin “*Fizionomia e dyfishtë*”, nxënësit në grupe dallojnë fjalitë e thjeshta dhe ato të përbëra, duke nënvizuar kallëzuesit.

Pjesa e dytë e orës (45 minuta)


Veprimtari paraprake

Nxënësit dallojnë pohimet e sakta (V) dhe ato të gabuara (x):

- Një fjali e thjeshtë ka më pak fjalë se një fjali e përbërë.
- Kriteri për dallimin e një fjalie të thjeshtë nga ajo e përbërë, është numri i kallëzuesve të fjalisë.
- Një fjali me dy kallëzues homogjenë është fjali e thjeshtë.
- Në një fjali të përbërë nuk mund të ketë dy a më shumë kallëzues pa asnjë kryefjalë të shprehur.
- Si fjalia e thjeshtë, ashtu dhe ajo e përbërë janë njësi kumtuese.

Ndërtimi i njohurive të reja: “Pemë mendimi”

Mësuesi/ja ndërton diagramin e klasifikimit të fjalive të bashkërenditura.



Nxënësit shkruajnë diagramet në skedë ose në bllokun e gramatikës.

Diskutim mbi disa pohime: të sakta/të gabuara.

<ul style="list-style-type: none"> - Pjesët e fjalive të bashkërenditura mund të lidhen me ose pa lidhëza. - Rendi i fjalive të bashkërenditura është gjithnjë i lirë. - Kudo ku përdoret lidhëza “dhe” kemi të bëjmë me fjali të bashkërenditura. - Pjesët e fjalive të bashkërenditura mund të qëndrojnë si fjali më vete. - Pjesët e fjalive të bashkërenditura mund të futen në trup të njëra-tjetrës. - Për bashkëlidhjen e pjesëve të fjalisë, rol të veçantë ka edhe koha e foljeve-kallëzues. - Lidhje barazie mes pjesëve të fjalisë do të thotë se asnjëra pjesë nuk varet prej tjetrës. 	
<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup</p>	
<p>Në mënyrë të pavarur dhe në grup zhvillohen ushtrimet:</p>	
<p>- Ushtrimi 2, fq. 31 – Dallimi i fjalive bashkërenditëse, nënvizimi i mjeteve lidhëse.</p>	
<p>- Ushtrimi 3, fq. 31 – Dallimi i fjalive bashkërenditëse nga fjalitë e thjeshta me kallëzues homogjenë.</p>	
<p>Ushtrimi 4, fq. 31 – Ndërtimi i fjalive me pjesë të bashkërenditura me marrëdhënie <i>këpujore</i>,</p>	
<p><i>kundërshtore</i>, <i>veçuese</i> dhe <i>përmbyllëse</i>.</p>	
<p>Vlerësimi:</p>	
<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësohen nxënësit, që dallojnë marrëdhëniet kuptimore dhe lidhjet sintaksore që realizohen në fjalinë e thjeshtë dhe në fjalinë e përbërë. • Vlerësohen nxënësit, që dallojnë llojin e fjalive me bashkërenditje; ndërtojnë fjali të përbëra me bashkërenditje <i>këpujore</i>, <i>kundërshtore</i>, <i>veçuese</i>, <i>përmbyllëse</i>. 	
<p>Detyrë shtëpie:</p>	
<p>Usht. 5, f. 31. – Ndërtoni një tekst argumentues me temë: “Profesioni im i dashur”, në të cilin të përdorni gjerësisht të gjitha llojet e fjalive bashkërenditëse. Nënvizoni mjetet lidhëse.</p>	

PLANIFIKIMI I TEMËS MËSIMORE 9, 10

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Rubrika: - Të lexuarit Ora I Tema mësimore: Tekstet rrëfyese Ora II Tema mësimore: Analizë teksti rrëfyese		Situata e të nxënit: Rrëfëni shkurtimisht një ngjarje të ditëve të fundit. Si vepruat?	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none">• Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit• Kompetenca e të menduarit• Kompetenca e të nxënit• Kompetenca personale• Kompetenca qytetare• Kompetenca digjitale			

Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - analizon tekstin rrëfyes, veçoritë dhe strukturën e tij; - krahason tekste rrëfyese të llojeve të ndryshme; - identifikon karakteristika të formës të teksteve rrëfyese, si: hyrja, mbyllja, paragrafi, fragmenti; - analizon veçoritë gjuhësore të një teksti rrëfimtari.	Fjalët kyçe: teksti rrëfyes; rend kronologjik; strukturë ciklike; strukturë rrethore.										
Burimet: - materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit; tabela, fleep-charter, shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë ndërveprimi).	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - TIK; Qytetari; Histori.										
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Të nxënësve ndërveprues, Stuhi mendimi, Hartë semantike, Diagrame Veni, Punë në grup, Përmbledhje e strukturuar</i>											
<p style="text-align: center;">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <ul style="list-style-type: none"> Pjesa e parë e orës: Veprimtari paraprake/ Stuhi mendimi <p>Ata më zgjodhën dy herë senator, tri herë deputet, pesë herë përfaqësues të bashkësisë myslimane dhe një herë kryetar bashkie të Vlorës, pa qenë nevoja që unë të luaja edhe gishtin. Pa dashur të mburrem, mendoj se suksesi im te miqtë partiakë, te zgjedhësit dhe te populli, shpjegohet me dy bindje të miat: të mos e shpërdoroja kurrë besimin e tyre për të nxjerrë përfitim vetjak dhe të mos i tradhetoja ata kurrë.</p> <p style="text-align: right;">(Eqerem Bej Vlora, “Kujtime”)</p> <ul style="list-style-type: none"> <i>Cili është qëllimi i fragmentit që dëgjuat?</i> Ndërtimi i njohurive të reja: Hartë semantike/ Përmbledhje e strukturuar <p>Tekstet rrëfyese janë tekste në të cilat rrëfihen ngjarje, përvoja, përjetime, kujtime të caktuara që kane lidhje me njëra-tjetrën. Për këto ngjarje mund të rrëfëhet sipas një rendi kronologjik ose sipas një rendi të lirë, në varësi të zgjedhjes së autorit.</p> <table border="1" data-bbox="183 1384 1141 1556"> <tr> <td>Kush?</td><td>Kush është protagonist i ngjarjes?</td></tr> <tr> <td>Çfarë?</td><td>Ngjarja që ka ndodhur</td></tr> <tr> <td>Kur?</td><td>Koha kur kanë ndodhur ngjarjet</td></tr> <tr> <td>Ku?</td><td>Vendi ku janë zhvilluar ngjarjet</td></tr> <tr> <td>Përse?</td><td>Shkaqet që kanë ndikuar rrjedhën e ngjarjeve</td></tr> </table> <ul style="list-style-type: none"> Punë e pavarur/ Punë në grup <p>Grupi i parë: Lexoni tekstin e parë (Eqerem Bej Vlora, “Kujtime”) dhe nënvizoni foljet dhe shprehjet kohore. Në çfarë kohe dhe vete përdoren foljet dhe si përkon kjo me këndvështrimin e rrëfimtari të brendshëm?</p> <p>Grupi i dytë: Lexoni tekstin e dytë dhe kthejuni përgjigje pyetjeve në lidhje me të: Kush? Çfarë? Kur? Ku? Përse?</p> <p>Grupi i tretë: Lexoni me vëmendje tekstin e tretë dhe thoni nëse rrëfimi është objektiv apo subjektiv, duke u nisur nga karakteristikat gjuhësore dhe stilistike të tekstit.</p>		Kush?	Kush është protagonist i ngjarjes?	Çfarë?	Ngjarja që ka ndodhur	Kur?	Koha kur kanë ndodhur ngjarjet	Ku?	Vendi ku janë zhvilluar ngjarjet	Përse?	Shkaqet që kanë ndikuar rrjedhën e ngjarjeve
Kush?	Kush është protagonist i ngjarjes?										
Çfarë?	Ngjarja që ka ndodhur										
Kur?	Koha kur kanë ndodhur ngjarjet										
Ku?	Vendi ku janë zhvilluar ngjarjet										
Përse?	Shkaqet që kanë ndikuar rrjedhën e ngjarjeve										
Detyrë shtëpie: Rishkruajeni tekstin e dytë duke e realizuar rrëfimin në vetën e tretë njëjës, sipas këndvështrimit të rrëfimtari të jashtëm të gjithëdijshëm dhe duke i përdorur foljet në kohën e pakryer.											
<p style="text-align: center;">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p>Ora e dytë Analizë teksti rrëfyes: <i>Vizitë në Manastir</i> Veprimtari paraprake</p>											

Cilat janë karakteristikat gjuhësore të tekstit rrëfyes?

1. Foljet e tekstit rrëfyes, si rregull, përdoren në një prej kohëve të së shkuarës, si p.sh.: në kohën e kryer të thjeshtë, në të pakryerën etj.

2. Në tekstet rrëfyese vihet re përdorimi i ndajfoljeve dhe i lokucioneve ndajfoljore të kohës.

Ndërtimi i njohurive të reja:

Lexohet fragmenti duke u ndalur tek tiparet e tij si:

- veta e rrëfimit;
- objektiviteti dhe subjektiviteti i rrëfimit;
- qëllimin e rrëfimitares;
- vendin dhe kohën e zhvillimit të rrëfimit.

Punë e pavarur

Ushtrimi 2: Çfarë dini për Kongresin e Manastirit dhe çfarë rëndësie ka ai në historinë e gjuhës shqipe?

Përgjigje: Kongresi i Manastirit (ose Kongresi i Alfabetit), ka qenë një konferencë akademike në qytetin e Manastirit, mes datave 14 nëntor – 22 nëntor 1908, për standardizimin e alfabetit të gjuhës shqipe.

Data 22 nëntor përbën tashmë një ditë të shënuar në Shqipëri, Kosovë, Republikën e Maqedonisë dhe në diasporën shqiptare, e njohur si *Dita e Alfabetit*. Përpara kongresit, gjuha shqipe përfaqësohej prej gjashtë ose më shumë alfabetesh, pa llogaritur nënvariantet.

Ushtrimi 8: Gjeni dy raste kur rrëfimtaria ndërkall në tekst citime ose thënie nga personalitete të njohura. Çfarë roli luajnë këto elemente?

Përgjigje: Këto elemente e bëjnë më të besueshëm, faktik dhe i japin frymëmarrje tekstit.

Vlerësimi:

Nxënësit/et do të vlerësohen:

- për pjesëmarrjen në diskutime;
- për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;
- për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna;
- për analizën e strukturës së tekstit rrëfyes.
për analizën gjuhësore të tekstit rrëfyes.

Detyrë shtëpie: Gjeni në internet ose në libra të ndryshëm informacione rreth qytetit të Manastirit dhe Kongresit të Manastirit.

PLANIFIKIMI I TEMËS MËSIMORE 11, 12

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Rubrika: Njohuri gjuhësore - Drejtshkrim Ora I: Tema mësimore: Drejtshkrimi i emrave të përveçëm të huaj Ora II: Tema mësimore: Drejtshkrimi i fjalëve me prejardhje të huaj		Situata e të nxënit Fragmente nga gazeta	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit			

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore I Nxënësi/ja: - dallon emrat e përveçëm të huaj dhe diskuton rreth trajtës së tyre në shqiptim dhe në shkrim; - shkruan drejt emrat e përveçëm me prejardhje të huaj. Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore II: Nxënësi/ja: - shkruan drejt fjalët me prejardhje të huaj.	Fjalët kyçe: - fjalë e huaj; - drejtshkrimi, emra të përveçëm të huaj; - emra me prejardhje të huaj.
Burimet: teksti mësimor, videoprojektor, tabelë, gazeta, “Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe”.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Letërsi, TIK

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Stuhi mendimi, Diskutim, Punë e pavarur/në grup, Ese 5-10’

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT
Veprimtari paraprake

Nxënësve u jepen fragmente të shkëputura në gazeta dhe u kërkohet të nënvizojnë të gjitha emrat e përveçëm të huaj në atë shkrim.

Ndërtohet në tabelë një “Stuhi mendimi” me të gjitha fjalët e gjetura nga nxënësit.


Ndërtimi i njohurive të reja:

Mësuesi/ja në dy tabela paraqet rregulla të drejtshkrimit të gjuhës shqipe dhe shembujt për secilin rast.

RREGULLA TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE	SHEMBUJ
- Emrat e përveçëm që në trajtën origjinale të tyre kanë grupet -ia-, -ie-, -io-, -iu- , me -i- të patheksuar në trup të tyre, shkruhen me -ia-, -ie-, -io-, -iu- dhe jo me -ja-, -je-, -jo-, -ju- : - Shkruhen me -ja-, -je-, -jo-, -ju- , emra të përveçëm, si:	Molieri, Tokio etj. Jeronim, Jerusalem, Jupiteri etj.

<p>- Emrat e përveçëm që në gjuhën nga vijnë kanë në trup të tyre togjet -aj-, -ej-, -oj-, -uj-, shkruhen me -j-. Kur këto togje dalin në fund të fjalës, në shqip, shkruhen me -i-:</p> <p>- Emrat e përveçëm me burim prej greqishtes së vjetër, që në këtë gjuhë kanë y (ipsilon), shkruhen me i:</p> <p>- Emrat me burim, kryesisht grek, latin që në trup të tyre kanë grupet -au-, -eu-, shkruhen edhe në shqip me -au-, -eu-:</p> <p>- Fjalët me burim nga latinishtja e nga gjuhët romane, si dhe nga greqishtja, të cilat në gjuhën shqipe kanë një -c- të ndjekur nga zanorja -e-, ose -i-, shkruhen me -c- dhe jo me -ç- a me -s-:</p> <p>-Shkruhen me -d-, -t- disa nga emrat e përveçëm grekë e romakë:</p> <p>-Shkruhen me -gj- e jo me -g- apo -xh-, emrat e përveçëm, si:</p> <p>- Fjalët e huaja që burojnë nga greqishtja e vjetër, nga latinishtja ose nga gjuhët romane dhe që në këto gjuhë kanë një -l- të thjeshtë ose dyfishe, shkruhen me -l- dhe jo me -ll-:</p> <p>-Shkruhen me -z- dhe jo me -s- emrat, si:</p>	<p>Azerbajxhan, Bajron, Lajpcig, etj.</p> <p>Havai, Shangai, Uruguai, Sidnei etj.</p> <p>Asiri, Bizant, Egjipt, Libi, Siri, Olimp etj.</p> <p>August, Aurora, Euripidi, Euro etj. Bëjnë përjashtim: Evropë, evropian etj.</p> <p>Barcelona, Cezari, Lukreci, Sicilia etj.</p> <p>Afërdita, Demetra, Herodoti, Iliada, Odiseu, Itaka, Prometeu etj.</p> <p>- Gjermani, Gjenevë, Gjenovë, etj.</p> <p>-Apolon, Atlantik, Altatida, Babiloni, Peleponez, Penelopa, Platoni etj.</p> <p>Azia, Brazili, Dionizi, Elisabeta, Ezopi etj.</p>
--	---

Diskutim

Diskutohet rreth pohimeve në ushtrimin 1 fq. 34.

Emrat e huaj në gjuhën shqipe shkruhen siç shqiptohen.

Emrat e huaj të përveçëm lakohen ndonëse mund të vijnë nga një gjuhë pa lakim.

Shqiptimi i emrave të huaj është gjithnjë i njëjtë me trajtën origjinale.

Për shkrimin e saktë të emrave të huaj, rëndësi të veçantë ka njohja e shqiptimit të tyre.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Në mënyrë të pavarur dhe në grup zhvillohen ushtrimet fq. 34, 35, duke u korrigjuar gabimet në emrat e huaj të shkruar.

Pjesa e dytë e orës (45 minuta)

Veprimtari paraprake

Nxënësit lexojnë në tabelë fjalë me prejardhje të huaj dhe e plotësojnë me shembuj të tjerë.

ia - italian	ja - plejadë
ie - ambicie	je - medalje
io - iluzion	jo - rajon
i	- analizë, himn, hiperbolë
au	- audiencë, auditor
eu	- euro
iu	- akuarium
oo	- alkool, koordinatë
c	- celebrim, celular
xh	- inxhinier, xhiro
zh	- grupazh
nj	- dinjitet, injorancë
rr	- arrogancë
sm	- disertacion
zm	- fantazmë

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Në mënyrë të pavarur dhe në grup zhvillohen ushtrimet fq. 47, 48, duke korrigjuar fjalët e shkruar gabim. Klasa ndahet në katër grupe.

Dy grupe përmes teknikës Ese 5-10' shkruajnë sa më shumë fjalë me prejardhje të huaj. Leximi i tyre më pas nga disa nxënës.

Dy grupe të tjera lexojnë dhe më pas diskutojnë materialin plotësues: “*Sugjerim për shkrimin e emrave të përveçëm të huaj*”, fq. 170, 171.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit që dallojnë fjalët e huaja të shkruara gabim, si dhe vlerësohen nxënësit që gjejnë gjegjëset e tyre në gjuhën shqipe.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 3, fq. 47. Dalloni fjalët e huaja në tekstin e dhënë.

PLANIFIKIMI ORËS MËSIMORE 13, 14

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Rubrika: Të folurit Njohuri gjuhësore - Morfologji Ora I: Tema mësimore: Përshtatja e gjuhës gjatë të folurit me qëllimin, temën dhe dëgjuesin Ora II: Tema mësimore: Mënyrat e formimit të fjalëve		Situata e të nxënit Prezantohet një sekuencë e të folurit në publik nga një personazh i njohur publik. Teksti “Dështaku”	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none">• Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit• Kompetenca e të menduarit• Kompetenca e të nxënit• Kompetenca personale• Kompetenca qytetare• Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore I Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- përshtat të folurit në publik me audiencën dhe qëllimin;- flet rreth një teme të caktuar në publik duke përmbyshur elementet përbërëse të tij;- menaxhon kohën dhe emocionet gjatë të folurit në publik me një tematikë të caktuar. Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore II Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- përcakton mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe;- dallon dhe analizon një fjalë që është formuar me prejardhje.		Fjalët kyçe: Të folurit në publik, qëllimi, audienca, emocionet, hulumtim, organizim, komunikim verbal, komunikim joverbal. <ul style="list-style-type: none">- prejardhje, parashitesë, prapashtesë;- përngjitja, paranyjëzimi, përbërja; konversion, mënyrë e përzier.	
Burimet: Materiale për diskutim, materiale audiovizive, teksti mësimor, CD shoqëruese e librit të mësuesit. Skeda, bllok gramatike, tabelë.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK Qytetari Histori Letërsi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Diskutim në bazë të fjalëve kyçe, Leksion i përqendruar, Punë në grupe, Rrjeti i diskutimit, Stuhi mendimi.</i>			

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT

Pjesa e parë e orës (45 minuta)

Veprimtari paraprake. “Diskutim në bazë të fjalëve kyçe”

Të folurit në publik, Komunikim verbal, Komunikim joverbal, Organizim i kohës dhe emocioneve.
Kërkohet nga nxënësit të lidhen fjalët e dhëna në mënyrë koherente.

Ndërtimi i njohurive të reja: Leksion i përqendruar

Shpjegohen tiparet e të folurit publik të renditura në tabelën e mëposhtme.

<i>Të folurit në publik</i>
<i>Emocionet</i>
<i>Arritja e qëllimit nëpërmjet të folurit në publik</i>
<i>Praktikë me të folurit</i>
<i>Themelet e të folurit në publik</i>
<i>Audienca</i>

Punë e pavarur. “Rrjeti i diskutimit”

Zhvillohet një diskutim me temën: “**Bulizmi në shkollë**”.

Vlerësoni njëri-tjetrin për të folurit e përshtatur me qëllimin dhe audiençën, duke respektuar kriteret e mëposhtme të vendosura në tabelë.

Kontrollimi i emocioneve	
Përshtatja e të folurit me audiençën	
Organizimi i materialit në përshtatje me qëllimin	
Përshtatja me reagimet e audiençës	
Komunikimi verbal me audiençën	
Komunikimi joverbal me audiençën	

Pjesa e dytë e orës (45 minuta)

Veprimtari paraprake

Lexohet teksti “Dështaku”, në faqen 52 (mund të paraqitet edhe me videoprojektor). Nënvizohen fjalët e prejardhura së bashku me nxënësit.

Nuk e kishte menduar se shtëpia është strehë e prehjes dhe mendimeve të lira, është vend i pavarësisë dhe paprekshmërisë; është vatër e gruas, familjes dhe vazhdimësisë së brezave dhe fisit, është djepi i gjuhës dhe kudhra e mprehjes së fjalës shqipe; është banka ku rrinë për të mësuar përrallën dhe këngën; është kutia e hirit të stërgjyshërve dhe foleja e traditës; është pragu ku qajmë e ku këndojmë; është shtrati i çlodhjes dhe i vrasjes së ndergjegjes; është jastëk i gjumit dhe i zgjimit; është çerdhja e kujtimeve të lindjeve dhe vdekjeve; është magje e gatimit të njeriut të njerëzishëm; është simbol i unitetit të qelizave të qenies; është pistë e nisjes së ritmeve të jetës... Kjo është shtëpia.

D. Agolli “Dështaku”


Fjalë të prejardhura: *stërgjyshërve, çlodhjes, njerëzishëm, prehjes, mprehjes, paprekshmërisë, vazhdimësisë etj.*

Ndërtimi i njohurive të reja: “Stuhi mendimi”

Me teknikën “Stuhi mendimi”, mësuesi/ja paraqet *formimin e fjalëve dhe llojet e prejardhjes*.



Llojet e prejardhjes.



Nxënësit shkruajnë diagramet në skedë ose në bllokun e gramatikës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: “Punë e pavarur dhe në grup”

Në mënyrë të pavarur dhe në grup zhvillohen ushtrimet:

- Ushtrimi 1, fq. 54 – Mënyra e formimit të fjalëve të prejardhura.
- Ushtrimi 2, fq. 54 – Formimi i fjalëve të reja.
- Ushtrimi 4, fq. 54 – Gjeni fjalët e formuara me prejardhje pa ndajshitesa.

Për mësuesit material ndihmës për këtë temë mësimore.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002.

Parashtesa në gjuhën shqipe		Prapashtesa në gjuhën shqipe	
a-	asimetri, apolitik, anormal, afetar	gjembaç, lugaç	-
an-	analfabet, analog	aç(e) aç	
anti-	antikombëtar, antipopullor	ujnajë, lisnajë, akullnajë	- ajë
auto-	autobiografi, autodidakt, autograf, autokritikë	durrsak, austriak, fierak, dështak	-ak
bashkë-	bashkëkohor, i bashkëngjitur	personal, gradual, tekstual	
bio-	biografi, biolog	-al	
ç-	çnjerëzor, i çrregullt, çregjistroj	shkodran, dibran	
de-	degradoj, demaskoj, deshifroj	-an (-jan)	
drejt-	drejtkëndor, drejtvizor	emigrant, kursant, muzikant	
filo-	filolog, filologji	-ant	
gjithë-	gjithëkombëtar, i gjithëpushtetshëm	librar, gazetar, kopshtar, argjendar	
		-ar	
gjysmë-	gjysmanalfabet, gjysmëkilësh	ditar, vjetar, dritare	
hidro-	hidroenergjetik	-ar(e)	
gjeo-	gjeomagnetik, gjeometri, gjeofizikë	beratas	-as
		dorashkë	-
i (in-, im-)-	imoral, inorganik	ashkë	
jashtë-	jashtëshkollor, i jashtëzakonshëm, jashtëkohor	ligjëratë, dhuratë, lëvdatë	
jo-	jonormal, jozyrtar, jopërparimtar	-atë	
kundër-	kundërligjshëm, kundërnjerëzor, kundërpeshë	montazh, grupazh	
lart-	i lartpërmendur	-azh	
mbi-	mbishkrim, i mbinatyrshëm, mbivlerësoj	zanatçi	
mono-	monosilabik, monografi, monokulturë	-çi	
mos-	mosmirënjohës, mospërfillës, mosbindje	asistent, referent,	
ndaj-	ndajshtim, ndajfolje	-ent	
		ndërtesë, shkresë, urdhëresë	
		-esë	
		matës, çelës, ndezës	-(ë)s
		madhësi, mbarësi, rëndësi	
		-(ë)si	

ndër-	ndërhyj, ndërlidh, ndërkombëtar, ndërshtetëror	vjetërsirë, kalbësirë, vogëlsira	
neo-	neolatin, neologjizëm, neoklasicizëm	-(ë)sir(a) zbrazëtirë, shkretëtirë, hapësirë	-(ë)tirë,
nën-	nëntokë, nënçmoj, nënqesh	(ë)sirë pjesëtoj, shkaktoj, udhëtoj	
pa-	i paaftë, i pabotuar, i padenjë, i pashkruar	-(ë)to marrëzi, djallëzi	
pan-	panamerikan, panafrikan	-(ë)zi	
para-	parashkollor, parafundor, i parafundit	argjendari, mjeshtëri, pasuri, varfëri	
pas-	pasardhës, pasdrekë, pasuniversitar,	- i rrugicë	-
për-	përkrah, përshtat, përngjaj, përmasë	icë bankier, boksier	
plot-	i plotpushtetshëm, i plotfuqishëm, i plotvlershëm	-ier (er) nevrashtenik	-ik
poli-	poliglot, polifonik, politeknik	metodikë, estetikë	
porsa-	i porsaçelur, i porsalindur, i porsaemëruar	-ikë burim, strehim	
poshtë-	poshtëshënuar	- im	
pranë-	pranëvënie, pranverë	kodrinë, çmendinë, rrafshinë	
prapa-	i prapambetur, prapaveprues, prapambetje	-inë mallakastriot	-iot
prej-	i prejardhur, prejardhje	futbollist, kitarist, shahist, idealist	
pro-	proamrikane, proangleze	-ist	
pseudo-	pseudoshkencor, pseudoshkrimtar	fëdanishte, lulishte, gurishtë	
ri-	riorganizoj, riprodhoj, rishikoj	-ishte/ishtë gjirokastirit	-it
sapo-	i sapodalë, i sapoformuar	aktiv, objektiv, subjektiv	
sipër-	sipërfaqe, sipërmarrës, i sipërshënuar	-iv zyrtarizëm, majtizëm	-izëm
super-	superstrukturë, superfuqi	veshje, dukje	-je
stër-	i stërgjatë, i stërmadh, i stërllashtë, stërhollor	fukarallëk, budallallëk	-llëk
sh-	i shkujdesur, shkarkoj, shkatërroj	klithmë, britmë, ndihmë	-më, (-
shpër-	shpërbëj, shpërdor	imë) besoj, emëroj	
shumë-	shumëshekullor, i shumëdëshiruar	-o malësor, drejtor, dasmor, këmbësor	
tej-	tejfundor, i tejdukshëm, tejfundor	-or	
ultra-	ultramodern, ultratingull		

vetë-	vetëmohues, vetëkritik, i	fletore, rregullore, ëmbëllore, bashkëtingëllore-	
	vetëkuptimshëm	or(e)/-tore	
z-	zbath, zbuloj	brumos, inatos, vendos	-os
zh-	i zhdrejtë, zhbëj, zhbllokoj	domosdoshëm, i ndershëm	
		-shëm	
		gatishmëri, domosdoshmëri	
		-shmëri	
		dëshmitar, lajmëtar, arsimtar	
		-tar (-atar)	
		punëtor, fajtor, vjershëtor	-
		tor (-ator)	
		ishullth, vëllimth, zëth, zogth, nxitimthi	
		-th, -thi-	
		korrekturë, arkitekturë, skulpturë	
		-urë	
		mbeturina, qelqurina	-
		urin(a)	
		shakaxhi	-
		xhi	
		portëz, shtëpizë	
		-z(ë)	

Vlerësimi:

Nxënësit do të vlerësohen:

- për pjesëmarrjen në diskutim;
- për materialet e sjella në mbështetje të temave të diskutimit;
- për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit, të folurit në publik.

Nxënësit do të vlerësohen:

- për përcaktimin e mënyrave të formimit të fjalëve në gjuhën shqipe;
- për të dalluar dhe analizuar fjalë që janë formuar me prejardhje si dhe ato që krijojnë fjalë të reja me prejardhje.

Detyrë shtëpie:

Realizoni në grupe me nga 4 nxënës prezantime për temat:

“Gjuha dhe standardi”, “Kujdesi për ujin”.

Usht. 10, fq. 55. – Shkruani një fletë ditari duke përdorur fjalë të prejardhura, me dhe pa ndajshtesa.

PLANIFIKIMI ORËS MËSIMORE 15, 16

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII	
Rubrika: Të shkruajmë Ora I Tema mësimore: Shkruajmë një artikull Ora II Tema mësimore: Shkruajmë një artikull		Situata e të nxënit: - Cilat janë tematikat tuaja të pëlqyera të artikujve?		
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none">• Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit• Kompetenca e të menduarit• Kompetenca e të nxënit• Kompetenca personale• Kompetenca qytetare• Kompetenca digjitale				
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - shkruan një artikull duke iu përmbajtur temës së dhënë; - organizon artikullin e shkruar sipas strukturës së tij: hyrje, zhvillim, mbyllje; - shkruan një artikull me tematikë të përcaktuar, duke synuar stil dhe origjinalitet.		Fjalët kyçe: - artikulli i gazetës, burime informative, objektiviteti, teknikat komunikuese, struktura e artikullit.		
Burimet: - gazeta, artikuj revistash, CD, teksti mësimor, tabela ndërveprimi, fletore të punëve me shkrim.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - TIK; Qytetari; Histori.		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Rrjeti i diskutimit, Leksion i përqendruar, Demonstrim analitik, Punë e pavarur me shkrim.</i>				
ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT Pjesa e parë e orës (45 minuta) Veprimtari paraprake: Rrjeti i diskutimit Zhvillohet një diskutim i shkurtër bazuar në dy pohimet e mëposhtme: Informacioni, në ditët e sotme, i besohet një numri të konsiderueshëm mjetesh komunikimi masiv, që në gjuhën e përditshme quhen masmedia . Tërë artikujt gazetareskë kanë për qëllim të informojnë, por stili, gjuha, teknikat komunikuese përcaktohen nga përmbajtja dhe lloji i artikullit. Ndërtimi i njohurive të reja: Leksion i përqendruar				
Titulli i artikullit	Struktura e artikullit	Planifikimit i shkrimit	Hartimi i artikullit	Rishikimi i artikullit
- tërheq vëmendjen; - ngjall dëshirën për lexim; - përmbledh përmbajtjen e tekstit.	- Hyrje - Zhvillim - Mbyllje	- Koha - Vendi - Roli i personazheve	- Shtjellimi i tekstit. - Shkrimi i tekstit në mënyrë të qartë, të saktë dhe me koherencë.	- Kontrolli i përmbajtjes - Kontrolli i formës



<p>Demonstrim analitik Lexohet artikulli model i dhënë në tekstin mësimor: Të jesh student jashtë vendit Çështja e të studiuarit jashtë vendit, ose më saktësisht në vendet perëndimore, është tepër me interes dhe jo vetëm për studentët shqiptarë. Në fakt, pas rënies së komunizmit, të gjitha vendet e ish-bllokut lindor u përballën me një fazë tranzitore...</p> <p>Ora e dytë Punë e pavarur Shkruani një artikull duke zgjedhur njërën prej temave të mëposhtme. Udhëtim në një kulturë ndryshe Diversiteti kulturor Toleranca tek adoleshentët Të falësh apo jo? Më shumë hapësira të gjelbra</p> <p>Vlerësimi: Nxënësi/ja: - realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të shkruarit, përdor strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin e tij, vlerëson cilësinë e informacionit që gjen, si dhe reflekton ndaj shkrimit duke përcaktuar elementet për përmirësim; - përshtat shkrimin me qëllimet dhe lexuesit; - përzgjedh dhe organizon fakte, ide, opinione, jep shembuj dhe të dhëna për të realizuar një produkt shkrimi cilësor.</p>
--

PLANIFIKIMI ORËS MËSIMORE 17, 18

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Morfologji Ora I: Tema mësimore: Përngjitja dhe kompozimi Ora II: Tema mësimore: Nyjëzimi dhe konversioni		Situata e të nxënit Teksti “Don Kishoti” Tekst nga Kasem Trebeshina	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore 1 Nxënësi/ja: - përcakton dallimet mes fjalëve të formuara me kompozim dhe fjalëve të formuara me mënyrat e tjera; - dallon kur një fjalë është formuar me përngjitje dhe argumenton përgjigjen e tij.		Fjalët kyçe: - prejardhje, parashtesë, prapashtesë, - përngjitja, paranyjëzimi, përbërja, konversion, mënyrë e përzier.	

<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore II</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon fjalët që janë formuar me nyjëzim; - përcakton se cilat pjesë të ligjëratës (klasa fjalësh) formohen me nyjëzim; - përcakton se cilat pjesë të pandryshueshme të ligjëratës formohen me konversion. 	
<p>Burimet:</p> <p>Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë, videoprojektor.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Letërsi</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p><i>Stuhi mendimi, Pemë mendimi, Punë e pavarur/në grup</i></p>	
<p style="text-align: center;">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p><i>Pjesa e parë e orës (45 minuta)</i></p> <p><i>Veprimtari paraprake</i></p> <p>Lexohet teksti “Don Kishoti”, në f. 60 (mund të paraqitet edhe me videoprojektor). Nënvizohen fjalët të prejardhura, të përngjitura dhe të përbëra së bashku me nxënësit.</p> <div style="border: 1px solid black; padding: 10px; margin: 10px 0;"> <p>Një djalosh... Fytyrën e kishte stërgjatëshe dhe të zeshkët, mollëzat të dala, shenjë që tregonte se ishte dinak, nofullat të mëdha, shenjë e pagabueshme që dëftonte se ishte gaskonas, syrin filxhan dhe të zgjuar, hundën si gremç, por të derdhur me finesë, ishte trupmadh për një adoleshent, por tepër i rrëgjuar për një burrë të rritur... Sepse djaloshi ynë kishte një kalë dhe ky kalë na ishte aq i shquar, saqë ra përnjëherë në sy; ishte një kalë shale dymbëdhjetë a katërmbëdhjetë vjeç, qimeverdhë, bishtrrjepur me gunga në këmbë... Mjerisht, cilësitë e këtij kali ishin aq të fshehura nën qimen e tij të çuditshme me dukjen e pahijshme, saqë shfaqja e tij në Mëng, ku kishte hyrë gati një çerek ore më parë kishte ngjallur një ndjenjë mospajtimi, e cila kishte arritur të prekte deri edhe kalorësin.</p> <p>Dhe kjo ndjenjë e kishte rënduar tejet djaloshin d’Artanjan.</p> <p style="text-align: right;">M. Servantes, “Don Kishoti”</p> </div> <p>Fjalë të prejardhura: <i>mospajtimi, mjerisht, e pahijshme, mollëzat, pagabueshme</i> etj.</p> <p>Fjalë të përngjitura: <i>përnjëherë</i> etj.</p> <p>Fjalë të përbëra: <i>qimeverdhë, trupmadh, bishtrrjepur</i> etj.</p> <p><i>Ndërtimi i njohurive të reja</i></p>	

Mësuesi/ja jep konceptin e përngjitjes dhe kompozitës, si dhe disa tipare të tyre.



Disa modele kompozitash

emër = emër + emër: mikpritje, pikëpamje

emër = emër + mbiemër: gushëkuq, lulëkuqe

emër = ndajfolje + emër: keqkuptim, mirëbesim

mbiemër = emër + emër: zemërgur, shpirtkazmë


mbiemër = emër + mbiemër: zemërgjerë, dritëshkurtër

mbiemër = ndajfolje/përemër + mbiemër/emër: dyvjeçar, disamuajsh

folje = ndajfolje + folje: mirëpres, keqkuptoj

folje = emër + folje: buzëqesh, duartrokas

folje = ndajfolje + folje: parathem, drejtpeshoj



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: “Punë e pavarur dhe në grup”

Në mënyrë të pavarur dhe në grup zhvillohen ushtrimet:

- Ushtrimi 1, 2, fq. 62 – Dalloni fjalët e përngjitura nga fjalët e përbëra.
- Ushtrimi 7, fq. 63 – Zëvendësimi me një fjalë të vetme i njësive frazeologjike.
- Ushtrimi 8, fq. 63 – Analizë nga pikëpamja e formimit të fjalëve të nënvizuara.

Pjesa e dytë e orës (45 minuta)

Veprimtari paraprake

Lexohet teksti nga K. Trebeshina në f. 64 (mund të paraqitet edhe me videoprojektor). Nënvizohen fjalët që janë formuar me nyjëzim dhe konversion së bashku me nxënësit.

Malet e Shqipërisë, malet që t’i sheh syri kudo që të jesh, janë të çuditshëm. Sikur i ka magjepsur një fuqi e mrekullueshme: ti i shikon në një ditë të pastër, kur dielli shkëlqen madhërisht në kupën e qiellit dhe ata të duken të kaltëruar, të mjegulluar, të menduar, të bukur sa më s’thuhet!

Por, të largët dhe që s’arrihen dot! I sheh dhe nuk i sheh. Janë aty përpara syve të tu dhe ti nuk i sheh, duke i parë, nuk i arrin dot! E kupton që nuk mund t’i arrish atje kurrë... Vetëm dëgjon disa këngë. E kush i këndon ato këngë?! Ku këndohen?! Ajo nuk dihet! Po këngët këndohen dhe malet janë diku aty, të paarrishëm!...


Ku e kanë gjetur gjithë këtë bukuri këta male? Po kur moti është i vrenjtur? Hej, si duken atëherë! Marrin një pamje të zemëruar, një ngjyrë të thellë mavi dhe ngrihen të egër, pikërisht aty përpara vështrimit tënd. Ngrihen të egër, të heshtur, të pakalueshëm! Ngrihen të gjallë sikur të kishin një shpirt njerëzor, që ka kaluar provat e gjata dhe të rënda të jetës.

Të tillë janë malet e Shqipërisë!

K. Trebeshina

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja jep konceptin e nyjzimit dhe konversionit, si dhe disa tipare të tyre.



Nxënësit shkruajnë diagramet në skedë ose në bllokun e gramatikës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Në mënyrë të pavarur dhe në grup zhvillohen ushtrimet:

- Ushtrimi 2, fq. 65 – Përdorimi i fjalës *akull* në fjalitë e dhëna.
- Ushtrimi 4, fq. 65 – Rishkruani fjalitë duke i kthyer pjesoret në mbiemra.
- Ushtrimi 4, fq. 54 – Gjeni fjalët e formuara me prejardhje pa ndajshitesa.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit, që përcaktojnë dallimet mes fjalëve të formuara me kompozim dhe fjalëve të formuara me mënyrat e tjera.

Vlerësohen nxënësit, që dallojnë fjalët që janë formuar me nyjëzim; si dhe vlerësohen nxënësit që përcaktojnë se cilat pjesë të pandryshueshme të ligjëratës formohen me konversion.

Detyrë shtëpie:

Usht. 9, fq. 66. – Përshkruani stinën e parapëlqyer, duke përdorur të paktën nga pesë fjalë të formuara me nyjëzim dhe konversion.

PLANIFIKIMI ORËS MËSIMORE 19, 20

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Rubrika: Të dëgjuarit Tema mësimore: Të dëgjuarit kritik		Situata e të nxënit: Kërkohet nga nxënësit të reflektojnë rreth një materiali të shkurtër dëgjimor.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none">- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit- Kompetenca e të menduarit- Kompetenca e të nxënit- Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- dëgjon një material duke treguar vëmendje dhe kuptuar atë;- dëgjon një material dhe e interpreton atë nga pikëpamja kuptimore dhe ajo gjuhësore;- dëgjon një material dhe e vlerëson atë.		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none">- Të dëgjuarit kritik, Struktura NIVD, Ndjesia, Interpretimi, Vlerësimi, Detyra.	
Burimet: <ul style="list-style-type: none">- teksti mësimor, CD me këngë dhe fragmente dëgjimore, materiale të ndryshme dëgjimore.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none">- TIK; Qytetari; Letërsi; Histori.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Loja gjuhësore, Harta semantike, Punë në grupe, Rrjeti i diskutimit.</i>			
ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT Pjesa e parë e orës (45 minuta) Veprimtari paraprake: Pyetja sjell pyetjen Çfarë mendoni se është të dëgjuarit kritik? A mendoni se dëgjuesi duhet të ketë përvojë dhe njohuri në fushën e materialit të dëgjuar? Përgjigjja duhet të orientohet drejt këtij modeli: Të dëgjuarit kritik është një aftësi që konsiston në vlerësimin e argumenteve të parashtruara nga të tjerët. Këtë aftësi mendohet se e zotërojnë dëgjuesit me aq përvojë dhe njohuri në fushën e materialit të dëgjuar, sa janë në gjendje të formojnë një opinion të vlefshëm rreth tij. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Harta semantike</i> Struktura NIVD e të dëgjuarit kritik <div><div>↓</div><div>Të dëgjuarit kritik e përthyen procesin e të dëgjuarit në katër pjesë:</div><div>↓</div><div>N: ndjesia; I: interpretimi, V: vlerësimi; D: detyra.</div></div> Punë e pavarur Punë në grupe Grupi i parë: Nxënësit dëgjojnë një këngë dhe u përgjigjen pyetjeve lidhur me: titullin, llojin e timbrit të zërit të këngëtares, kuptimit të vargjeve. Grupi i dytë: Nxënësit dëgjojnë tekstin “Kushtet historike të fillesave të Rilindjes Kombëtare Shqiptare” dhe u përgjigjen pyetjeve.			
Shembja e pashallëqeve shqiptare shënoi fillimin e një periudhe të re, që njihet me emrin Rilindja Kombëtare Shqiptare (vitet ‘30 të shek. XIX–1912). Gjatë saj u synua çlirimi i atdheut nga sundimi osman, bashkimi i trojeve shqiptare në një shtet kombëtar autonom ose të pavarur dhe zhvillimi i gjuhës, i shkollës e i kulturës kombëtare. U quajt kështu për nder të atyre njerëzve që u përpoqën për rilindjen e			

kombit shqiptar, për t'i kthyer atij lavdinë, si në kohën e Skënderbeut, dhe për të formuar një shtet kombëtar.

Grupi i tretë: Nxënësit evidentojnë dhjetë fjalë (terma) nga teksti i dëgjuar në ushtrimin 3 që i takojnë fushës së gjuhësisë dhe shpjegojnë kuptimin e tyre.

Vlerësimi:

Nxënësi/ja:

- demonstroi vëmendje gjatë të dëgjuarit të fragmenteve;
- shfaq ndjeshmëri dhe respekt ndaj folësit;
- reagon në mënyrë të përshtatshme duke treguar mirëkuptim ndaj folësit;
- dëgjon fragmentet duke i vlerësuar dhe interpretuar ato;
- demonstroi vullnet dhe gatishmëri në detyrat individuale dhe në punët në grup.

PUNË ME PROJEKT

REALIZIMI I NJË MANUALI

Qëllimi i këtij projekti është që nxënësi/ja:

- të realizojë një manual ku do të paraqisni mënyrë të përmbledhur njohuritë themelore të marra në lëndën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë, të marra këto gjatë tre viteve të gjimnazit;
- të menaxhojë punën për realizimin e këtij manuali mësimor;
- të kurorëzojë aftësitë vetjake në një produkt pune, i cili do t'i shërbejë përgatitjes suaj për maturën shtetërore.

Partnerët:

- nxënës/e të grupeve bashkëpunuese;
- mësues/e të gjuhës dhe të letërsisë;
- punonjës/e të arkivave, të bibliotekave, të video-fonotekave të ndryshme.

Fazat e projektit

Faza I

Prezantimi i projektit nga mësuesi/ja: synimi, qëllimet etj.

Ndarja e punës për secilin grup.

Përcaktimi i anëtarëve për secilin grup.

Caktimi i afateve për kontrollin e ecurisë së punës.

Faza II

Vëzhgimi i punës së kryer.

Sugjerime, vërejtje ndihmëse.

Përzgjedhja e materialeve të vlefshme për manualin.

Udhëzime për përgatitjen e *slide-ve* (programi *PowerPoint*), të cilat do të jenë pjesë e manualit.

Faza III dhe Faza IV

Prezantimi i manualit mësimor sipas grupeve.

Vlerësimi i nxënësve nga vetë nxënësit/et dhe mësuesi/ja.

Shënim: Këtu janë shtjelluar të tria fazat e projektit, por ato do të realizohen sipas planifikimit vjetor.

Veprimtaritë kryesore të projektit

- realizimi i projektit lëndor sipas këndvështrimit individual;
- përmbushja e objektivave të projektit me përpikëri;
- ndarja e punës mes anëtarëve të grupit;
- kërkimi i literaturës;
- integrimi i njohurive në disa fusha të nxëni, si: gjuhë shqipe, letërsi, informatikë etj.;
- menaxhimi dhe prezantimi i projektit, duke reflektuar kompetencat e fituara nga të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit, të shkruarit dhe të vëzhguarit.

Nxënësi/ja do të hulumtojë në:

- tekstet shkollë, materiale të ndryshme informuese, vepra letrare, artikuj të ndryshëm vlerësues për letërsinë dhe gjuhën etj. për të realizuar përmbledhjet e njohurive sipas kompetencave kyçe dhe atyre të fushës, në përputhje me programin e maturës shtetërore.

Këto materiale do të ndërthurin këto njohuri:

- Teknikat e shkrimit dhe karakteristikat strukturore, gjuhësore dhe stilistike të teksteve përshkruese, rrëfyese, argumentuese, udhëzuese, informuese-paraqitëse.

- Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit: *Morfologji dhe fjalëformim; Sintaksë; Leksikologji; Drejtshkrim dhe pikësim.*
- Shkrimi i një eseje argumentuese, përshkruuese, rrëfyese, informative-shpjeguese, teksti udhëzues.
- Lista e veprave nga do të përzgjidhet fragmenti i tekstit letrar në testimin kombëtar, sipas programit orientues për përgatitjen e provimit kombëtar të maturës shtetërore për gjimnazin.

Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi i projektit do të bazohet në mënyrën e konceptimit të tij nga pikëpamja e përmbajtjes dhe ajo formale, për elemente të tilla si: pasuria e materialit të përfshirë, saktësia dhe qartësia e paraqitjes, përfshirja e hartave ideore që lehtësojnë të kuptuarin e materialit, cilësia e prezantimit të manualit, përgatitjes së *slide-ve*, dorëzimi i tij në afatin e caktuar.

PLANIFIKIMI ORËS MËSIMORE 21, 22

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Rubrika: - Të lexuarit - Tekstet udhëzuese Ora I Tema mësimore: Tekstet udhëzuese Ora II Tema mësimore: Analizë teksti udhëzues		Situata e të nxënit: - Ku dallon teksti udhëzues nga ai shpjegues?	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të nxënit - Kompetenca personale - Kompetenca qytetare - Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - lexon për të kuptuar tekstin udhëzues; - analizon strukturën e tekstit udhëzues; - analizon veçoritë gjuhësore të tekstit udhëzues; - lexon organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të tekstit udhëzues; - shndërron tekstin udhëzues në një format tjetër teksti (p.sh.: rrëfyes).		Fjalët kyçe: tekst udhëzues; libra elektronikë; teknikat e udhëzimit; struktura e udhëzimeve.	
Burimet: - teksti mësimor, tekste udhëzuese, materiale ilustruese, telefon celular për leximin e librave elektronikë.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK; Qytetari; Histori.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:

Tabela semantike, Diskutim njohurish paraprake, Stuhi mendimi, Organizuesi logjik i analogjisë, Punë në grup, Praktikë e drejtuar.

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT

Pjesa e parë e orës (45 minuta)

Veprimtari paraprake: Çfarë dimë për tekstet udhëzuese?

Veçori	Struktura	Lloje tekstesh udhëzuese
Në tekstet udhëzuese gjuha e përdorur është formale. Përdoren terma teknike, administrative apo të fushave të ndryshme, të ndërthurura këto me leksikun e gjuhës së përditshme.	Organizimi i tyre bëhet sipas një rendi logjik hap pas hapi. Renditja bëhet me pika, ku secila jep një informacion të detajuar për veprimet që do të kryhen.	- Manuallet - Doracakët - Udhëzuesit - Recetat - Rregulloret e ndryshme

Ndërtimi i njohurive të reja:

Koncepti: Tekstet udhëzuese janë tekste që përmbajnë udhëzime të qarta për mënyrën se si duhet kryer një veprim i caktuar dhe për rendin e hapave të nevojshëm që duhen ndërmarrë.

Ndjekim tabelën e mëposhtme duke koordinuar mes kësaj dhe asaj të mësipërme.

Teknikat e shkrimit të tekstit udhëzues	Karakteristika strukturore të tekstit udhëzues	Karakteristika gjuhësore të tekstit udhëzues
- Veprimet hap pas hapi - Elementet pamore	- Titulli - Lista e materialeve - Figurat, ilustrimet, tabelat - Fjalorthi	- Gjuha është e drejtpërdrejtë. - Fjalitë janë të shkurtra dhe të thjeshta. Ato zakonisht fillojnë me folje në mënyrën urdhërore dhe tregojnë vargun e veprimeve që duhen kryer.

Punë e pavarur/ Punë në grupe

Grupi i parë: Punon me ushtrimin 2. Nxënësit lexojnë tekstin dhe nënvizojnë ato udhëzimet që mund të hiqen, si të panevojshme ose të papërshtatshme.

Tek udhëzimi nr.4: *Prisni që të njoftoheni për pranimin.* Pjesa që mund të hiqet është: Gjatë kësaj kohe merruni me aktivitet fizik që mban larg stresin dhe kontrolloni me kujdes çdo ditë e-mail-in tuaj.

Grupi i dytë: Nxënësit shkruajnë një tekst të ngjashëm udhëzues ku të tregojnë hap pas hapi procedurën që duhet ndjekur për të aplikuar për shkollë të lartë në Shqipëri.

P.sh.: Të gjithë maturantët për t'u pranuar në universitet do të duhet që të paraqesin diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose diplomën; dëftesën e shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të në Shqipëri; dëftesë pjekurie të shkollës së mesme (për kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 876.

Grupi i tretë: Nxënësit shndërrojnë tekstin udhëzues të dhënë në ushtrimin 2 në një tekst rrëfyes, në të cilin tregojnë ngjarjen e aplikimit për shkollë të lartë nga ana e një maturanti.

Ata rrëfejnë duke përdorur teknikën e së vërtetës.

Udhëzimet e dhëna hap pas hapi ata i bëjnë pjesë të subjektit të rrëfimit.

Ora e dytë mësimore: Diskutim paraprak

- A keni informacion për termin: **iBooks Store**?
- Po ju a lexoni libra nga interneti?
- Cilat zhanre pëlqeni dhe pse?

Ndërtimi i njohurive të reja:

- Lexohet teksti udhëzues: *Si të lexojmë libra nga telefoni “Apple”*



- Shpjegohen hap pas hapi veprimet që duhet të kryhen për një përdorim sa më të saktë të **IBOOKS**.

Punë e pavarur Punë në grupe

Grupi i parë: Nxënësit punojnë me karakteristikat gjuhësore tekstit të lexuar (të cilat i japin tiparet e tekstit udhëzues).

Grupi i dytë: A do të kishte kuptim teksti nëse hapat do të radhiteshin ndryshe?

Përgjigje: Ndryshimi i renditjes së hapave në një tekst udhëzues do ndikonte në çrregullimin e koherencës së tij, teksti do bëhej i pakuptueshëm.

Grupi i tretë: Nxënësit gjejnë në tekst termat që lidhen me fushën teknike:

3D Touch; opsioneve; “Look Up”; “Bookmarks” etj.

Çfarë roli luajnë imazhet dhe ikonat në këtë tekst udhëzues?

- Elementet figurative qartësojnë dhe lehtësojnë kuptimin e tekstit udhëzues.

Vlerësimi:

Nxënësit/et do të vlerësohen:

- për pjesëmarrjen në diskutime;
- për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;
- për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna;
- për analizën e strukturës së tekstit udhëzues;
- për analizën gjuhësore të tekstit udhëzues.

Detyrë shtëpie: Shkruani një tekst udhëzues për një nga çështjet e mëposhtme:

- Mënyra se si mund të instalohet në telefon ose kompjuter një aplikacion që ju e përdorni shpesh.
- Mënyra se si mund të dërgohet një mesazh zanor përmes aplikacioneve të internetit.
- Mënyra se si mund të krijohet një adresë *e-mail*-i.

PLANIFIKIMI ORËS MËSIMORE 23, 24

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Morfologji Tema mësimore: Mënyrat e përziera të formimit të fjalëve		Situata e të nxënit Ismail Kadare, “Ura me tri harqe”	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore 1 Nxënësi/ja: - dallon fjalët që janë formuar me përngjitje dhe		Fjalët kyçe: - kompozim, përngjitje, nyjëzim, parashtesim, prapashtesim, fjalëformim.	

prapashtesim, me kompozim dhe prapashtesim, me nyjëzim dhe prapashtesim etj.; - formon fjalë të reja duke përdorur mënyrat e formimit të fjalëve; - vlerëson larminë e fjalëformimit të gjuhës shqipe.	
Burimet: Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë, Fjalori i Gjuhës shqipe (FESH), videoprojektor.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Letërsi
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Stuhi mendimi, Punë e pavarur dhe në grup</i>	
<p style="text-align: center;">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p>Pjesa e parë e orës (45 minuta)</p> <p>Veprimtari paraprake</p> <p>Lexohet teksti nga I. Kadare “Ura me tri harqe” në fq. 69 (mund të paraqitet edhe me videoprojektor). Nënvizohen fjalët jo të thjeshta.</p> <div style="border: 1px solid black; padding: 10px; margin: 10px 0;"> <p>Dielli që po perëndonte përshkëndiste pjerrtazi harqet e urës. Ajo gurëri e madhe ishte e gjitha në pritje. Harqet dukej sikur do të të hanin. Do të doja që konstruktori të shihte këtë shkretim. Mirëpo jetimëria e urës që dukej sikur do të ishte qindravjeçare, mori fund papritur ditën e 29 tetorit. Midis rrëmujës së punimeve, i zymtë e i pashoqërueshëm me njeri vërtitej konstruktori...</p> <p>Nganjëherë nën rrezet e diellit mbrëmësor, koka e tij kuqalashë dukej sikur lëshonte shkëndijime djallëzore mes asaj baltisjeje të përgjithshme. Koha mbajti mirë. Në mbarim të gjahut, në kthim, nisi të borëronte lehtë dhe vargu i gjahtarëve, ashtu, i pahitur nga bora, dukej edhe më i bukur. Po, shumë pak ngjanin ata me kryezotët e dikurshëm të Arbrit, me ata të largët, alpinët, borëtarët, mjegullkaltërorët, të mbështjellë me një shall të madh.</p> <p style="text-align: right;">I. Kadare, “Ura me tri harqe”</p> </div> <p>Ndërtimi i njohurive të reja: “Stuhi mendimi”.</p> <p>Përmes “Stuhi mendimi”, mësuesi/ja ndërton diagramin e grupimit të homonimeve, si fjalë me formë të njëjtë e me kuptime të ndryshme.</p> <div style="text-align: center; margin-top: 20px;"> <pre> graph TD A[Mënyra të fjalëformimit] --> B[Përngjitje dhe prapashtesim (pakujdesi, nëpunës, trekëndësh)] A --> C[Kompozim dhe prapashtesim (pjesëmarrës, marrëveshje, këmbadoras)] A --> D[Nyjëzim dhe prapashtesim (i hekurt, i sotëm, i thyeshëm)] A --> E[Nyjëzim dhe parashteso-prapashtesim (i përpiktë, i përvajshëm, i përgjithshëm)] A --> F[Nyjëzim dhe përngjitje (i paanë, i pafytyrë, i pashtëpi)] A --> G[Nyjëzim dhe përngjitje e prapashtesim (i përdyjavshëm, i përmuajshëm)] </pre> </div>	

Nxënësit shkruajnë diagramin dhe rregullat në skedë ose në bllokun e gramatikës.

Të mbajmë mend!

✚ **Duhet dalluar fjalët që formohen me kompozim dhe prapashtesim nga kompozitat e mirëfillta.**

Në disa raste si: *liridashës, marrëveshje*, ky dallim nuk është i vështirë të bëhet sepse në gjuhën shqipe nuk ka fjalëdashës apo veshje (si formim nga emri vesh). Zakonisht formimet me kompozim dhe prapashtesim dalin prej lokucionesh foljore, prandaj fjala *pjesëmarrës* ka kuptimin : “ai që merr pjesë”.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: “Punë e pavarur dhe në grup”

Në mënyrë të pavarur dhe në grup zhvillohen ushtrimet:

Ush. 1, fq. 70 – Tregoni si janë formuar fjalët.

Punë në grup

Ush. 2, fq. 70 – Gjeni fjalë sipas mënyrave të fjalëformimit:

- a. Nyjëzim, përngjitje dhe prapashtesim;
- b. Nyjëzim dhe parashteso-prapashtesim;
- c. Nyjëzim dhe prapashtesim;
- d. Nyjëzim dhe përngjitje;
- e. Kompozim dhe prapashtesim;
- f. Përngjitje dhe prapashtesim.

Punë në grup

Ush. 6, fq. 71 - Dy grupe nxënësish me nga dy vetë u jepet Fjalori i Gjuhës shqipe dhe u kërkohet të gjejnë të gjitha formimet e prejardhura nga rrënjët: hap dhe bëj.

(Në rastet kur në klasë ka videoprojektor, mësuesi/ja paraqet Fjalorin Elektronik (FESH) dhe punon së bashku me nxënësit për të gjetur disa fjalë që përbëhen nga një morfemë e vetme.)

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit, që dallojnë fjalët që janë formuar me përngjitje dhe prapashtesim, me kompozim dhe prapashtesim, me nyjëzim dhe prapashtesim etj.

Vlerësohen nxënësit, që formojnë fjalë të reja duke përdorur mënyrat e formimit të fjalëve.

Detyrë shtëpie:

Ush.6, fq. 123. – Shkruani një ese në të cilën të përdorni fjalë të formuara me mënyrat e përziera të fjalëformimit.

Fusha: Gjuha e komunikimi		Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Rubrika: Të shkruarit Tema mësimore: Shkrimi i udhëzimeve për përdorimin e një pajisjeje ose programi kompjuterik			Situata e të nxënit: Lexohen fragmente të shkurtra udhëzuese.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none">• Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit• Kompetenca e të menduarit• Kompetenca e të nxënit• Kompetenca personale• Kompetenca qytetare• Kompetenca digjitale				
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të shkruarit, përdor strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin e tij, organizon në mënyrë logjike mendimet dhe idetë;- redakton shkrimin duke përdorur edhe mendimet e të tjerëve;- shkruan qartë, me një stil vetjak dhe në mënyrë logjike, një tekst udhëzues;- zbaton rregullat gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit në shkrimin e tij.			Fjalët kyçe: - pajisje; program elektronik; planifikim; hartim rishikim; redaktim.	
Burimet: <ul style="list-style-type: none">- fletore të punëve me shkrim, modele tekstesh udhëzuese, shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë ndërveprimi).			Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - TIK; Qytetari; Histori.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:

Diskutim paraprak, Udhëzime shkrimi, Punë me shkrim sipas grupeve.

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT

Veprimtari paraprake

Diskutim paraprak

Cilat janë teknikat e përdorura në planifikimin e një shkrimi? Po në hartimin e tij?

Ndërtimi i njohurive të reja:

Lexohen udhëzimet:

- për të lidhur një aparat fotografik me kompjuterin;
- për të instaluar *driver*-in e një pajisjeje nga *CD*-ja;
- për të instaluar një pajisje të re në kompjuter.

Punë e pavarur me shkrim në grupe

Shkruani udhëzimet e nevojshme për përdorimin e një pajisjeje elektronike që e njihni mirë.

Shkruani udhëzime për përdorimin e një programi, si p.sh.: *Adobe Acrobat*.

Shkruani udhëzime se si të blini *online* në mënyrë të sigurt.

Hyrja e udhëzimeve duhet të paraqesë shkurtimisht se përse duhen këto udhëzime që po shkruani dhe kujt do t'i shërbejnë ato.

Shtjellimi do të përshkruajë të gjithë hapat e udhëzimeve.

Përfundimi mund të përmbajë mënyrën se si do të zbatohen këto udhëzime.

Vlerësimi:

Nxënësit/et do të vlerësohen:

- për shkrimin e tekstit udhëzues;
- për materialet e sjella në mbështetje të temës së tekstit udhëzues;
- për fjalorin e përdorur gjatë shkrimit të tekstit udhëzues;
- për respektimin e strukturës së tekstit udhëzues.
- për zbatimin e rregullave drejtshkrimore gjatë shkrimit të tekstit udhëzues.

PLANIFIKIMI ORËS MËSIMORE 25

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Sintaksë Tema mësimore: Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur ftilluese		Situata e të nxënit	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit			


Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore 1 Nxënësi/ja: - dallon llojet e fjalive të përbëra me nënrenditje; - ndërton fjali të përbëra me nënrenditje; - analizon fjalitë e përbëra me shumë pjesë; - veçon mjetet lidhëse (lidhëzat dhe fjalët lidhëse) në fjalitë e përbëra.	Fjalët kyçe: - fjali e përbërë, nënrenditje, mjete lidhëse (lidhëza, fjalë lidhëse).
Burimet: Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Letërsi

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve


Stuhi mendimi, Pemë mendimi, Diagram Veni, Diskutim, Di, Dua të di, mësova, Punë e pavarur/në grup

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT
Pjesa e parë e orës (45 minuta)

Diskutohet me nxënësit përmes teknikës “Stuhi mendimi” mbi njohuritë e tyre të mëparshme: Fjalja e përbërë me bashkërenditje.


Ndërtimi i njohurive të reja:

Mësuesi/ja përmes teknikës “Pemë mendimi” shpjegon: Fjalja e përbërë me nënrenditje, llojet e fjalisë nënrenditëse filluese (kundrinore dhe kryefjalore).




- Pjesa e varur lidhet drejtpërdrejt me foljen e pjesës kryesore (e plotëson atë).
- Pjesët e një fjalie të përbërë filluese mund të lidhen edhe pa ndihmën e një lidhëze.


Kur plotësojnë nevojën e foljes së pjesës kryesore për një kundrinor.

Lidhet drejtpërdrejt me foljen e pjesës kryesore duke luajtur rolin e kryefjalës që kërkon folje.

Mësuesi/ja me Diagram Veni paraqet të përbashkëtat dhe ndryshimet mes fjalive të përbëra me bashkërenditje dhe nënrenditje.



Mësuesi/ja përmes shembujve u kërkon nxënësve të paraqesin me Diagram Veni të përbashkëtat dhe ndryshimet mes fjalive të përbëra me nënrenditje kundrinore dhe kryefjalore.



Të mbajmë mend!

- ✚ Veçori kryesore e fjalive me nënrenditje filluese është fakti se në to, pjesa e varur lidhet drejtpërdrejt me foljen e pjesës kryesore, jo në kuptimin që e ndjek menjëherë atë, por sepse është e domosdoshme për të, pra e plotëson kuptimin e saj.

Diskutim mbi disa pohime: të sakta/të gabuara.

- E njëjta pjesë fjali e ndryshon funksionin në varësi të foljes së pjesës drejtuese.
- Me vlerë kundrinore mund të dalë një gjymtyrë fjali ose një pjesë e varur fjali.
- Si kryefjalë shërben vetëm një gjymtyrë fjali.
- Pjesa e varur kundrinore nuk mund t'i paraprijë pjesës drejtuese.
- Para fjalive filluese kundrinore e kryefjalore vendoset gjithnjë një lidhëz.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: “Punë e pavarur dhe në grup”

Usht. 2, fq. 84. – Ktheni shprehjet emërore me vlerë kryefjalore në pjesë të varur kryefjalore.

Usht. 3, fq. 84. – Ktheni shprehjet emërore me vlerë kundrinore në pjesë të varur kundrinore.

Punë në grup

Me anë të teknikës “*Di, Dua të di, Mësova*”, nxënësit kontrollojnë njohuritë e tyre mbi fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe fjalitë e përbëra me nënrenditje.

DI	Dua të di	Mësova
Në fjalitë e përbëra me bashkërenditje, pjesët vendosen në marrëdhënie barazie. Në fjalitë e përbëra me nënrenditje, pjesët vendosen në marrëdhënie varësie.		

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit, që dallojnë llojet e fjalive të përbëra me nënrenditje.

- Ndërtojnë fjali të përbëra me nënrenditje.

Detyrë shtëpie:

Krijoni fjali të përbëra me pjesë të nënrenditur ffilluese kryefjalore dhe kundrinore.

TESTOJMË NJOHURITË GRAMATIKORE

Tremujori I

❖ Qarkoni alternativën e shkruar saktë

- | | |
|----------------|-----------------|
| a. italian | b. italjan |
| a. Laipcig | b. Lajpcig |
| a. Molieri | b. Moljeri |
| a. Sidnei | b. Sidnej |
| a. Olymp | b. Olimp |
| a. Cezari | b. Çezari |
| a. Siçilia | b. Sicilia |
| a. audjencë | b. audiencë |
| a. elektrikist | b. elektriciist |
| a. zologjik | b. zoologjik |
| a. iluzion | b. iluzjon |
| a. disertacion | b. dizertacion |
| a. ambicie | b. Ambicje |
| a. pediatër | b. pedjatër |
| a. tastjerë | b. tastierë |
| a. inçizoj | b. incizoj |
| a. agjensi | b. agjenci |

❖ Qarkoni përgjigjen e saktë me Po/Jo

- Një fjali e thjeshtë ka më pak fjalë se një fjali e përbërë. Po Jo
- Kriteri për dallimin e një fjalie të thjeshtë nga ajo e përbërë, është numri i kallëzuesve të fjalisë. Po Jo
- Një fjali me dy kallëzues homogjenë është fjali e thjeshtë. Po Jo
- Në një fjali të përbërë nuk mund të ketë dy a më shumë kallëzues pa asnjë kryefjalë të shprehur. Po Jo
- Si fjalia e thjeshtë, ashtu dhe ajo e përbërë janë njësi kumtuese. Po Jo
- Pjesët e fjalive të bashkërenditura mund të lidhen me ose pa lidhëza. Po Jo
- Rendi i fjalive të bashkërenditura është gjithnjë i lirë. Po Jo
- Kudo ku përdoret lidhëza “dhe” kemi të bëjmë me fjali të bashkërenditura. Po Jo
- Pjesët e fjalive të bashkërenditura mund të qëndrojnë si fjali më vete. Po Jo

- Për bashkëlidhjen e pjesëve të fjalisë, rol të veçantë ka edhe koha e foljeve-kallëzues. Po Jo
- Lidhje barazie mes pjesëve të fjalisë do të thotë se asnjëra pjesë nuk varet prej tjetrës. Po Jo
- Fjalia e thjeshtë dhe e përbërë kanë të përbashkët numrin e kallëzuesve. Po Jo
- Edhe fjalia e thjeshtë edhe fjalia e përbërë kanë kuptim relativisht të plotë. Po Jo
- Edhe fjalia e thjeshtë edhe fjalia e përbërë kanë intonacion të plotë dhe të mbaruar. Po Jo
- Emrat e huaj në gjuhën shqipe, shkruhen siç shqiptohen. Po Jo
- Shqiptimi i emrave të huaj nuk është gjithnjë i njëjtë me trajtën origjinale. Po Jo
- Për shkrimin e saktë të emrave të huaj, rëndësi të veçantë ka njohja e shqiptimit të tyre. Po Jo
- Emrat e huaj të përveçëm lakohen ndonëse mund të vijnë nga një gjuhë pa lakim. Po Jo
- Shkurtesat janë një lloj i veçantë kompozimi. Po Jo
- Morfema rrënjore mbart kuptimin leksikor të fjalës. Po Jo
- Morfema rrënjore mbart kuptimin gramatikor të fjalës. Po Jo
- Emrat e huaj të përveçëm lakohen ndonëse mund të vijnë nga një gjuhë pa lakim. Po Jo
- A merret nyja si element fjalëformues tek fjalët: “*ile bukur, ile mirë, ile qartë*”? Po Jo
- Llojet e fjalive nënrenditëse filluese janë kundrinore dhe kryefjalore. Po Jo
- Formimi i fjalëve të reja me anë të nyjës është prodhimtar në gjuhën shqipe. Po Jo
- Me konversion formohen si pjesë të pandryshueshme të ligjëratës ashtu edhe pjesë të ndryshueshme. Po Jo
- Me konversion formohen vetëm pjesë të ndryshueshme të ligjëratës. Po Jo
- Fjalët “*brenda dhe sipër*” mund të përdoren, si: *parafjalë, ndajfolje* dhe si *parashtesë*. Po Jo
- Morfema është njësi e mëvetësishme. Po Jo
- Në fjalitë e përbëra me bashkërenditje, pjesët përbërëse të saj vendosen në marrëdhënie varësie mes tyre. Po Jo

❖ Plotësoni

- Krijoni me parashtesë fjalë me kuptim të kundërt.
 - ç- çorganizoj _____
 - sh-** _____
 - zh-** _____
 - pa-** _____
 - jo-** _____
- Plotëso me fjalë të tjera të përngjitura.

ndajfolje	gjithnjë _____
parafjalë	nëpër _____
lidhëz	megjithatë _____
pjesëza	kushedi _____
pasthirmë	faleminderit _____
- Cila është rrënja e ndajfoljes afër? _____
- Cila është rrënja e fjalëve *largoj, largësi, largesë, largim*?

- Fjala ndryshon nga morfema:

fjala

morfema

- Plotëso sipas modelit fjalë të krijuara me parashtesa.
 - para-** parashkollor _____
 - pas-** pasuniversitar _____
 - ri-** ripunoj _____
 - brenda-** brendashkruar _____
 - sipër-** sipërmarrës _____
 - prapa-** prapambetur _____

- Plotëso sipas modelit fjalë të krijuara me prapashtesa.

a. gazetar	_____	-ar
b. urdhëresë	_____	-esë
c. mbarësi	_____	-(ë)si
d. marrëzi	_____	-(ë)zi
e. burim	_____	-im

❖ Qarkoni përgjigjen e saktë

- Prapashtesa është:
 - trajtëformuese
 - fjalëformuese
 - trajtëformuese dhe fjalëformuese
- Parashtesa është:
 - trajtëformuese
 - fjalëformuese
 - trajtëformuese dhe fjalëformuese
- Morfemat ndajshitesore shërbejnë për të formuar:
 - forma të reja fjalësh
 - fjalë të reja
 - forma të reja fjalësh dhe fjalë të reja
- Morfemat ndajshitesore trajtëformuese shërbejnë për të formuar:
 - forma të reja fjalësh
 - fjalë të reja
- Morfemat fjalëformuese janë:
 - parashtesa
 - prapashtesa
 - mbaresë
- Morfemat trajtëformuese janë:
 - nyja mbaresa, prapashtesa
 - nyja mbaresa
- Prapashtesat qëndrojnë:
 - pas rrënjës
 - pas rrënjës apo ndonjë prapashtese tjetër.
- Cila është rrënja e ndajfoljes afër? _____
 - pas rrënjës
 - pas rrënjës apo ndonjë prapashtese tjetër
- Morfemat ndajshitesore fjalëformuese shërbejnë për të formuar:
 - forma të reja fjalësh
 - fjalë të reja


- 10.** Fjala “*Vendosi ta botonte librin*”, është:
a. Fjali e thjeshtë
b. Fjali e përbërë
- 11.** Fjala “*Foli pa menduar*”, është:
a. Fjali e thjeshtë
b. Fjali e përbërë
- 12.** Fjala e thjeshtë dhe ajo e përbërë ndryshojnë:
a. Nga ajo që kumtojnë.
b. Nga intonacioni i fjalisë.
c. Nga numri i kallëzuesve në fjali.
- 13.** Mbiemrat: “*i bukur, i mirë, i qartë*”, janë:
a. të prejardhur
b. të parmë
- 14.** Me anë të nyjzimit formohen:
a. mbiemra, emra prejfoljor të gjinisë femërore
b. mbiemra, emra prejfoljor të gjinisë asnjëse dhe femërore
c. mbiemra, emra, folje
- 15.** Fjala e nënvizuar në fjalinë: “*Fol pak, puno shumë!*” është:
a. parafjalë
b. ndajfolje
- 16.** Fjala e nënvizuar në fjalinë: “*Pak nxënës ishin të pranishëm.*” është:
a. parafjalë
b. ndajfolje

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Sintaksë Ora I Tema mësimore: Fjalja e përbërë me pjesë të nënrenditur rrethanore. Ora II Tema mësimore: Fjalja e përbërë me pjesë të nënrenditur përcaktore.		Situata e të nxënit: - Fjali të përbëra me nënrenditje, të ndara në fisha ose të paraqitura me video-projektor.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore I: Nxënësi/ja: - dallon llojet e fjalive të përbëra me nënrenditje rrethanore; - veçon mjetet lidhëse (lidhëzat dhe fjalët lidhëse) në fjalitë e përbëra me nënrenditje rrethanore; - ndërton fjali të përbëra me nënrenditje rrethanore. Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore II: Nxënësi/ja: - dallon llojet e fjalive të përbëra me nënrenditje përcaktore; - veçon mjetet lidhëse (lidhëzat dhe fjalët lidhëse) në fjalitë e përbëra me nënrenditje përcaktore; - ndërton fjali të përbëra me nënrenditje përcaktore.		Fjalët kyçe: - fjali e përbërë, nënrenditje, mjete lidhëse (lidhëza, fjalë lidhëse) rrethanore, pjesë e varur rrethanore; - mjete lidhëse (lidhëza, fjalë lidhëse) përcaktore, gjymtyrë emërore ose përemërore, pjesë e varur përcaktore.	
Burimet: - teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë, FESH, video-projektor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Stuhi mendimi, Pemë mendimi, Puna me fisha, Diskutim, Diagram Veni, Punë e pavarur/në grup, Minitest.</i>			
ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT Pjesa e parë e orës (45 minuta) Veprimtari paraprake Me teknikën “Stuhi mendimi” u kërkohet nxënësve të flasin për fjalinë e përbërë me nënrenditje filluese, llojet (kundrinore dhe kryefjalore).			

FJALIA E NËNRENDITUR FTILLUESE → Pjesa e varur lidhet drejtpërdrejt me foljen e pjesës kryesore (e plotëson atë).


Pjesët e një fjalie të përbërë filluese mund të lidhen edhe pa ndihmën e një lidhëze.



Lidhet drejtpërdrejt me foljen e pjesës kryesore duke luajtur rolin e kryefjalës që kërkon folje.

Ndërtimi i njohurive të reja: “Pemë mendimi”

Mësuesi/ja përmes teknikës “Pemë mendimi” shpjegon: *Fjalinë e përbërë me nënrenditje rrethimore*, pjesa e varur e së cilës shpreh një rrethanë të kryerjes së veprimit: *kohë, vend, shkak, rrjedhojë, krahasim, lejim, mënyrë, qëllim, kusht*.



Nxënësit shkruajnë diagramet dhe tabelat në skedë ose në bllokun e gramatikës.

Diskutim mbi disa pohime: të sakta/të gabuara.

Në një fjali të përbërë mund të ketë pjesë të varura rrethore dhe filluese.

Pjesa e varur e fiton rolin e saj në varësi të marrëdhënies që vendos me pjesën drejtuese.

Pjesët e varura rrethore emërtohen në varësi të rrethanës që shprehin.

Pjesët e varura rrethore, nuk kanë rend të lirë.

Një pjesë e varur mund të shërbejë si pjesë drejtuese për një pjesë tjetër në fjali.

Të mbajmë mend!

❖ Në fjalitë e përbëra me nënrenditje rrethore, pjesa e varur përgjithësisht shpreh *një rrethanë* të kryerjes së veprimit në pjesën kryesore.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Së bashku me nxënësit ndërtohet tabela e mjeteve lidhëse të fjalive me pjesë të nënrenditur rrethore.

FJALI ME PJESË TË VARUR RRETHANORE	MJETE LIDHËSE
KOHORE	kur, ndërsa, gjersa, pasi, para, para se, ndërkohë që etj.
VENDORE	ku, kudo që, ngado që, te/tek, nga etj.
SHKAKORE	se, sepse, ngaqë, duke qenë se, për shkak se, për arsye se etj.
QËLLIMORE	që, me qëllim që, në mënyrë që.
MËNYRORE	si, siç, sikur, sikurse, ashtu, ashtu si etj.
KRAHASORE	sa, aq sa, po aq sa, sa ç', nga ç', mësa etj.
KUSHTORE	në, nëse, në qoftë se, po, po qe se, po të jetë se, me kusht që etj.
LEJORE	ndonëse, sido që, sado që, edhe pse, kushdo etj.
RRJEDHIMORE	ndaj, prandaj, për pasojë, për rrjedhojë, saqë, aq sa, kështu që etj.

Përshkruhen tiparet dalluese të tyre dhe ilustrohen me shembuj.

Punë në grup

Mësuesi/ja shkruan disa fjali në tabelë, nga ku nxënësit duhet të gjejnë funksionin e fjalës “që”, (Usht. 4, faqe 91).

Që të kesh sukses, duhet të punosh më shumë.

U gëzova shumë **që** erdhe në ditëlindjen time.

Që të dy njihen prej vitesh.

Punën **që** nise mos e lër në mes.

Që kur është kthyer **që** andej, se si sillet, ndryshe.

Që kjo është Teuta, nuk kam farë dyshimi.

Usht. 3, f. 91. – Ktheni në fjali të përbëra me nënrenditje fjalitë e mëposhtme dhe tregoni llojin e tyre. Nënvizoni mjetet lidhëse.

Usht. 5, f. 91. – Gjeni dhe analizoni pjesët e fjalisë së mëposhtme, si dhe mjetet lidhëse mes tyre.

Pjesa e dytë e orës (45 minuta)

Ndërtimi i njohurive të reja: “Puna me fisha”

U shpërndahen nxënësve fisha me fjali të ndryshme. Fishat mund të paraqiten edhe në videoprojektor, ose flipçart. U kërkohet të qarkojnë lidhëzat/fjalët lidhëse.

Fisha 1.

Kushdo **që** shkel rregullat, përballet me ligjin.

Fisha 2.

Këta qenë të vetmit njerëz të mirë **që** iu gjendën pranë në ato ditë të vështira.

Fisha 3.

Kjo është punë **që** s’bëhet.

Fisha 4.

Blerta, **e cila** e njohte më mirë se në gjendjen, nuk po fliste.

Fisha 5.

Kishte dëgjuar shumë për atë qytet të gurtë, **i cili** tashmë iu shfaq para sysh me tërë bukurinë e vet.

Fisha 6.

Parku, pranë të cilit po ndërtohej aq shumë, e humbi hijeshinë e dikurshme.

Të mbajmë mend!

Në fjalinë e përbërë me pjesë të nënrenditur përcaktore, *pjesa e varur lidhet me një gjymtyrë emërore ose përemërore të pjesës drejtuese.*

Nxënësit shkruajnë diagramet dhe rregullat në skedë ose në bllokun e gramatikës.

Më pas ndërtohet Diagrami i Venit për të treguar ndryshimet mes pjesëve të varura rrethore dhe atyre përcaktore.



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: “Punë e pavarur dhe në grup”

Në mënyrë të pavarur dhe në grup zhvillohen ushtrimet:

- Ushtrimi. 2, faqe 97. Shtojuni nga një fjali përcaktore fjalive të mëposhtme.
- Ushtrimi. 3, faqe 97. Dalloni fjalitë me pjesë të nënrenditur përcaktore nga ato me pjesë të nënrenditur filluese e qëllimore.

Një nxënës zhvillon ushtrimin 5 në tabelë: Përcaktimi i fjalive përcaktore. Dallimi i mjeteve lidhëse.

Minitest

Ndërtoni një fjali të përbërë me pjesë të nënrenditur filluese. Provojeni nëse mund ta ktheni pjesën e nënrenditur filluese në rrethore dhe përcaktore.

Vlerësimi:

Vlerësohet nxënësi/ja, që:

- dallon llojet e fjalive të përbëra me nënrenditje rrethore dhe përcaktore;
- veçon mjetet lidhëse (lidhëzat dhe fjalët lidhëse) në fjalitë e përbëra me nënrenditje rrethore dhe përcaktore;
- ndërton fjali të përbëra me nënrenditje rrethore dhe përcaktore.

Detyrë shtëpie:

- Ndërtoni nga një fjali përcaktore, ku si mjete lidhëse të përdorni: që, i cili (pa parafjalë). (Usht. 4, faqe 97)

PLANIFIKIMI ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Rubrika: Të dëgjuarit Ora I Tema mësimore: Shkaqet kryesore të dëgjimit të dobët		Situata e të nxënit: - Gjatë të dëgjuarit vihen re disa shprehje të papërshtatshme, të cilat dëmtojnë marrjen dhe kuptimin e informacionit. Këto shprehje bëhen shkak për një dëgjim të dobët. Po ju a jeni një dëgjues i mirë?	

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e të nxënit - Kompetenca personale - 	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - identifikon fjalët dhe frazat kyçe në një tekst; - dallon idenë kryesore; - dallon detajet; - nxjerr përfundime në lidhje me qëllimin, temën, mesazhin etj.; - harton pyetje të niveleve të ndryshme rreth tekstit; - interpreton informacionin që merr nga burime të ndryshme. 	Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - shprehi të papërshtatshme dëgjimi; shprehi të mira dëgjimi; dëgjim efektiv.
Burimet: materiale dëgjimore, CD, albume fotografike, piktura, libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-charter</i> , shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë ndërvepruese).	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> - TIK; Qytetari.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Puna me fisha, Stuhi mendimi, Leksion i përqendruar , Punë në grup.</i>	
<p style="text-align: center;">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p>Pjesa e parë e orës (45 minuta) Veprimtari paraprake</p> <p>(Puna me fisha) Dëgjohen tekste të ndryshme këngësh dhe u kërkohet nxënësve/eve të riprodhojnë përmbajtjen e asaj çfarë dëgjuan.</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja: Leksion i përqendruar</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shkaqet e shprehive të papërshtatshme të dëgjimit: Tërheqja pa vend e vëmendjes së folësit ose ndërprerja e fjalës së tij. Anashkalimi i materialit të vështirë. Mungesa e respektit për folësin. • Shprehite e mira të dëgjimit: durimi, inkurajimi, të vështruarit në sy. <p>Këshilla për dëgjim efektiv:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Gjeni elementet që lidhen me interesat tuaja. 2. Përmbajtja është e rëndësishme. 3. Dëgjoni idetë. 4. Përqendrohuni. <p>Punë e pavarur dhe në grup Grupi i parë: Përshkruani me radhë pushimet tuaja më të mira ose më të këqija. Gjatë kohës që dëgjoni njëri-tjetrit, bëni edhe komente të ndryshme sipas rastit. Grupi i dytë: (Ushtrimi 2, f. 94) Dëgjoni për të gjetur frazën “e fshehtë”. Zhvilloni një dialog me shokun ose shoqen tuaj. P.sh.: Më pëlqen... të udhëtoj me makinën time duke shëtitur nga një plazh në tjetrin së bashku me shoqërinë time. <i>Noti</i> është një nga hobet e mia, veçanërisht zhytja në...</p>	

Grupi i tretë: (Ushtimi 3, f. 94) Dëgjoni një këngë me vëmendje. Ndahuni në grupe dyshe. Njëri anëtar i grupit harton pyetje për anëtarin tjetër, të cilit i duhet t'u përgjigjet atyre. Pyetjet mund të jenë të tilla që të kenë përgjigje të llojit:

Titulli fillon me një ndajfolje: p.sh.: drejt.

Fjala dashuri përsëritet 6 herë.

Përshkruani.

Një nxënës përshkruan një pikturë, portret apo fotografi. Një nxënës tjetër e dëgjon dhe përpqet ta saktësojë me ndërhyrje të herëpashershme përshkrimin. Një nxënës i tretë duhet të vizatojë mbi bazë të përshkrimit. Në fund zbulohet objekti i përshkruar dhe krahasohet me vizatimin e realizuar.



Sa estetike është natyra!

Çdo pjesëz e saj, sado e vogël, e papunuar dhe në gjendje të egër, d.m.th., e braktisur lirisht në vetvete, po të mos shkelet nga këmba e njeriut, stoliset menjëherë në mënyrën më të bukur, vishet me bimë, lule, kaçube, vetëlindja e të cilave, hijeshia natyrore dhe grupimi i tyre i papërcaktuar paraprakisht tregojnë se nuk janë rritur nën kamxhikun e egoistit të madh, njeriut, por aty natyra ka sunduar lirisht. Çdo pjesë e braktisur bëhet menjëherë e bukur. Mbi këtë bazohet ideja e kopshtit anglez, e cila qëndron në fshehjen e

artit sa të jetë e mundur më shumë, në mënyrë që të duket sikur në kopshtin e ndërtuar ka mbizotëruar lirisht natyra. Vetëm natyra e lirë është plotësisht e bukur, paraqet në qartësinë më të madhe pamje ku gëlon vullneti i jetës, që ende i pavetëdijshëm, shpërthen e krijon gjithmonë me thjeshtësinë, me çiltërsinë më të madhe. **(Shopenhauer)**

Vlerësimi:

Nxënësit/et do të vlerësohen për:

- komunikimin në përputhje me normat shoqërore dhe me vlerat kulturore në situata të ndryshme;
- ndërmarrjen e nismave dhe shprehjen e interesave për çështje të ndryshme;
- përdorimin e imagjinatës dhe shpirtit krijues për zgjidhjen e problemeve;
- demonstrimin e vullnetit dhe gatishmërisë në detyrat individuale dhe në punët në grup;
- pjesëmarrjen aktive në punën në grup.

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Rubrika: Të folurit		Ora II Tema mësimore: Të folurit për të informuar dhe të folurit për të bindur	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none">- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit- Kompetenca e të menduarit- Kompetenca e të nxënit- Kompetenca personale			

<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none">- përshtat gjuhën me qëllimin, temën, dëgjuesin etj.;- mbledh, vlerëson, përzgjedh dhe sintetizon fakte dhe ide nga një sërë burimesh;- ndan informacionin që mbledh, në informacion të rëndësishëm dhe informacion dytësor.	<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none">- të folurit për të informuar; të folurit bindës; performancë e të folurit; detaje informuese dhe bindëse; audienca. <p>Situata e të nxënësve:</p> <ul style="list-style-type: none">- Kur paralajmëroni dikë për kalimin e rrugës, kur përshkruani një situatë të rrezikshme, kur orientoni dikë për rregullat në pishinë, mendoni se flitet për të informuar, apo për të bindur?		
<p>Burimet: materiale informative, albume fotografike, libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-charter</i>, shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë ndërvepruese).</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <ul style="list-style-type: none">- TIK; Qytetari; Biologji.		
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p><i>Lojë me fisha, Stuhi mendimi, Harta semantike, Punë në grupe.</i></p>			
<p style="text-align: center;">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p>Veprimtari paraprake Stuhi mendimi</p> <p>Lojë me fisha</p> <p>U shpërndahen nxënësve fisha me materiale të shkurtra të cilat referohen si tema diskutimi:</p> <p>ADN është akronim për Acidin Desoksiribonukleik. ADN-ja është substanca në të cilën mbartet e koduar, për shumicën e organizmave, informacioni i trashëgimisë, informacioni, i cili kalohet në qelizat bija pas çdo ndarje qelizore. Në këtë mënyrë, ADN-ja është përgjegjëse për strukturën dhe karakteristikat fizike dhe biokimike për gati të gjitha qeniet e gjalla.</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja: Harta semantike</p> <table><tr><td><p>Të folurit për të informuar është një ligjëratë që prezanton një temë të caktuar. Nëpërmjet saj përcillen njohuri, shpjegime, këshilla, parashikime dhe ide që i drejtohen dëgjuesit.</p></td></tr><tr><td><p>Të folurit për të informuar ndryshon nga të folurit bindës, por nuk është e lehtë të vendosësh një vijë të qartë dallimi midis të folurit për të informuar dhe atij bindës. Informacioni i mirë ka një prirje të fortë për të qenë bindës dhe bindja mbështetet në informacione të mira.</p></td></tr></table>		<p>Të folurit për të informuar është një ligjëratë që prezanton një temë të caktuar. Nëpërmjet saj përcillen njohuri, shpjegime, këshilla, parashikime dhe ide që i drejtohen dëgjuesit.</p>	<p>Të folurit për të informuar ndryshon nga të folurit bindës, por nuk është e lehtë të vendosësh një vijë të qartë dallimi midis të folurit për të informuar dhe atij bindës. Informacioni i mirë ka një prirje të fortë për të qenë bindës dhe bindja mbështetet në informacione të mira.</p>
<p>Të folurit për të informuar është një ligjëratë që prezanton një temë të caktuar. Nëpërmjet saj përcillen njohuri, shpjegime, këshilla, parashikime dhe ide që i drejtohen dëgjuesit.</p>			
<p>Të folurit për të informuar ndryshon nga të folurit bindës, por nuk është e lehtë të vendosësh një vijë të qartë dallimi midis të folurit për të informuar dhe atij bindës. Informacioni i mirë ka një prirje të fortë për të qenë bindës dhe bindja mbështetet në informacione të mira.</p>			
<p>Punë e pavarur në grupe</p> <p>Ndahuni në grupe dhe përgatitni një ligjëratë për të informuar rreth temave:</p>			
<p>Grupi 1</p> <p>Origjina e alfabetit</p> <p>Historia e transplantave</p> <p>Karburantet alternative</p>	<p>Grupi 2</p> <p>Gruaja e parë astronute</p> <p>Klonimi i parë i një gjitari</p> <p>Nanoteknologjia</p>		
<p>Grupi 3</p> <p>Mbipesha</p> <p>Kulturat e modifikuara gjenetike</p> <p>Analfabetizmi</p>	<p>Grupi 4</p> <p>Syzet 3D</p> <p>Dieta me pak karbohidrate</p> <p>Ritualet e martesave në vende të ndryshme</p>		

Grupi 5 Komunikimi i kafshëve Stresi dhe efektet e tij Mosbindja civile	Grupi 6 Si zhvillohet një stuhi/uragan/tërmet Historia e kukullës Barbi Ngrohja globale
Vlerësimi: Nxënësit do të vlerësohen: -për reagimin në mënyrë të përshtatshme duke treguar mirëkuptim ndaj folësit; - ndërmarrjen e nismave dhe shprehjen e interesimit për çështje të ndryshme; - demonstrimin e vullnetit dhe gatishmërisë në detyrat individuale dhe në punët në grup; - respektimin e parimeve, vlerave, bindjeve dhe kulturës së të tjerëve; Detyrë shtëpie: - Vlerësoni një ligjëratë informuese të një prezantuesi televiziv, duke përdorur skemën e dhënë në faqen 100.	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Drejtshkrim, Lexojmë Ora I Tema mësimore: Raste të përdorimit të nyjave “të” dhe “së” Ora II Tema mësimore: Tekstet argumentuese		Situata e të nxënit - Rregulla drejtshkimore - Ndërtimi i një teze për temën: “Ndikimi i ambientit në jetën psikologjike dhe morale të njeriut”.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore I: Nxënësi/ja: - përdor drejt nyjën <i>të</i> dhe nyjën <i>së</i> ; - tregon rastet kur duhet përdorur <i>nya të</i> dhe kur duhet përdorur <i>nya së</i> ; - dallon nyjën e rasës gjinore nga <i>nya</i> e fjalës.		Fjalët kyçe: - <i>nyjë</i> ; <i>nyjë</i> e rasës gjinore; <i>nyjë</i> e fjalës; <i>nya të, së</i> ; <i>argumente</i> ; <i>tezë</i> ; <i>antitezë</i> .	

<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore II:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none">- identifikon qëllimin dhe audiencën (lexuesin) e tekstit;- përdor njohuritë paraprake (p.sh., njohuri rreth temës, koncepte të njohura ose njohuri social-kulturore) për të kuptuar tekstin;- shfrytëzon elemente, si: titulli, nëntitujt, organizimi i tekstit, fjalori etj., për të kuptuar tekstin;- përcakton funksionet, llojin, qëllimet teknikat dhe karakteristikat gjuhësore, stilistike dhe strukturore të tekstit argumentues.								
<p>Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none">- teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë, video-projektor.	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <ul style="list-style-type: none">- Letërsi; TIK; Qytetari; Histori.							
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p><i>Stuhi mendimi, Pemë mendimi, Diagram veni, Diskutim, Punë e pavarur/në grup, Harta semantike, Lexim me ndalesa.</i></p>								
<p style="text-align: center;">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p><i>Pjesa e parë e orës (45 minuta)</i></p> <p><i>Veprimtari paraprake: Stuhi mendimi</i></p> <p>Kujtojmë skemën e organizimit të teksteve argumentuese:</p> <table><tr><td>Tema/ Problemi</td></tr><tr><td>Parashtrimi i tezës</td></tr><tr><td>Argumente që mbështesin tezën</td></tr><tr><td>Parashtrimi i antitezës</td></tr><tr><td>Argumente që mbështesin antitezën</td></tr><tr><td>Hedhja poshtë e argumenteve pro antitezës</td></tr><tr><td>Përfundimet</td></tr></table>		Tema/ Problemi	Parashtrimi i tezës	Argumente që mbështesin tezën	Parashtrimi i antitezës	Argumente që mbështesin antitezën	Hedhja poshtë e argumenteve pro antitezës	Përfundimet
Tema/ Problemi								
Parashtrimi i tezës								
Argumente që mbështesin tezën								
Parashtrimi i antitezës								
Argumente që mbështesin antitezën								
Hedhja poshtë e argumenteve pro antitezës								
Përfundimet								
<p><i>Ndërtimi i njohurive të reja: Harta semantike</i></p> <p>Teksti argumentues është ai lloj teksti ku një qëndrim i caktuar mbështetet me argumente dhe prova, me qëllim bindjen e dëgjuesve ose të lexuesve. Tekstet argumentuese i hasim kur trajtohen tema që mund të kenë të bëjnë me situata historike ose sociale, me çështje praktike të përditshmërisë, me aktualitetin, me argumente teknike e profesionale, me ligjërimin politik etj.</p>								
<p>Teknikat e teksteve argumentuese</p> <p>Në thelb të tekstit argumentues qëndron tema ose problemi rreth të cilit mbahet një qëndrim. Autori i tekstit më tej shpalos mendimin e tij rreth kësaj teme, pra tezën e tij.</p>								

Me qëllim që t'i bindë lexuesit rreth vlefshmërisë së tezës së tij, autori paraqet prova dhe argumente në favor të tezës.
Për ta bërë më të plotë trajtesën argumentuese, autori mund të prezantojë edhe antitezën , pra tezën e kundërt me të tijën, të cilën e shoqëron po ashtu me argumentet përkatëse .
Në fund ai i hedh poshtë argumentet e antitezës , duke ripohuar kështu vërtetësinë e argumenteve të tezës së tij.
Në fund autori mbërrin në konkluzione, ku rithekson qëndrimin e tij (pra tezën) në lidhje me problemin e diskutuar.

Punë e pavarur në grupe

Lexohet reklama në faqen 110.

Grupi i parë: Në reklamën e mëposhtme janë përcaktuar elementet përbërëse të strukturës argumentuese. Nxënësi/ja heton dhe dallon tezën e reklamës dhe jep argumente se përse autori nuk e ka përfshirë haptazi tezën e tij.

Gjen fjalë dhe shprehje që autori i përdor për të parashtruar argumentet në mbështetje dhe kundër tezës së tij.

Dallon se cilës fushë leksikore i përkasin fjalët e termat e reklamës.

Grupi i dytë: Përmbledh me nga një fjali secilin nga argumentet që autori ka paraqitur në mbështetje të tezës së tij.

Grupi i tretë: Shkruan një tekst argumentues për temën “Mjekësia popullore alternative”, sipas skemës së dhënë në f. 109. Kërkon informacione (enciklopedi, internet etj.) për të paraqitur argumente sa më të qëndrueshme në mbështetje të tezës.

Vlerësimi:

Nxënësi/ja vlerësohet për:

- rrjedhshmërinë gjatë të lexuarit;
- ndarjen e përvojave të leximit me të tjerët;
- respektimin dhe pranimin e mendimit të të tjerëve në raport me lexime të ndryshme;
- respektimin e etikës gjatë komunikimit personal dhe në grup;
- vlerësimin e kontributit të të tjerëve gjatë kryerjes së një detyre;
- shfaqjen e tolerancës dhe respektit për kulturën dhe për gjuhën e tjetrit.

Detyrë shtëpie: Gjenero tekstin e një fjalimi të një politikani në fushatë elektorale dhe thoni se mbi cilën strukturë është hartuar ky fjalim. A ka më tepër argumente në mbështetje të një teze apo të një antiteze? Gjuha i përket stilit të veprimtarisë politiko-shoqërore apo veprimtarisë juridiko-administrative? A mban ky fjalim gjurmë të ligjërit të shkujdesur që del jashtë normës letrare? Ilustroni përgjigjet tuaja me referenca nga teksti.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Leksikologji Ora I Tema mësimore: Analizë teksti argumentues		Situata e të nxënit: - Diskutim rreth dokumentit të parë të shkruar në gjuhën shqipe.	

Ora II Tema mësimore: Ligjërimet në gjuhën shqipe	- Fragmente.
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore I: Nxënësi/ja: - dallon tezën dhe argumentet në mbështetje të saj në tekstin argumentues të lexuar; - dallon antitezën dhe argumentet në mbështetje të saj në tekstin e lexuar; - arrin në konkluzione rreth përfundimit të tekstit; - arrin në konkluzione rreth saktësisë së parafrazimeve të dhëna. Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore II: Nxënësi/ja: - përcakton llojet e ligjërimeve në gjuhën shqipe; - analizon tiparet e ligjërimit të thjeshtë, të ligjërimit bisedor dhe të ligjërimit libror; - krahason ligjërimin bisedor me ligjërimin e thjeshtë; - dallon llojin e ligjërimit në një tekst; - ndërton tekste të shkurtra, të cilat kanë tiparet e ligjërimit të thjeshtë, të ligjërimit bisedor ose të ligjërimit libror.	Fjalët kyçe: - ligjërim i thjeshtë; ligjërim bisedor; ligjërim libror; tipare.
Burimet: - teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë, Fjalori i gjuhës Shqipe, FESH, video-projektor.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - TIK.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Stuhi mendimi, Lexim me ndalesa, Harta semantike, Punë në grupe, Pemë mendimi, Diagram Veni, Punë e pavarur/në grup.</i>	
<p style="text-align: center;">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p>Pjesa e parë e orës (45 minuta) Veprimtari paraprake: Stuhi mendimesh Diskutim rreth Mesharit të Gjon Buzukut</p>	

Që nga botimi e deri më 1740, gati dy shekuj, "Meshari" ishte një vepër e humbur, një vepër e panjohur. Më 1740 u zbulua në Bibliotekën e Propaganda Fides, afër Romës, Mesharin e don Gjon Buzukut (1555) e zbuloi ipeshkvi i Shkupit Imzot Gjon Nikollë Kazazi nga Gjakova.

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim me ndalesa dhe koment

Lexohet fragmenti: Dëshmi që provojnë se "Meshari" është hartuar nga Gjon Buzuku.

Referime, argumente të dhëna nga: Buzuku, Selman Riza, Martin Camaj.

Zëvendësim i fjalës: ...se vepra e njohur si "Meshari", në **qenësinë** e vet, është e hartuar nga ai vetë. Fjala mund të zëvendësohet me fjalën: formën, ekzistencën e vet.

Punë e pavarur në grupe

Grupi i parë: Cila është struktura mbi të cilën është ndërtuar ky tekst argumentues?

Citim

Këtë, në një mënyrë ose në një tjetër, na e thotë vetë Buzuku në *Pasthënien*, ku përmend se mbi të gjitha dëshironte të mbaronte veprën që t'i pëlqente Hyjit: "E u mā duo te mbaronj vepërënë...

Teza

...se vepra e njohur si "Meshari", në qenësinë e vet, është e hartuar nga ai vetë.

Argumente për tezën

Për këtë gjë Martin Camaj shkruan "Njëmend, Buzuku i shfrytëzoi tekstet e këtilla biblike po më tepër se një përkthyes shpeshherë duhet të çmohet si një hartues...

Grupi i dytë: (Ushtrimi 6, faqe 113) Si realizohet përfundimi i tekstit?

Nga mbyllja: Nga ajo që u tha, mund të nxirret përfundimi se vepra e Buzukut është një zgjedhje – përmbledhje tekstesh të karakterit...


Mbyllja e mësipërme është sintetike, përmbledh argumentet e dhëna dhe paragrafi fillon me një frazë formale tipike për gjuhën e argumentimit.

Grupi i tretë: Nxënësit argumentojnë se cili është parafrazimi më i saktë në citimin e dhënë. (Ushtrimi 7 faqe 113) Në parafrazim duhet të jepen të sakta dhe të plota të gjitha informacionet dhe ai të jetë sa më i kuptueshëm, pa fjalë të paqarta apo të vështira. Në ushtrimin e dhënë duket se varianti **a.** i përmbush këto kritere.

Pjesa e dytë e orës (45 minuta)

Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në grup, Stuhi mendimi

Me teknikën "Stuhi mendimi" u shpjegohet nxënësve kuptimi i fjalës *ligjërim*.




Variant i gjuhës me disa veçori dalluese;

stil i gjuhës, mënyrë të foluri

Ndërtimi i njohurive të reja:

Me teknikën “Pemë mendimi” paraqiten llojet e ligjërimeve në gjuhën shqipe.



Punë e drejtuar


Leximi i tri fragmenteve faqe 114, 115. Diskutim për gjuhën e përdorur në secilën prej tyre.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: “Punë e pavarur dhe në grup”

- Tregoni cilit ligjërim i përkasin. (Usht. 1, faqe 116)
- Ushtimi 2, faqe. 116, zhvillohet nga tre nxënës në tabelë, duke vendosur pranë çdo grupi të dhënë fjalësh sinonimin e tij në ligjërimin e thjeshtë, bisedor dhe libror.

Punë në grup

Nxënësit plotësojnë diagramin me tipare të secilit ligjërim.



Vlerësimi:

Nxënësit/et do të vlerësohen për:

- dallimin e tezës dhe argumenteve në mbështetje të saj;
- dallimin e antitezës dhe argumenteve në mbështetje të saj;
- qëndrimin e autorit lidhur me temën;
- vlerësimin e saktësisë së informacioneve të dhëna;
- parafrazimin e fjalive duke synuar qartësinë dhe koherencën e frazës;
- analizën e tipareve të ligjëritit të thjeshtë, të ligjëritit bisedor dhe të ligjëritit libror;
- krahasimin e ligjëritit bisedor me ligjëritin e thjeshtë.

Detyrë shtëpie:

– Parafrazoni citimin: “Meshari i Buzukut do parë si një vepër komplekse, në prozë, pak edhe në poezi, me përkthime, po edhe me pjesë origjinale ndofta edhe me tekste jo vetëm nga Buzuku, por edhe nga autorë të tjerë ose shqipëruar, që mbeten anonimë, prej të cilëve Buzuku huazoi, por edhe u përpoq t’i adaptonte në shqipen që ai shkruante vetë”.

– Ndërttoni tri tekste të shkurtra me tipare të ligjërimit të thjeshtë, bisedor dhe libror. Çfarë vini re?

Diskutoni. (Usht. 4, faqe 97)

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Leksikologji Ora I Tema mësimore: Studim tekstesh të dëgjua Ora II Tema mësimore: Stilet funksionale të gjuhës: <i>stili i letërsisë artistike dhe stili politiko-shoqëror</i>		Situata e të nxënësve - Komentoni titullin e kësaj interviste: “Gjuha shqipe një nga makinat më të përsosura të Evropës”. - Fragmente: Faik Konica “Malli i Atdheut”.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore I: Nxënësi/ja: - reflekton ndaj informacionit të dëgjuar; - rikujton përmbajtjen e informacionit, si dhe analizon mënyrën në të cilën stili dhe struktura e një fjalie ose e një ligjërate mbështet qëllimin e saj; - reflekton mbi informacionin e dëgjuar, si dhe përgjigjet në mënyrë të përshtatshme; - demonstroi aftësitë e domosdoshme të të dëgjuarit kritik Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore II Nxënësi/ja: - përcakton kuptimin e termit “stil funksional”; - përcakton se cilit stil i përket një tekst;		Fjalët kyçe: - dëgjim i orientuar; shprehje të mira të dëgjimit; Kongresi i drejtshkrimit; fraza kyçe informuese; ligjërimit i thjeshtë, ligjërimit bisedor, ligjërimit libror, tipare; stil funksional.	

<ul style="list-style-type: none"> - analizon elementet kryesore të secilit stil; - krahason stilet me njëri-tjetrin. 	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti mësues, skeda, bllok gramatike, tabelë, Fjalori i gjuhës Shqipe, FESH, video-projektor. 	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> - TIK.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Punë në grupe dyshe, Dëgjim i fragmentuar dhe pyetje-përgjigje, Stuhi mendimi, Pemë mendimi, Diagram Veni, Punë e pavarur/në grup.</i>	
<p style="text-align: center;">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p>Pjesa e parë e orës (45 minuta) Veprimtari paraprake: <i>Punë në grupe dyshe</i> Njëri përgatit tekstin duke u bazuar frazat e dhëna, ndërsa tjetri shkruan fjalitë ku janë përdorur këto fraza, ndërkohë që dëgjon tekstin e hartuar nga shoku ose shoqja e grupit. <i>P.sh: Unë zakonisht filloj të studioj në orën 5 pasdite. Më duhen rreth 2 orë pushim pasi vij nga shkolla që të mundem të rifilloj sërish studimin. Gjithashtu, zakonisht, vendos muzikë në sfond...</i></p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Dëgjim i fragmentuar dhe pyetje-përgjigje</i> Dëgjohej e fragmentuar intervista e Ismail Kadaresë mbi Kongresin e Drejtshkrimit. Dëgjohej fragmenti 1 dhe drejtohej pyetja: <i>Po ju, çfarë mendimi keni për Kongresin e Drejtshkrimit?</i></p> <p>Model përgjigjeje: Pa dyshim që rëndësia e këtij kongresi është unike dhe e madhe pasi në të u vendosën rregullat dhe normat gjuhësore, shina mbi të cilat eci që prej ngulitjes së tij, gjuha shqipe. Gjuha ka evoluar dhe është në zhvillim, kështu që ndryshimet në të duheshin ndjekur, pra duheshin bërë ndryshimet e nevojshme. Kritikën ndaj këtij kongresi më duken të pavlera. Po kështu veprohet edhe për fragmentet në vijim.</p> <p>Punë e pavarur në grupe Pas dëgjimit të tekstit në ushtrimin 7, faqe 123 diskutohet rreth pyetjeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Si mendoni, në ç'fushë ka ndryshuar bota këto vitet e fundit?</i> Përgjigje: Teknologjia ka dominuar në territorin e komunikimit. Risitë e teknologjisë janë të shumta, por e parë në këtë aspekt mund të thuhet se është fuqizuar bota virtuale. - <i>Si mendoni, a janë më cilësore marrëdhëniet tradicionale të komunikimit?</i> Përgjigje: Komunikimi i drejtpërdrejtë mbetet më i qarti dhe i sakti, pasi të parit sy më sy jep mundësinë e njohjes së gjuhës së trupit, mimikës dhe gjesteve, gjë e cila nuk mund të mbulohet me simbolet e internetit. - <i>Marrëdhënia me rrjetet sociale ua ka shtuar apo ua ka pakësuar miqtë?</i> Përgjigje: Miqtë e rrjeteve sociale kryesisht mbeten aty, në botën virtuale. Jashtë saj, rrallë ata mund të jenë miq aktivë në jetën tonë. <p>Punë e pavarur (Ushtimi 4, faqe 122) Bëni një dialog me shokun ose shoqen tuaj, duke luajtur rolin e këshilluesit në situatat e dhëna në tekst. Situata: Shoku/shoqja dëshiron që të bëhet i/e pasur dhe mendon që të fillojë punë menjëherë, sepse shkolla e lartë është humbje kohe. Përgjigje: Nxitimi në këtë rast do ishte rruga e gabuar, pasi në asnjë profesion nuk mund të arrish diçka, pa arsimin përkatës. Sa më vonë ta kuptosh këtë, aq më negative do të jetë situata.</p> <p>Pjesa e dytë e orës (45 minuta)</p>	

Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në grup, Stuhi mendimi

Lexohet fragmenti “Malli i Atdheut” në faqen 124. U kërkohet nxënësve/eve të shprehin se çfarë mendojnë për gjuhën e përdorur.

Malli i atdheut


Kur vete njeriu, i lirë e i vetëm, larg atdheut – viset e reja, ndryshimi i zakoneve, ëmbëlsia e udhëtimit e një mijë gjëra që vihen re ndër popuj të huaj, të gjitha këto ta përgëzojnë zemrën e të bëjnë jo të harrosh Shqipërinë, po mos të të vejë tek ajo aq dendur mendja. Më tutje, si ngopen sytë së pari me ndryshime, gazi shuhet pak nga pak. S’di ç’të mungon, s’di se ç’të duhet.

Një hije trishtimi ta mbulon fytyrën; e, pikë së pari herë-herë, mbastaj më dendur e më në fund shpesh e pothuaj kurdo e kudo, kujtimi i prindërve, i miqve e shokëve, kujtimi i dheut ku u lindëm e u rritëm, ku qajtëm foshnja e ku lozëm djelm, kujtimi i atyre maleve larg të cilave nuk rron dot mirë një shqiptar, kujtimi i kombit, që, me gjithë ca të liga që ka, është kombi ynë, e më tepër kujtimi e dëshira e etja e gjuhës sonë ta shtrëngojnë e ta dërmojnë me të vërtetë zemrën. Ah, malli i Shqipërisë, malli i atdheut të dashur, i shenjtë mall e dashuri e shenjtë, kush është ai shqiptar që s’e ka pasur në dhe të huaj!

Duhet të jesh jashtë Shqipërisë, e të jesh larg, për të kuptuar se ç’forcë e ç’bukuri të ëmbël ka për veshët kjo fjalë: Shqipëri! Ajo më e zbrazura letër, ajo fjala më e vogël, na sjell, kur vjen nga Shqipëria, një gaz të parrëfyeshëm, se na sjell si një copë të atdheut...

F. Konica

Mësuesi/ja me teknikën “Stuhi mendimi” paraqet fushën në të cilën realizohet komunikimi; stilet përkatëse për secilën fushë. Si dhe tipare të gjuhës së letërsisë artistike, të gjuhës së stilit politiko-shoqëror.



<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: “Punë e pavarur dhe në grup”</p> <p>Në mënyrë të pavarur dhe në grup zhvillohen ushtrimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ushtrimi. 2, faqe 127. Gjeni fjalët e shprehjet karakteristike për stilin e letërsisë artistike. - Ushtrimi. 3, faqe 127. Fjalët <i>marr, akull, zjarr, pikë, shenjë, mendje, orë, bie</i> përdorini në përshkrimin e disa situatave apo gjendjeve: në stilin e letërsisë artistike, në stilin politiko-shoqëror.
<p>Vlerësimi:</p> <p>Vlerësohet nxënësi/ja, që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcakton kuptimin e termit “stil funksional”; - përcakton se cilit stil i përket një tekst; - krahason stilet me njëri-tjetrin. <p>Detyrë shtëpie:</p> <p>– Gjeni në gazeta a revista tekste të stileve ndryshme nga fusha e letërsisë artistike, e veprimtarisë politike e shoqërore, e veprimtarisë shkencore e teknike, e veprimtarisë juridike e administrative, duke nënvizuar fjalët, shprehjet karakteristike të tyre.</p>

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
<p>Rubrika: Njohuri gjuhësore</p> <p>Leksikologji, Të flasim</p> <p>Ora I</p> <p>Tema mësimore: Përsëritje. Stili i letërsisë artistike</p> <p>Ora II</p> <p>Tema mësimore: Fjalimi bindës</p>	<p>Situata e të nxënit:</p> <p>- Gazeta, revista.</p> <p>Situata e të nxënit: A e dini se fuqia e fjalës së njerëzve të mëdhenj ka ndryshuar historinë?</p> <p>Përmendim disa prej tyre: <i>Abraham Lincoln, Franklin D. Roosevelt, Indira Gandhi, Sir Uinston Churchill.</i></p>	<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit 	
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore 1</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcakton se cilit stil i përket një tekst; - analizon elementet kryesore të secilit stil; - krahason stilet me njëri-tjetrin. 	<p>Fjalët kyçe:</p> <p>- stil funksional; stil i letërsisë artistike; tipare; efektshmëri; analiza e audiencës; mesazh bindës fjalim; prezantim.</p>		


Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore II: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - paraqet alternativën personale mbi çështjen ose tekstin e caktuar; - vlerëson përfundimet e një diskutimi; - merr nismën të ndryshojë rrjedhën e një diskutimi; - përdor përmbajtje të përshtatshme për qëllime, audienca, situata dhe kontekste të caktuara; - parashtron argumentin përmes një përmbajtjeje të ngjeshur, duke respektuar faktorin kohë; - merr parasysh rolin e dëgjuesit, të qëllimit, të situatës dhe të kontekstit në një diskutim. 	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti mësimor, tabelë, fletë A4, gazeta, revista. 	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> - Letërsi; Qytetari; Histori.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:

Stuhi mendimi, Diskutim, Ese 5-10 min., Di, dua të di, mësova, Diagram Veni, Punë e pavarur/në grup.

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT
Pjesa e parë e orës (45 minuta)

Mësuesi/ja me teknikën “Stuhi mendimi” paraqet fushat në të cilën realizohet komunikimi; stilet përkatëse për secilën fushë dhe diskuton së bashku me nxënësit.



Diskutim i detyrave të shtëpisë. Nxënësit lexojnë fragmentet e nxjerra nga gazeta a revista të stileve të ndryshme nga fusha e letërsisë artistike, veprimtarisë politiko-shoqërore, shkencore-teknike dhe juridiko-administrative.

Ata specifikojnë fjalë dhe shprehje në tabelë sipas fushave.

letërsi artistike	politiko-shoqërore	shkencore-teknike	juridiko-administrative

Përmes teknikës “*Di, Dua të di, Mësova*”, nxënësit kontrollojnë njohuritë e tyre.


DI	Dua të di	Mësova
Stili Fusha	Fjalë dhe shprehje sipas fushave	Tipare të gjuhës

Ese 5-10 min

Nxënësit të ndarë në dy grupe u kërkohet të ndërtojnë në stilin e letërsisë artistike dhe në stilin politiko-shoqëror nga një tekst me temë “Atdheu ynë”. Secili nxënës përzgjedh vetë se në cilin stil do të përshkruajë.

Leximi dhe diskutimi i shkrimeve.

Dallimi midis stileve përmes “Diagramit të Venit”.



Pjesa e dytë e orës (45 minuta)

Veprimtari paraprake: Diskutim i lirë rreth situatës

Diskutim rreth proverbit:

Kush pyet, komandon.

Pyetjet janë një instrument jetik për të mësuar dhe shmangur moskuptimet, por edhe një instrument për të shuar një konflikt dhe për të bindur një person, pasi një sërë pyetjesh të hapura do ta ndihmonin audiencën të kuptonte arsyet që qëndrojnë pas pikëpamjes suaj.

Ndërtimi i njohurive të reja: Leksion i përqendruar hap pas hapi

1. Përcaktimi. Një fjalim bindës është një lloj specifik fjalimi, në të cilin folësi ka për qëllim bindjen e audiencës për të pranuar pikëpamjen e tij.

2. Efektshmëria. Një fjalim bindës varet edhe nga faktorë, si: gjuha e trupit të folësit dhe mjedisi në të cilin mbahet fjalimi.

3. Analiza e audiencës është një faktor i rëndësishëm, pasi audienca do të bindet për arsyet e veta, jo për arsyet e folësit.

4. Këshilla për të bindur: Kush pyet, komandon. Jepini rëndësi tjetrit!

5. Përgatituni! Sqaroni objektivin që dëshironi të arrini, parashikoni përgjigjet e mundshme, simuloni skenarë të ndryshëm.

6. Praktikoni fjalimin tuaj. Praktikimi është një nga mënyrat më të besueshme për të siguruar sukses.

Punë e pavarur në grupe

Grupet punojnë me hartimin e një fjalimi bindës, për një nga temat e mëposhtme:

- Provimet e maturës janë si çdo provim tjetër
- Mbingarkesa me studime është çështje perceptimi

Vlerësohen përbërësit e mesazheve bindëse të njëri-tjetrit:

- Sintetizimi i të dhënave dhe fakteve të situatës.
- Shprehja e mendimeve dhe e ndjesive.
- Shprehja qartësisht e dëshirave dhe nevojave, duke përfshirë ndikimet pozitive për audiencën.

Vlerësimi:

Nxënësi/ja, vlerësohet për:

- përcaktimin se cilit stil i përket një tekst;
- ndërtimin e një teksti në stilin e letërsisë artistike dhe në stilin politiko-shoqëror.
- komunikimin në përputhje me normat shoqërore dhe me vlerat kulturore në situata të ndryshme;
- ndërmarrjen e nismave dhe shprehjen e interesimit për çështje të ndryshme;
- përdorimin e imagjinatës dhe shpirtin krijues për zgjidhjen e problemeve;
- demonstrimin e vullnetit dhe të gatishmërisë në detyrat individuale dhe në punët në grup.

Detyrë shtëpie:

- Ndërtoni një minifjalor me fjalë dhe shprehje nga fusha e letërsisë artistike dhe politiko-shoqërore.

(Ushtrimi 3 dhe 4 në faqen 131) Analizoni fjalimin e një politikani, duke nxjerrë në pah mangësitë e tij.

Vlerësoni sipas skemës së mësipërme përbërësit e mesazhit bindës nga fjalimi i një personaliteti.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Leksikologji Ora I Tema mësimore: Stilet funksionale të gjuhës: <i>stili shkencor-teknik dhe stili juridiko-administrativ.</i> Ora II Tema mësimore: Përsëritje. Stilet funksionale të gjuhës		Situata e të nxënit - Neni 14.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore I Nxënësi/ja: - përcakton se cilit stil i përket një tekst; - analizon elementet kryesore të secilit stil; - krahason stilet me njëri-tjetrin. Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore II Nxënësi/ja: - përcakton se cilit stil i përket një tekst; - analizon elementet kryesore të stilit shkencor-teknik dhe stilit juridiko-administrativ; - krahason stilet me njëri-tjetrin.		Fjalët kyçe: - stil funksional; stil shkencor-teknik; stil juridiko-administrativ.	
Burimet: - teksti mësimor, tabelë, tablo, flipçart, video-projektor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Stuhi mendimi, Pemë mendimi, Diagram Veni, Punë e pavarur/në grup</i>			

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT***Pjesa e parë e orës (45 minuta)******Ndërtimi i njohurive të reja: Puna me fisha***

U shpërndahen nxënësve/eve dy paragrafë të ndryshëm në dy tablo. Tablotë mund të paraqiten edhe në video-projektor, ose flipçart. U kërkohet të vërejnë për gjuhën e përdorur në këto dy paragrafë.

Fisha 1.**Neni 14**

1. Gjuha zyrtare në Republikën e Shqipërisë është shqipja.
2. Flamuri kombëtar është i kuq me një shqiponjë të zezë dykrenore në mes.
3. Stema e Republikës së Shqipërisë paraqet një shqyt me fushë të kuqe me një shqiponjë të zezë dykrenore në mes. Në krye të shqytit, me ngjyrë të artë, është vendosur përkrenarja e Skënderbeut.
4. Himni kombëtar është “Rreth Flamurit të Përbashkuar”.
5. Festa Kombëtare e Republikës së Shqipërisë është Dita e Flamurit, 28 Nëntori.
6. Kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë është Tirana.
7. Forma dhe përmasat e simboleve kombëtare, përmbajtja e tekstit të himnit kombëtar, si dhe përdorimi i tyre rregullohen me ligj.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Fisha 2.

Vetia që ka atomi i një elementi kimik për t’u bashkuar me një numër të caktuar atome të një elementi, quhet valenca e tij. Valenca e një elementi është një numër që tregon me sa atome hidrogjeni mund të lidhet një atom i elementit përkatës ose sa atome hidrogjeni mund të zëvendësojnë një atom të këtij elementi. Valencat më të larta për shumicën e elementeve janë të bazuara në numrin e elektroneve të lira në shtresën e fundit. Valenca e një elementi përcaktohet, duke e krahasuar me valencën e hidrogjenit. Valenca e një elementi paraqitet me numër romak, i cili shënohet në kllapa pas emrit të elementit.

Të mbajmë mend!

✎ *Stili shkencor-teknik është ai stil që transmeton nëpërmjet nivelit të lartë formal të gjuhës dije nga fusha të ndryshme, si ajo e shkencave shoqërore, shkencave natyrore, teknikës, teknologjisë etj.*

Mësuesi/ja përmes “Stuhi mendimi” paraqet tipare të stilit shkencor-teknik dhe stilit juridiko- administrativ. Nxënësit plotësojnë diagramin me tipare të secilit stil.



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: “Punë e pavarur dhe në grup”

Në mënyrë të pavarur dhe në grup zhvillohen ushtrimet:

- Ushtrimi. 2, faqe 134. Vendosni fjalitë sipas stilit përkatës.
- Ushtrimi. 4, faqe 134. Gjeni fjalët dhe shprehjet karakteristike për stilin shkencor-teknik dhe diskutoni rreth tyre.

Pjesa e dytë e orës (45 minuta)

Punë në grupe dyshe

U shpërndahen nxënësve disa tekste:

MENDIMI POLITIKO-SHOQËROR, SHKRIMI DHE SHKOLLA SHQIPE



PASHKO VASA

(1825-1892)

Radhitet ndër njerëzit e mëdhenj të Rilindjes që hodhën themelet e ideologjisë së saj dhe u shquan në fushën e mendimit e të veprimit politik dhe në atë të krijimtarisë letrare. U lind në Shkodër ku kreu mësimet e para. Pasi kreu studimet e mesme në Venedik, punoi si sekretar i konsullatës britanike në Shkodër, por shpejt e braktisi atë detyrë dhe rreth vitit 1847 u hodh në Itali, ku mori pjesë në luftën çlirimtare të italianëve kundër zgjedhës së huaj. Por lufta e sakrifikat e tij për çlirimin e Italisë u shpërblyen me intriga e përndjekje që e çuan në burg. I zhgënjyer, shtrëngohet të vendoset në Stamboll, ku më pas zuri vende me rëndësi në administratën osmane. Por kjo nuk e pengoi të lidhej me lëvizjen atdhetare të shqiptarëve dhe të bëhej një nga figurat kryesore të saj. Veprimtarinë më të dendur e zhvilloi në vitet 70, kur bashkë me Kostandin Kristoforidhin u përpoqën për krijimin e një shoqërie për përhapjen e shkrimit shqip dhe për zgjimin e vetëdijes kombëtare. Në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, krahas Abdyl Frashërit, u shqua si një nga figurat kryesore të Komitetit të Stambollit. Më 1878, ai u gjend në Kosovë. Duke qenë në epiqendër të ngjarjeve, që shënuan fillimin e një epoke të re në historinë e përpjekjeve të shqiptarëve për liri e për shtet të pavarur kombëtar, ai u bë një nga veprimtarët më aktivë për organizimin e Lidhjes dhe për njohjen ndërkombëtare të çështjes shqiptare. Me anë të disa memorandumeve drejtuar qarqeve diplomatike angleze e austro-hungareze dhe sidomos me anën e memorandumit të njohur të 20 qershorit 1878, shkruar padyshim me dorën e tij dhe drejtuar përfaqësuesve të shteteve pjesëmarrëse në Kongresin

e Berlinit, Pashko Vasa, ndër të parët politikanë e diplomatë shqiptarë, i bëri të pranishëm opinionit ndërkombëtar faktin se “po lind një çështje e re, çështja shqiptare”.

SAMI FRASHËRI (1850-1904)

Një kontribut të madh në përpunimin e në zhvillimin e mëtejshëm të mendimit politiko-shoqëror e filozofik shqiptar dha ideologu i shquar i Rilindjes Kombëtare Sami Frashëri.

Samiu ishte një nga themeluesit e kulturës në gjuhën shqipe që lulëzoi në gjysmën e dytë të shek. XIX. Ai shkroi 5 tekste për shkollën e parë shqipe, më të mirat ndër ato që ishin botuar deri atëherë. Një vlerë të veçantë ka “Shkronjëtorja e gjuhës shqip” (1886), një nga gramatikat më të mira, hartuar në të kaluarën. Në të Samiu dha sistemin gramatikor të gjuhës shqipe, përpunoi kategoritë e saj themelore dhe formuloi terminologjinë përkatëse, një pjesë e së cilës i ka qëndruar me sukses kohës.

Ai u dallua si një punonjës i palodhur në fushën e letërsisë e të shkencës. Rezultatet e studimeve të tij i botoi turqisht me emrin Shemsettin Sami ose Sh. Sami Frashëri. I dha kulturës turke mbi 40 vepra, shumica origjinale, disa përkthime, një pjesë të të cilave mbetën të pabotuara. Në listën e gjatë të veprave të Samiut ka shkrime letrare, novela e drama, fjalorë e tekste shkollore, broshura për popullarizimin e njohurive shkencore, studime mbi gjuhësinë e letërsinë turke e arabe. Samiu i dha popullit turk të parin fjalor normativ dhe etimologjik të turqishtes (Kamus-i-Turki) dhe të parën enciklopedi të historisë e të gjeografisë të botuar në 6 vëllime (Kamus-ul-alam). Ai drejtoi gjithashtu disa organe shtypi, gazeta e revista, si “Feneri” (1873), “Kopështi” (1873), “Mëngjesi” (1876), “Zëdhënësi i Lindjes” (1878) dhe “Java” (1881).

Në gjithë pasurinë letrare e publicistike dallohet kryevepra e tij në gjuhën shqipe “Shqipëria ç’ka qënë ç’është e ç’do të bëhet?” (1899), e cila me të drejtë është çmuar edhe si manifesti politik i Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Idetë e orientimet e kësaj vepre, së bashku me ato të fjalëve të urta të botuara në turqisht dhe të të gjithë veprës së tij të gjerë shkencore, e bëjnë Samiun një nga dijetarët më në zë që ka nxjerrë historia e popullit shqiptar, atdhetarin e madh dhe humanistin e shquar të kulturës kombëtare shqiptare.

LETËRSIA ARTISTIKE – RUJTËSE E KULTURËS GJUHËSORE TË KOMBIT

Kultura gjuhësore e letërsisë artistike ndikon në evoluimin e gjuhës në tërësi. Ngulitja e normës, standardizimi do të thotë në një kuptim ngadalësim i zhvillimit të vetvetishëm gjuhësor.

Letërsia dhe gjuha e gjallë e folur e kompensojnë këtë shmangie nga ecuria spontane. Letërsia luan rol të veçantë për marrëdhëniet e gjuhës së normuar me format e tjera, sidomos jostandarde, të trajtës së shkruar me trajtën e folur. Nëpërmjet letërsisë artistike jo vetëm zgjerohen mundësitë shprehëse të shqipes, por edhe përtërihen ato, shtjellohen më tej ose edhe krijohet diçka e re. Një vepër letrare është edhe një qëndrim ndaj gjuhës për kohën e vet, të parë me syrin e artistit të fjalës. Letërsia shfrytëzon të gjitha mundësitë e organizimit të gjuhës në stile. Mund të thuhet se gjuha e letërsisë është një shndërrim specifik i gjuhës së përditshme në gjuhën e artit letrar. Në letërsi gjen shfaqje më të qartë e më të qenësishme natyra kombëtare e gjuhës.

Normat juridiko-administrative. Veçoritë specifike të tyre.

Fjala “administratë” e ka prejardhjen nga latinishtja e vjetër “administër”. Përdorej nga romakët për të treguar veprimtarinë që zhvillohej nën varësinë dhe nën drejtimin e dikujt. Fillimet e së drejtës administrative, si degë e veçantë e të drejtës si dhe ato të shkencës së saj i gjejmë në Francë. Së këndejmi, Franca konsiderohet si djep i të drejtës administrative.

E drejta administrative, në kuptimin e sotëm modern të saj, është zhvilluar vonë, në periudhën e feudalizmit të vonshëm. Kështu, nga fundi i shekullit 17-te në Francë duken fillimet e gjyqësisë administrative, kurse në shekullin 18-te, kryesisht është caktuar parimi sipas të cilit para mbretit ose para itendeteve të tij, pra në radhë të parë para organeve administrative shqyrtohen të gjitha konfliktet në lidhje me dekretet administrative të mbretit.

Në literaturën juridike si dhe në legjislacionin përkatës ndeshim shpeshherë nocione të tilla si: administratë shtetërore, veprimtari ekzekutive, veprimtari publike etj., dhe në raste të tilla autorët japin kuptime të ndryshme ose vënë shenjën e barazimit midis tyre.

VETËTIMA

Vetëtima është një dukuri natyrore ajrore, e cila paraqitet me përplasjen e e dy reve të mëdha që lëshojnë një rreze shumë të nxehtë deri në tokë. Gjithashtu shpesh vetëtimat shkaktajnë vdekje të njerëzve, për shkak të nxehtësisë që transporton ajo në tokë (që është sa 5-fishi i nxehtësisë diellore). Vetëtimat zakonisht janë ngjyrë të bardhë. Kur ne shohim vetëtimën do vëmë re se më parë do të shohim dritën që ajo lëshon dhe më pas do të dëgjojmë zhurmën që shkaktohet nga përplasia e reve me njëra-tjetrën. Kjo ndodh sepse shpejtësia e dritës është më e madhe se shpejtësia e zërit. Ajo e zëvendëson përplasjen e reve në vetëtima.

Nxënësit lexojnë fragmentet e stileve të ndryshme nga fusha e letërsisë artistike, veprimtarisë politiko- shoqërore, shkencore-teknike dhe juridiko-administrative.

Ato specifikojnë fjalë dhe shprehje në tabelë sipas fushave.

letërsi artistike	politiko-shoqërore	shkencore-teknike	juridiko-administrative

Punë në grup

Minifjalorin me fjalë dhe shprehje nga fusha e letërsisë artistike dhe politiko-shoqërore, detyrë e një ore më parë u kërkohet ta plotësojnë edhe me fjalë dhe shprehje nga fusha shkencore-teknike dhe juridiko-administrative, duke i vendosur në tabelë.

A	B	C	Ç	D	DH	E	Ë	F	G
GJ	H	I	J	K	L	LL	M	N	NJ

O	P	Q	R	RR	S	SH	T	TH	U
V	X	XH	Y	Z	ZH				

Vlerësimi:

Vlerësohet nxënësi/ja, që:

- përcakton se cilit stil i përket një tekst;
- analizon elementet kryesore të stilit shkencor-teknik dhe stilit juridiko-administrativ;
- krahason stilet me njëri-tjetrin.

Detyrë shtëpie:

Plotësimi i minifjalorit me fjalë dhe shprehje të tjera në fusha të ndryshme.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Rubrika: Të shkruarit		Orë mësimore: 2 orë Tema mësimore: Shkruajmë ese argumentuese	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none">• Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit• Kompetenca e të menduarit• Kompetenca e të nxënit• Kompetenca personale• Kompetenca qytetare• Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të shkruarit;- përdor strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin e tij/saj;- vlerëson cilësinë e informacionit që gjen;- reflekton ndaj shkrimit duke përcaktuar elementet për përmirësim;- përshtat shkrimin me qëllimet dhe lexuesit nëpërmjet argumentimit;- përzgjedh dhe organizon fakte, ide, opinione, jep shembuj dhe të dhëna për të realizuar një produkt shkrimi cilësor.		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none">- ese argumentuese; planifikim; hartim; rishikim. Situata e të nxënit: <ul style="list-style-type: none">- Mbani një qëndrim dhe jepni 2 argumente mbështetëse rreth tij.	

<p>Burimet:</p> <p>- ese të ndryshme model, materiale burimore informative, teksti i nxënësit, fletore të punëve me shkrim.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>- TIK; Qytetari.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p><i>Demonstrim, Stuhi mendimesh, Leksion i përqendruar, Punë e pavarur me shkrim.</i></p>	
<p style="text-align: center;">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p>Pjesa e parë e orës (45 minuta)</p> <p>Veprimtari paraprake: <i>Demonstrim, Stuhi mendimesh</i></p> <p>Lexohen fragmente nga ese argumentuese të suksesshme.</p> <p>Argumentoni se si ambienti që na rrethon i jep kuptim jetës sonë.</p> <p>Është një argument i njohur tashmë nga të gjithë ndikimi i pamohueshëm i ambientit, rrethanave në të cilat rritemi në jetën tonë: tiparet psikologjike dhe ato morale. Njeriu është produkt i shoqërisë në të cilën rritet dhe edukohet, ai është pasqyrë e pastër e asaj çfarë është reflektuar në të. Nëse reflektimi ka qenë negativ, individ i mbart pikërisht këto tipare, të gjitha nën emëruesin e së keqes. Në të kundërt, para nesh do të kemi fatin të kemi një individ të suksesshëm, me të gjitha tiparet e së mirës dhe pozitives.</p> <p>Argumentin e parë dëshiroj ta sjell nga letërsia, e pikërisht nga “I huaji” i Kamysë. Në këtë kryevepër kaq të njohur theksohet qartë se është jeta absurde ajo që e vret te njeriu çdo gjë njerëzore. Pra, qenia njerëzore pëson metamorfozën e saj në përballje me shoqërinë e ashpër, rregullat e ngurta të saj. Si pasojë individ ndihet i vetmuar në një botë indiferente.</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Leksion i përqendruar</i></p> <p>Eseja argumentuese ka për synim të mbështetë me arsye të vlefshme (argumente), idenë (tezën) tuaj. Në ese duhen marrë në konsideratë idetë e përkundërta (antiteza) dhe këto ide duhen hedhur poshtë përmes argumenteve. Në fund, duhet bërë përmbyllja (përfundimi) e shkrimit duke ripohuar tezën fillestare.</p> <p>Etapat e hartimit të esesë argumentuese</p> <p style="text-align: center;">↓</p> <p>Planifikimi i esesë argumentuese.</p> <p style="text-align: center;">↓</p> <p>Hartimi i esesë argumentuese.</p> <p style="text-align: center;">↓</p> <p>Rishikimi i esesë argumentuese.</p> <p style="text-align: center;">↓</p> <p>Leximi i parë: kontroll i përmbajtjes.</p> <p>Leximi i dytë: kontroll i formës.</p> <p>Punë e pavarur: <i>Lexohet eseja argumentuese model:</i></p> <p>Rëndësia e shkollës së mesme</p> <p>Hyrja</p> <p>Kur je në shkolle të mesme, është mjaftueshëm e vështirë të bësh plane për javën e ardhshme, jo më për 10, 15 apo 25 vitet e ardhshme.</p> <p>Teza</p> <p>Në vend që vendimi t’u lihet në dorë adoleshentëve jolargpamës, duhet të vendoset një ligj që të detyroje të gjithë nxënësit në mbarë botën të kryejnë shkollën e mesme.</p> <p>Argument logjik mbështetës:</p> <p>Së pari, një diplomë gjimnazi duhet të jetë normë në çdo shtet.</p> <p>Së dyti, arsimi i mesëm i jep njeriut njohuritë dhe teknikat bazë për të gjetur një punë në të ardhmen, prandaj duhet të jetë i detyrueshëm.</p>	

Së treti, një arsim i mesëm duhet të jetë i detyrueshëm për të gjithë dhe për një arsye tjetër të rëndësishme: gjithë qëllimi i arsimit është të krijojë bazat intelektuale që duhen për të qenë i vetarsimuar.

Mbyllja

Për ta përfunduar, duhet të ketë një ligj që e bën të detyrueshëm arsimin e mesëm për të gjithë nxënësit, sipas të cilit të penalizohet ai që nuk e mbaron shkollën e mesme dhe nuk diplomohet.

Shënim: Orën e dytë të mësimit nxënësit punojnë me shkrim esenë argumentuese, duke zgjedhur njërën prej temave:

1. Disa njerëz mendojnë se fjalët janë parëndësishme, ato i merr era, ndërsa veprat mbeten. Disa të tjerë mendojnë se fjalët mund të jenë të thjeshta, por e kanë fuqinë të madhe. Me cilin këndvështrim jeni dakord? Argumentoni mendimin tuaj.

2. Ka njerëz që mendojnë se ne duhet të përqendrohemi në të tashmen dhe të ardhmen dhe se kemi pak për të mësuar nga e shkuara. Disa të tjerë mendojnë se e shkuara është shumë e rëndësishme për të tashmen e njeriut. Me cilin këndvështrim jeni dakord? Argumentoni mendimin tuaj.

3. Sa pajtoheni me thënien e mëposhtme?

“Nëse mendon se je i aftë për të arritur gjëra të mëdha, ke për t’i arritur ato.”

Argumentoni rastin tuaj qartësisht.

Vlerësimi:

Nxënësit/et do të vlerësohen për:

- shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit;
- demonstrimin e imagjinatës dhe shpirtit krijues gjatë të shkruarit;
- respektimin e gjuhës standarde dhe shmangien e fjalëve të huaja gjatë të shkruarit (kur e kanë fjalën gjegjëse në gjuhën shqipe);
- vlerësimin e punëve të të tjerëve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen detyrës me shkrim.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Drejtshkrim Ora I Tema mësimore: Analize teksti informues-paraqitës (Procesverbali) Ora II Tema mësimore: Rregulla për shkrimin e bibliografisë		Situata e të nxënit: - Lexohen fragmente procesverbalesh të ndryshme dhe diskutohet rreth strukturës së tyre.	

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore 1: Nxënësi/ja: - përcakton qëllimin e tekstit të lexuar; - dallon karakteristikat strukturore të tekstit informues-paraqitës të lexuar; - analizon strukturën e tekstit informues-paraqitës të lexuar; - analizon strukturën e procesverbalit; - shkruan një procesverbal duke përmbushur kriteret përkatëse.	Fjalët kyçe: - bibliografi; autor; burim; rend alfabetik.
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore II Nxënësi/ja: - u përmbahet rregullave të përcaktuara në shkrimin e bibliografisë; - përdor drejt shenjat e pikësimit dhe shkronjën e madhe në shkrimin e bibliografisë.	
Burimet: - teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë, Fjalori i gjuhës Shqipe, FESH, video-projektor.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - TIK.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Stuhi mendimi, Pemë mendimi, Diagram Veni, Punë e pavarur/në grup</i>	
ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT Pjesa e parë e orës (45 minuta) Veprimtari paraprake: <i>Stuhi mendimesh</i> Ç`janë tekstet informuese dhe si përcillen ato tek lexuesi?	
Kujtojmë Tekstet informuese-paraqitëse mund të përcillen përmes të folurit ose përmes gjuhës së shkruar . <i>Leksionet, lajmet, njoftimet, intervistat</i> që jepen me gojë përbëjnë tekste informuese-paraqitëse. Ndërsa tekste informuese-paraqitëse që paraqiten me shkrim janë: <i>memot, broshurat, fletëpalosjet, CV-të, vërtetimet, kërkesat, raportet vjetore, procesverbalet, relacionet, letrat zyrtare, njoftimet, ftesat, shpalljet, recensionet</i> etj.	
Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Leksion i përqendruar, Pyetja sjell pyetjen</i> Tekstet informuese-paraqitëse janë tekste që paraqesin informacione dhe të dhëna për një çështje të caktuar, me qëllim informimin e mëtejshëm të audiencës rreth çështjes në fjalë. Tekstet informuese-paraqitëse nuk kanë synim të rrëfejnë a të japin udhëzime, por karakterizohen nga shpjegime të qarta dhe të kuptueshme për lexuesin.	

Lexohet fragmenti: Procesverbale të Mbledhjeve të Komissisë Letrare Shqipe në Shkodër
Nxënësit formulojnë dhe i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit rreth materialit të lexuar.

Punë e pavarur në grupe

Grupi i parë: Nxënësit tregojnë si është strukturuar secili nga procesverbalet e mësipërme.

- Tema e procesverbalit
- Pjesëmarrësit
- Çështjet e diskutuara
- Konkluzionet

Grupi i dytë: Çfarë çështjesh janë trajtuar në këto procesverbale të Komissisë Letrare të Shkodrës?

Rrahjet e mendimeve për ngulitjen e normës së shqipes së shkruar.

Grupi i tretë: Rishkruan dy prej procesverbaleve, duke i kthyer ato në shqipen e sotme standarde.

P.sh.:

8 Maj 1917

Gurakuqi, Peci, Logoreci, Mosi, Paluca e Naraci. Morën pjesë edhe Z. Z. Fejzi Beu (Alizoti), Avni Dabulla, Dom Pjetër Gjura, Vejsel eff. Mungon Z. Seiner.

Urdhri i ditës: Trajtimi i emrave të familjeve shqiptare “E.V.N.1700 më 30 Prill 1917”.

Mbasi u shqyrtua çështja e trajtimit të emrave të familjeve u dhanë këto dy vendime:

1. Përgjithësisht shqiptarët kanë emra familjesh të rrjedhur ose prej ndonjë titulli, ose prej katundit a qytetit nga ka ardhur familja, ose prej mjeshtërisë, ose prej emrit të veçantë të ndonjërit prej të parëve të familjes.

Pjesa e dytë e orës (45 minuta)

Veprimtari paraprake: Stuhi mendimi

Mësuesi/ja me teknikën “Stuhi mendimi” u kërkon nxënësve të shprehin çfarë dinë për bibliografinë.

Bibliografia

Ndërtimi i njohurive të reja: Diskutim

Mësuesi/ja paraqet me video-projektor ose në një tablo shembuj bibliografish duke përcaktuar nga shembulli rregulla standarde për hartimin e bibliografisë.

Rregullat e drejtshkrimit	Shembuj
Në krye jepet mbiemri i autorit, pas tij vihet presje, e cila ndiqet nga shkronja e parë e emrit të tij, e menjëherë pas saj vihet pikë. Pastaj, në kllapa jepet viti i botimit. Pas kllapave vihet pikë dhe vijon titulli i librit ose i shkrimit me shkronja kursive, kurse në fund vihet pikë. Pas kësaj shkruhet vendi i botimit, vihen dy pika dhe shkruhet emri i shtëpisë botuese.	Elsie, R. (2001). A Dictionary of Albanian Religion, Mythology and Folk Culture. New York: Neë York University Press.
	Rrota, J. (1936): Për historin e alfabetit shqyp. Shkodër: Botime Françeskane.

	Altimari, F. (2012). Mbi huazimet nga italishtja dhe nga dialektet italo-romane në sistemin foljor të arbërishtes së Kalabrisë. Në: Res Albanicae, Rivista di albanologia I, nr. 1. Palermo: Fondazione Universitar "Francesco Solano", 7-23.
	Altimari, F., L.M. Savoia (1994). I dialetti italo-albanesi. Roma: Bulzoni.
	Instituti i Statistikave (2010). Vjetari Statistikor. Tiranë: Shtëpia Botuese X.
	https://www.mitpressjournals.org/loi/ling

Të mbajmë mend!

✚ Bibliografia shkruhet sipas renditjes alfabetike të mbiemrave të autorëve të caktuar, duke ruajtur trajtën origjinale të emrit, ose transkriptimin në alfabetin latin, për autorët e huaj, si dhe titullin në gjuhë të huaj.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: "Punë e pavarur dhe në grup"

Së bashku me nxënësit diskutohet ushtrimi 2, f. 153.

- Nxënësit/et rishkruajnë të dhënat e mëposhtme sipas rregullave për shkrimin e bibliografisë.

Kolë Ashta, Toena, Leksiku historik i gjuhës shqipe I, Tiranë, 1996.

Çabej. Eqrem, Tiranë 2002, Studime etimologjike në fushë të shqipes III, Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Vepra të zgjedhura, Selman Riza, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2009, Tiranë.

Martin Camaj, La parlata albanese di Greci in Provincia di Avellino, 1971, Firenze, Olschki.

Sistemi foljor i gjuhës shqipe, 2010 Kolec Topalli, Plejad, Tiranë.

Ignazio Zamputti, Anonyms of Elbasan (Dorëshkrimi i Anonimit t'Elbasanit), 1951, në, 3-4, Buletin i Institutit të Shkencave, 64-131, Tiranë.

Pjetër Budi, Dottrina Christiana, 1618, Bartolomeo Zanneti, Romë.

Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore, Justin Rrota, 2006, Shkodër, Botime Françeskane.

Vlerësimi:

Nxënësit/et do të vlerësohen për:

- leximin e rrjedhshëm të tekstit për të kuptuar informacionin e tij;
- ndarjen e përvojave të tij të leximit me të tjerët;
- respektimin dhe pranimin e mendimit të të tjerëve gjatë dhënies së përgjigjeve;
- respektimin e etikës gjatë komunikimit personal dhe në grup;
- vlerësimin e kontributit të të tjerëve gjatë kryerjes së ushtrimeve;
- respektimin rregullave të përcaktuara në shkrimin e bibliografisë;

- përdorimin e drejtë të shenjave të pikësimit dhe shkronjën e madhe në shkrimin e bibliografisë.

Detyra shtëpie:

- Gjeni të dhëna (internet ose në literaturë të botuar) dhe shkruani një tekst informues-paraqitës për rëndësinë dhe veprimtarinë e Komisionit Letrar të Shkodrës. Mund të shfrytëzoni edhe materialin plotësues në fund të librit.

– Përzgjidhni një shkrim studimor mbi gjuhësinë dhe vëreni me kujdes në janë zbatuar këto rregulla: (Usht. 3, fq. 153.)

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Rubrika: Të folurit Tema mësimore: Përdorimi dhe përparësitë e mjeteve pamore gjatë një prezantimi		Situata e të nxënit: - Sa rol mendoni se luan përdorimi i mjeteve pamore gjatë një prezantimi?	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none">• Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit• Kompetenca e të menduarit• Kompetenca e të nxënit• Kompetenca personale• Kompetenca qytetare• Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">- paraqet alternativën personale mbi çështjen ose tekstin e caktuar;- vlerëson përfundimet e një diskutimi;- merr nismën të ndryshojë rrjedhën e një diskutimi;- përdor përmbajtje të përshtatshme për qëllime, audienca, situata dhe kontekste të caktuara;- parashtron argumentin përmes një përmbajtjeje të ngjeshur, duke respektuar faktorin <i>kohë</i>;- merr parasysh rolin e dëgjuesit, të qëllimit, të situatës dhe të kontekstit në një diskutim;- shfrytëzon pasurinë leksikore e semantike për të shprehur saktë mendimet e tij në diskutime në grupe të vogla e të mëdha.		Fjalët kyçe: - mjete pamore; grafikë; tabela; shifra; figura.	
Burimet: <ul style="list-style-type: none">- teksti i nxënësit, pamje, fotografi me mjete pamore, materiale informuese, tabela ndërvepruese, video-projektor etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - TIK; Qytetari.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:

Lexim i grafikëve dhe tabelave, Harta semantike, Punë e pavarur në grupe.



ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT

Pjesa e parë e orës (45 minuta)

Veprimtari paraprake: Lexim i grafikëve dhe tabelave

Paraqiten disa grafikë, tabela dhe fotografi.

Kërkohet nga nxënësit/et që t'i komentojnë.

Ndërtimi i njohurive të reja: Harta semantike

Përdorimi i mjeteve pamore:

1. Ndhmon prezantimin.
2. Përforon mesazhin
3. Sqaron dhe krijon emocion.
4. Shton interesin e audiencës për prezantimin e materialit.

- Cilat janë mjetet pamore?

Fotografitë, grafikët, tabelat, videot, modelet slajdet (slides) etj.

1. Tabelat përbëjnë mënyrën më efektive për paraqitjen e të dhënave. Ato krijohen lehtësisht duke përdorur programe të tilla, si: *Excel*-i.

2. Shifrat mund të paraqiten në shumë forma, të tilla si: *grafikët, diagramet, vizatimet, hartat* etj.

3. Figurat dhe fotografitë bëjnë që konceptet ose idetë të mos jenë thjesht fjalë, por të jenë fjalë plus imazhe.

4. Grafikët dhe diagramet sjellin në mënyrë të qartë shifrat dhe të dhënat e një teksti duke bërë edhe krahasime.

5. Slajdet rrisin besueshmërinë e prezantimit nëpërmjet imazheve, të dhënave që përmbajnë.

Punë e pavarur në grupe

Grupi i parë: Ushtrimi 1, faqe 156

Nxënësit/et përgatisin një tabelë për të prezantuar rezultatet e një testimi të bërë në lëndën e gjuhës. Ata e komentojnë atë dhe diskutojnë rreth lehtësisë që krijon në paraqitjen e të dhënave.

Pikët e klasës XII në testimin e gjuhës

<i>Pyetje/pikët</i>	<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	<i>6</i>
<i>Nxënësi 1</i>	<i>3 pikë</i>	<i>2 pikë</i>	<i>4 pikë</i>	<i>3 pikë</i>	<i>2 pikë</i>	<i>8 pikë</i>

Në këtë mënyrë bëhet lehtësisht e mundur p.sh., të verifikohet se sa nxënës/e e kanë punuar ushtrimin 1 (vërehen rezultatet në mënyrë vertikale).

Grupi i dytë: Ushtrimi 3, faqe 156

Lexohet teksti: “Pusi” dhe ndërtohet një grafik, në të cilin paraqitet në përqindje denduria e përdorimit të zanoreve (sa herë është përdorur secila prej tyre). Diskutohet rreth tij.

Grupi i tretë: Ushtrimi 3, faqe 156

Paraqitet në përqindje denduria e përdorimit të bashkëtingëlloreve të gjuhës shqipe në tekstin e ushtrimit 3 (sa herë është përdorur secila prej tyre). Diskutohet rreth mënyrës se si do t'i paraqiten këto të dhëna.

Punohet me grafikët në programin *excel*.

Vlerësimi:

Nxënësit/et do të vlerësohen për:

- komunikimin në përputhje me normat shoqërore dhe me vlerat kulturore në situata të ndryshme;
- ndërmarrjen e nismave dhe të shprehjes së interesimit për çështje të ndryshme;
- përdorimin e imagjinatës dhe shpirtit krijues për zgjidhjen e problemeve;
- demonstrimin e vullnetit dhe të gatishmërisë në detyrat individuale dhe në punët në grup.

TESTOJMË NJOHURITË GRAMATIKORE

Tremujori II

❖ Qarkoni alternativën e shkruar saktë.

- | | |
|-----------------------------------|-----------------------------------|
| a. orari i së hënës | b. orari i të hënës |
| a. vajzës së të motrës | b. vajzës të së motrës |
| a. kujdesi i së bijës | b. kujdesi i të bijës |
| a. i tha së motrës | b. i tha të motrës |
| a. gjyshes së tij të mirë | b. gjyshes të tij së mirë |
| a. në hyrje së sallës së leximit | b. në hyrje të sallës së leximit |
| a. pas lutjes së të bijës | b. pas lutjes të së bijës |
| a. sjelljes së saj, të hijshme | b. sjelljes së saj, së hijshme |
| a. portreti i së panjohurës | b. portreti i të panjohurës |
| a. muret e një ndërtese të vjetër | b. muret e një ndërtese së vjetër |

❖ Qarkoni përgjigjen e saktë me Po/Jo.

- | | | |
|--|----|----|
| 1. Pjesët e fjalisë përcaktore lidhen me lidhëza fthilluese. | Po | Jo |
| 2. Përemri lidhor <i>i cili/ e cila</i> përshtatet në rasë me paraprijësin. | Po | Jo |
| 3. Në një fjali të përbërë mund të ketë pjesë të varura rrethanore dhe fthilluese. | Po | Jo |
| 4. Pjesa e varur e fiton rolin e saj në varësi të marrëdhënies që vendos me pjesën drejtuese. | Po | Jo |
| 5. Pjesët e varura rrethanore emërtohen në varësi të rrethanës që shprehin. | Po | Jo |
| 6. Pjesët e varura rrethanore, nuk kanë rend të lirë. | Po | Jo |
| 7. Citimet në tekst kanë të dhëna të mjaftueshme rreth burimit të veprës së cituar. | Po | Jo |
| 8. Në bibliografi jepen të dhënat e domosdoshme rreth burimit të një vepre dhe autorit të saj. | Po | Jo |
| 9. Në bibliografi, ndiqet kronologjia e vitit të botimit. | Po | Jo |
| 10. Në bibliografi emrat e autorëve të huaj i shkruajmë siç i shqiptojmë. | Po | Jo |
| 11. Kur vepra ka më shumë se një autor, mjafton të shkruajmë emrin e njërit prej tyre. | Po | Jo |

- | | | |
|---|----|----|
| 12. Burimet nga interneti nuk janë të besueshme. | Po | Jo |
| 13. Në bibliografi mund të shtojmë autorë të tjerë, veç atyre të cituar në tekst. | Po | Jo |
| 14. Titujt e veprave në gjuhë të huaj i sjellim vetëm të përkthyer në shqip. | Po | Jo |
| 15. Çdo autor i cituar në tekst, duhet të pasqyrohet me të dhënat e kërkuara në bibliografi. | Po | Jo |
| 16. Leksiku i sotëm i shqipes përmban fjalë shumë të vjetra të trungut të saj. | Po | Jo |
| 17. Termi <i>fjalë të vjetra</i> nuk ka të njëjtin kuptim me termin <i>fjalë të vjetruara</i> . | Po | Jo |
| 18. Fjalët e vjetruara kanë humbur përdorimin aktiv, përdoren për shkaqe historike dhe stilistike. | Po | Jo |
| 19. Fjalët e vjetra janë pjesë e leksikut të hershëm të shqipes që ende përdoren dhe janë aktive. | Po | Jo |
| 20. Leksikun e sotëm të shqipes mund ta grupojmë në: arkaizma; shtresë e fjalëve të reja (neologjizma); fjalë të fushave profesionale (terminologji); fjalë dialektore dhe krahinore. | Po | Jo |
| 21. Nyjat shkruhen të ndara nga fjalët. | Po | Jo |
| 22. Nyjat nuk i shërbejnë fjalës. | Po | Jo |
| 23. Trajta e nyjës ndryshon në varësi të emrit që prin dhe të atij që ndjek. | Po | Jo |
| 24. Trajta e nyjës ndryshon në varësi të emrit që prin dhe jo të atij që ndjek. | Po | Jo |
| 25. Ligjërimi i thjeshtë i përmbahet normës së gjuhës standarde. | Po | Jo |
| 26. Në ligjërimin libror, norma gjuhësore ruhet më shumë se në ligjërimet e tjera. | Po | Jo |
| 27. Në ligjërimin bisedor, norma gjuhësore ruhet më shumë se në ligjërimet e tjera. | Po | Jo |
| 28. Në ligjërimin bisedor, nuk përdoren krahinorizmat, as fjalët e zhargoneve. | Po | Jo |
| 29. Në ligjërimin e thjeshtë, nuk përdoren krahinorizmat, as fjalët e zhargoneve. | Po | Jo |
| 30. Pjesët e nënrenditura luajnë në fjalinë e përbërë të njëjtin rol si edhe grupet e fjalëve brenda fjalisë së thjeshtë. | Po | Jo |

❖ **Plotësoni.**

1. Ligjërimet e gjuhës shqipe në të dyja variantet e saj (të shkruar dhe të folur) janë:

2. Ligjërimi _____ karakterizohet nga fjalë të zgjedhura, norma gjuhësore ruhet më shumë se në ligjërimet e tjera.
3. Ligjërimi _____ është variant i gjuhës standard në biseda të lira.
4. Ligjërimi _____ është ligjërim i përditshëm i njerëzve të profesioneve e krahinave të ndryshme, që nuk i përmbahen normës së gjuhës standarde.
5. Përemri lidhur ‘i cili/e cila’ është një fjalë _____, e cila ndryshe nga përemri lidhur ‘që’, përshtatet në gjini dhe në numër me _____.
6. Stilet i dallojmë nga njëri-tjetri, së pari nga _____; së dyti, _____.
7. Shtoj nga një fjali përcaktore fjalive të mëposhtme.
 - a. Më pëlqen shumë arti _____.
 - b. E pashë projektin _____.
8. Shtoj nga një fjali rrethanore fjalive të mëposhtme.
 - a. Varka shkante _____.
 - b. Mësuesi punoi pa ndërprerje _____.
9. Shtoj nga një fjali filluese fjalive të mëposhtme.
 - a. Nuk dihet se _____.
 - b. Pas shfaqjes, fëmijët tregonin _____.
10. Plotëso me disa tipare të gjuhës së:
 - a. letërsisë artistike

 - b. stilit politiko-shoqëror

 - c. stilit shkencor-teknik

 - b. stilit juridiko-administrativ

2. Pjesa e nënrenditur në fjalinë: “Këta qenë të vetmit njerëz të mirë që iu gjendën pranë ato ditë të vështira.”, është:
 - a. përcaktore;
 - b. filluese;
 - c. qëllimore.
3. Pjesa e nënrenditur në fjalinë: “Pritëm me muaj që të na pranohej kërkesa.”, është:
 - a. përcaktore;
 - b. filluese;
 - c. qëllimore.
4. Pjesa e nënrenditur në fjalinë: “Drita që vinte nga jashtë ishte shumë e fortë”, është:
 - a. përcaktore;
 - b. filluese;
 - c. qëllimore.
5. Pjesa e nënrenditur në fjalinë: “Prindërit punonin shumë që fëmijët të ishin të lumtur.”, është:
 - a. përcaktore;
 - b. qëllimore.
6. Pjesa e nënrenditur në fjalinë: “Nuk dihet se kur do të fillojmë punën.”, është:
 - a. përcaktore;
 - b. filluese.
7. Pjesa e nënrenditur në fjalinë: “Që kur jam në këtë qytet, ndihem mirë.”, është:
 - a. përcaktore;
 - b. filluese;
 - c. rrethanore.
8. Pjesa e nënrenditur në fjalinë: “Pas punës, kur po pushonte, i erdhi një surprizë.”, është:
 - a. përcaktore;
 - b. rrethanore.
9. Pjesa e nënrenditur në fjalinë: “Dihet se toka rrotullohet rreth diellit.”, është:
 - a. përcaktore;
 - b. filluese.
10. Pjesa e nënrenditur në fjalinë: “Nuk i dua njerëzit, që flasin shumë.”, është:
 - a. përcaktore;
 - b. filluese;
 - c. qëllimore.

Qarkoni përgjigjen e saktë

1. Pjesa e nënrenditur në fjalinë: “Drita që vinte nga jashtë ishte e fortë.”, është:
 - a. përcaktore;
 - b. filluese;
 - c. qëllimore.

PLANIFIKIMI ORËS MËSIMORE 1, 2

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Sintaksë, Të shkruajmë Ora I Tema mësimore: - Fjalitë e ndërmjetme Ora II Tema mësimore: - Shkrimi i letrës së motivimit		Situata e të nxënit: Fjalitë e ndërmjetme - Cilat informacione mendoni se janë kyçe për t`u përfshirë në një letër motivimi? Pse?	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore I: Nxënësi/ja: - analizon fjalitë e ndërmjetme; - përcakton tiparet e përbashkëta dhe tiparet e veçanta mes fjalive të ndërmjetme dhe fjalëve ose togjeve të fjalëve; - ndërton fjali të ndërmjetme në mes, në krye dhe në fund të fjalisë, si dhe përdor drejt presjen. Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore II: Nxënësi/ja: - realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të shkruarit të letrës së motivimit; - përdor strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin e tij; - vlerëson cilësinë e informacionit që gjen; - reflekton ndaj shkrimit duke përcaktuar elementet për përmirësim; - përshtat shkrimin me qëllimet dhe lexuesit nëpërmjet argumentimit; - përzgjedh dhe organizon fakte, ide, opinione, jep shembuj dhe të dhëna për të realizuar një produkt shkrimi cilësor.		Fjalët kyçe: - fjali të ndërmjetme; fjalë; togje fjalësh; presje.	
Burimet: - teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë, video-projektor, letra të ndryshme motivuese, tabela ndërvepruese, Gramatika e gjuhës shqipe II etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - TIK; Qytetari.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:			

Stuhi mendimi, Pemë mendimi, Diskutim, Punë e pavarur/ në grup, Diskutim paraprak i njohurive, Leksion i përqendruar, Punë e pavarur me shkrim.

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT

Pjesa e parë e orës (45 minuta)


Veprimtari paraprake

U paraqiten nxënësve dy fjali:

Njeriu që s'punon, dheut i rëndon.


Njeriu, që t'i biem shkurt, duhet të punojë.

Mësuesi analizon fjalitë dhe me teknikën *Stuhi mendimi* shpjegon tipare të fjalive të ndërmjetme.



Ndërtimi i njohurive të reja: Pemë mendimi

Mësuesi përmes teknikës *Pemë mendimi* shpjegon llojet dhe tipat e fjalive të ndërmjetme.



Nxënësit shkruajnë diagramet në skedë ose në bllokun e gramatikës.

Diskutim mbi disa pohime: të sakta/ të gabuara.

Të gjitha fjalitë që futen ndërmjet një fjalie tjetër, quhen fjali të ndërmjetme.
 Fjalitë e ndërmjetme prihen gjithnjë nga lidhëzat.
 Fjalitë e ndërmjetme nuk hyjnë në lidhje gramatikore me fjalinë në të cilën shfaqen.
 Fjalitë e ndërmjetme mund të përdoren në fjali të thjeshta dhe të përbëra.
 Fjalitë e ndërmjetme mund të qëndrojnë vetëm në mes të fjalive të tjera.

Të mbajmë mend!

- ❖ Fjali e ndërmjetme është fjalia e përfshirë në një fjali tjetër të thjeshtë a të përbërë, por pa qenë organikisht e lidhur me të. Më shpesh përdoren në mes të fjalisë, më pak në krye e në fund të saj.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Mësuesi/ja paraqet (me video-projektor) një tabelë me fjali të ndërmjetme dhe tiparet e tyre dhe u kërkon nxënësve të dallojnë *tipin e fjalisë* sipas shembullit.

Fjali të ndërmjetme	Tipare të përgjithshme	Shembuj
Të shkallës së vërtetësisë së një fakti.	Tregojnë deri në ç'masë është i vërtetë fakti i kumtuar, i cili mund të paraqitet si i dyshimtë, i pasigurt, i natyrshëm etj.	<i>Kjo punë, si të them, nuk është nisur mbarë.</i>
	Tregojnë urim, dëshirë, lutje, zemërim. Zakonisht janë fjali dëshirore.	<i>Ju pastë nëna, sa të mirë që jeni.</i>
	Tregojnë burimin e kumtimit: në është kumtimi i një personi të njohur apo i vetë folësit. Është tipi më i zakonshëm i fjalive të ndërmjetme.	<i>Shikoji punën, jo gunën, thotë një fjalë e urtë e popullit.</i>
	Japin një saktësim lidhur me karakterin e thënies; tregojnë qëndrimin e folësit ndaj mënyrës së formulimit a të shprehjes, ndaj zgjedhjes së një fjale të përdorur etj.	<i>Të them të drejtën, unë e mendoj ndryshe.</i>
	Shprehin thirrje drejtuar bashkëbiseduesit me qëllim që të tërheqin vëmendjen e tij, me qëllim që ky të reagojë.	<i>Ju lutem, të mos e zgjasim më shumë.</i>
	Tregojnë lidhje logjike të mendimeve të shprehura. Shërbejnë për kundërvënien e krahasimin e kumtimeve sipas rëndësisë së tyre.	<i>Siç u theksua më lart, puna në arkiva është parësore për një historian.</i>

Punë në grup

Nxënësit/et në grupe dyshe dallojnë fjalitë e ndërmjetme: *Usht. 2, fq.159.*

E vërteta është se ky njeri nuk ka faj.
 Të them të drejtën, ky njeri nuk ka faj.
 Siç erdhën këto punë, asgjë nuk është më e sigurt.
 Se si qëndron puna, këtë nuk e di.
 Unë them të mos e zgjasim më shumë.
 Unë, që të mos e zgjasim më shumë, ç'kisha për të thënë, e thashë.
 Siç thotë një fjalë e urtë, më mirë një vezë sot, se një pulë mot.
 Po të sillemi, siç këshillojnë fjalët e urta, ndoshta do të jetonim më mirë.

Në mënyrë të pavarur nxënësit punojnë ushtrimet 3 dhe 4 në faqen 159 të librit.

Për mësuesit material ndihmës për këtë temë mësimore.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe II*, Tiranë, 1997, f. 640.

Fjalitë e ndërmjetme – fjalët, togjet e fjalëve

Fjalitë e ndërmjetme dhe fjalët e togjet e ndërmjetme krahas tipareve të përbashkëta, kanë edhe dallime mes tyre.

Ndryshe nga fjalët e togjet, fjalitë e ndërmjetme janë njësi sintaksore, që kanë vlerë të plotë kallëzuesore.

Fjalitë e ndërmjetme pikërisht se janë fjali, kanë mundësi më të mëdha për të shprehur më mirë marrëdhëniet e folësit me kumtimin. Ato kanë një përmbajtje më të pasur, një kuptim më të plotë. Si fjalitë e tjera, ato mund të gjymtyrëzohen në mënyra të ndryshme.

Pjesa e dytë e orës (45 minuta)

Veprimtari paraprake: Diskutim paraprak i njohurive

– **Ç’është letra e motivimit?**

Një nga **llojet e teksteve informuese-paraqitëse** është letra e motivimit, në të cilën dërguesi paraqet motivet dhe interesin e tij për t’u pranuar në një punë apo për të vijuar studimet në një universitet.

Ndërtimi i njohurive të reja: Leksion i përqendruar

Etapat e hartimit të letrës së motivimit

Planifikimi i shkrimit të letrës së motivimit



Shkrimi i letrës së motivimit



Strukturimi i letrës së motivimit

Punë e pavarur me shkrim

Udhëzohen nxënësit të jenë të kujdesshëm me elementet e letrës së motivimit: dërguesin, marrësin, hyrjen e saj.

Letër motivimi për bursë studimi

Fllad Agolli

Rruga “Myslym Shyri”,

Pall. 146, Shk. 2, Ap. 10,

Tiranë, Shqipëri

Tel: + 355 4 224 0222

e-mail: flladagolli@yahoo.com

Znj. Amantia Cela

Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Arsimit

Rruga “Margarita Tutulani”

Tiranë/Shqipëri

Tiranë, më 07.02.2018

Hyrja

E nderuar znj. Çela,

Para pak kohësh mësova që organizata juaj po ofron një numër të kufizuar bursash akademike për maturantët vendas që synojnë të shkojnë në universitet. Si pasojë, po ju shkruaj këtë letër për t’ju shprehur vlerësimin për bujarinë tuaj dhe për t’ju paraqitur kandidaturën time për një nga këto bursa.

Zhvillim

Aktualisht unë jam në vitin _____
 Mendoj se ndërthurja e këtyre dy prirjeve të mia _____
 Ju siguroj që mbështetja juaj _____

Mbyllja

Duke ju falënderuar paraprakisht për vëmendjen tuaj,
 Mbetem në pritje të një përgjigjeje të afërt,
 Me respekt,
 Fllad Agolli

Vlerësimi:

Nxënësit/et do të vlerësohen për:

- dallimin e fjalive të ndërmjetme;
- ndërtimin e fjalive të ndërmjetme në mes, në krye dhe në fund të fjalisë.

Nxënësit/et do të vlerësohen për:

- shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të shkruarit të letrës së motivimit;
- demonstrimin e imagjinatës dhe shpirtit krijues gjatë shkruarit;
- respektimin e gjuhës standarde dhe shmangien e fjalëve të huaja gjatë shkruarit (kur e kanë fjalën gjegjëse në gjuhën shqipe);
- vlerësimin e punëve të tjerëve;
- bashkëpunimin në grup në kryerjen detyrës me shkrim.

Detyrë shtëpie:


– Zgjidhni një tekst nga proza popullore dhe vëreni përdorimin e fjalive të ndërmjetme. Përcaktoni llojin e tyre. (Usht.5, f.159.)

PLANIFIKIMI ORËS MËSIMORE 3, 4

Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Sintaksë, Drejtshkrim Ora I Tema mësimore: Fjalitë e ndërkallura Ora II Tema mësimore: Përdorimi i shenjave të pikësimit te fjalitë e ndërmjetme dhe te fjalitë e ndërkallura		Situata e të nxënit: - Rregulla drejtshkimore	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit			

<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Ora I</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcakton tiparet e fjalive të ndërkallura; - analizon fjalitë e ndërkallura; - ndërton fjalitë të ndërkallura; - krahason fjalitë e ndërkallura me fjalitë e ndërmjetme; - përdor drejt shenjat e pikësimit në fjalitë e ndërkallura; - përcakton ligjërimet dhe stilet kur përdoren fjalitë e ndërkallura. <p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Ora II</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor drejt presjen të fjalitë e ndërmjetme dhe shenjat e pikësimit në fjalitë e ndërkallura. 	<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - fjali të ndërkallura; fjali të ndërmjetme; shenja pikësimi; presje; ligjërim; stil.
<p>Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë, video-projektor. 	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Letërsi; TIK.
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p><i>Stuhi mendimi, Pemë mendimi, Diagrame Veni, Diskutim, Punë e pavarur/ Punë në grup.</i></p>	
<p style="text-align: center;">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p><i>Pjesa e parë e orës (45 minuta)</i></p> <p><i>Veprimtari paraprake</i></p> <p>Diskutohet me nxënësit përmes teknikës <i>Stuhi mendimi</i> mbi njohuritë e tyre të mëparshme mbi <i>Fjalitë e ndërmjetme</i>.</p> <div data-bbox="311 1601 949 1870" style="text-align: center;"> <pre> graph TD A[Fjalitë e ndërmjetme] --> B[Tipa fjalish të ndërmjetme] C[Llojet] --- B </pre> </div> <p>Diskutim i detyrave të shtëpisë, përdorimi i fjalive të ndërmjetme, lloji i tyre në tekste nga proza popullore.</p> <p><i>Ndërtimi i njohurive të reja: Pemë mendimi</i></p>	

Mësuesi/ja përmes teknikës *Pemë mendimi* shpjegon fjalitë e ndërkallura, llojet dhe të dhënat plotësuese të fjalive të ndërkallura.



Nxënësit/ety shkruajnë diagramet në skedë ose në bllokun e gramatikës.

Diskutim mbi disa pohime: të sakta/ të gabuara.

Si fjalitë e ndërmjetme, ashtu dhe ato të ndërkallura, nuk janë të lidhura organikisht me fjalinë së cilës i referohen.

Fjalitë e ndërkallura shprehin kuptime modale dhe emocionale.

Fjalitë e ndërkallura kanë rend të lirë: ato dalin në fillim, në mes e në fund fjalisë së cilës i shtohen.

Fjalitë e ndërkallura mund të dalin edhe jashtë kufijve të fjalisë së cilës i referohen, ashtu si fjalitë e ndërmjetme.


Fjalitë e ndërkallura mund të ndahen nga pjesa tjetër me kllapa ose me vizë pushimi.

Të mbajmë mend!

Fjali të ndërkallura quhen ato fjali që përmbajnë të dhëna të ndryshme plotësuese për një fjali a fjalë të porsathënë dhe që shqiptohen me intonacion të ndërkalljes.

Mësuesi/ja së bashku me nxënësit me *Diagrame Veni* paraqesin të përbashkëtat dhe ndryshimet mes fjalive të ndërmjetme dhe fjalive të ndërkallura.

- Kanë rend të lirë.
- Nuk mund të dalin jashtë kufijve të fjalisë së cilës i referohen.



- Nuk shprehin kuptime modale.
- Mund të dalin edhe jashtë kufijve të fjalisë cilës i referohen.

- Nuk janë të lidhura organikisht me fjalinë së cilës i referohen.
- Mund t'i përkasin si fjalisë në tërësi, ashtu edhe gjymtyrëve të veçanta.
- Mund të bashkohen me fjali të tjera pa mjete ose me mjete lidhëse.
-

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Mësuesi paraqet (me video-projektor) një tabelë me fjali të ndërkallura dhe tiparet e tyre dhe u kërkon nxënësve të dallojnë *Tipin e fjalisë* sipas shembullit.

Fjali të ndërkallura	Tipare të përgjithshme	Shembuj
Pa lidhëza	Japin të dhëna plotësuese për dikë dhe veprimtarinë e tij, për rrethanat në të cilat flitet, si dhe të dhëna të ndryshme sqaruese apo saktësuese për atë fjali ku shfaqen.	<i>Këtë herë (se mos vetëm kësaj here...), kanë kaluar çdo cak. Kur e humbte toruan (kjo nuk ndodhte aq rrallë), s'flitej me të.</i>
	Ndërtohen kryesisht me lidhëza bashkërenditëse: <i>dhe, edhe, e, por</i> . Me anë të tyre jepet ndonjë saktësim, sqarim lidhur me kontekstin ku dalin, ose për ndonjë fjali të përmendur më parë.	<i>Ata që riatdhesohen (dhe, për hir të së vërtetës, ka shumë të tillë), nuk e kanë të lehtë t'ia fillojnë nga e para.</i>
	Përmbajnë kryesisht të dhëna që zbulojnë rrethana për kohën, shkakun, qëllimin ose të dhëna me karakter krahasimi, kushti a lejimi rreth kontekstit ku shfaqen. Për nga forma janë të ngjashme me fjalitë e varura përkatëse, por dallohen prej tyre nga një pavarësi më e madhe sintaksore-intonacionore.	<i>Si t'ua bëjmë halleve të tjera, pa pemë mbjellim (kaq sa mund të bëjmë). I nxirë nga inati (sepse këtë gjë nuk e priste), e ngrinte zërin pa e kontrolluar dot veten.</i>
	Japin të dhëna të hollësishme plotësuese, bëjnë sqarime të ndryshme, përshkrime, njoftime etj. Zakonisht janë fjali të gjata dhe fillojnë me shkronjë të madhe dhe mbyllen me shenja pikësimi brenda kllapës.	<i>Atë natë binte shi. (Sa për dijeni, netët me shi nuk janë të rralla këtyre anëve.)</i>

Punë në grup


Nxënësit/et në grupe dyshe dallojnë fjalitë e ndërkallura dhe vendosin shenjat përkatëse të pikësimit. (*Usht. 4, fq.165.*)

Të tjerët dhe këta nuk ishin pak nuk u shprehën as andej as këndej.
Pasi e pastroi shtëpinë këtë ia kishte lënë porosi e ëma u vesh e doli.
Kur dilte kjo ndodhte jo rrallë kohët e fundit na njoftonte kur do të kthehej.
Tani e dimë si qëndron puna eh sa mirë e dimë.
Të nesërmen më duket se qëlloi e diel shtypi e përcolli dhe e komentoj këtë lajm pa ndërprerje.

Në mënyrë të pavarur nxënësit punojnë ushtrimet 2, 3 faqe 165.

Pjesa e dytë e orës (45 minuta)**Veprimtari paraprake: Stuhi mendimi**

Me teknikën *Stuhi mendimi* mësuesi/ja u kërkon nxënësve/eve të shprehin përse përdoret presja dhe rastet e përdorimit në fjali.



Përdoret në gjuhën e shkruar për të ndarë ose veçuar fjalë a grupe fjalësh të një fjalie ose pjesë të një fjalie të përbërë.

Ndërtimi i njohurive të reja:

Mësuesi/ja paraqet (me video-projektor) një tabelë me fjalë duke treguar përdorimin ose jo të presjes dhe llojin e fjalës së nënrenditur.

Rregulla për përdorimin e presjes të fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditura

Lloji i fjalës së nënrenditur	përdorimi ose jo i presjes	Shembuj fjalish
	Ndahen me presje gjithë fjalitë e varura (me ose pa lidhëza) që ndodhen para fjalës drejtuese.	<i>Sa të rrosh, do të mësosh. Që është i huaj, duket.</i>
kryefjalore dhe kundrinore	Nuk ndahen me presje kur lidhen me anë të lidhëzave: <i>që, se, sikur</i> ose pa lidhëza.	<i>Duket që është i huaj. Na u desh të prisnim. Nuk e di ku shkoi.</i>
përcaktore shtuese	Ndahen me presje pasi nuk janë të lidhura ngushtë me paraprijësin e tyre.	<i>Arbri, që, zakonisht, s'pushonte së foluri, tani s'po ndihej.</i>
përcaktore kufizuese	Nuk ndahen me presje, si kur lidhen me përemra lidhorë, ashtu dhe me ndajfolje lidhore, pasi janë të lidhura ngushtë me paraprijësin e tyre.	<i>Të lajmërohen edhe ata që mungojnë sot.</i>
vendore	Nuk ndahen me presje kur plotësojnë kallëzuesin e fjalës drejtuese. Ndahen me presje ato që saktësojnë një rrethanor vendi.	<i>Nuk korret ku s'ke mbjellë. Doli jashtë, ku e priste një veturë e zezë.</i>
kohore	Nuk ndahen me presje kur plotësojnë kallëzuesin e fjalës drejtuese. Ndahen me presje ato fjalë kohore që saktësojnë një rrethanor kohe.	<i>E pritëm gjersa u errësua. U kthye vonë, pasi ra nata.</i>
mënyrore	Ndahen me presje kur nuk lidhen ngushtë me fjalinë drejtuese dhe nuk vijnë fill pas kallëzuesit. Nuk ndahen me presje kur lidhen ngushtë me kallëzuesin e fjalës drejtuese dhe vijnë fill pas tij.	<i>Rrinte diku në një qoshe, si të ishte i zënë në faj. Bëj si të thashë.</i>
qëllimore	Nuk ndahen me presje kur lidhen ngushtë me fjalinë drejtuese dhe saktësojnë kallëzuesin e saj. Ndahen me presje kur nuk lidhen ngushtë me fjalinë drejtuese dhe nuk vijnë fill pas kallëzuesit të saj. Nuk ndahen me presje kur lidhen pa lidhëza me fjalinë drejtuese dhe vijnë fill pas kallëzuesit të saj.	<i>Mbulohu që të mos ftohesh. E ujiste lulen çdo ditë, që të mos thahej. Vrapoi të kapte trenin.</i>
shkakore	Ndahen me presje kur lidhen me anë të lidhëzave: <i>se, sepse, meqenëse, për shkak se, ngaqë, ngase</i> etj. Nuk ndahen me presje kur vijnë fill pas kallëzuesit.	<i>E humbëm trenin, sepse kishte shumë trafik. Gëzohem që jeni mirë.</i>
rrjedhimore	Ndahen me presje kur kanë lidhje të dobët me fjalinë drejtuese. Nuk ndahen me presje kur plotësojnë foljen e fjalës kryesore.	<i>Ishte zemëruar shumë, prandaj nuk fliste fare. E përplasi derën sa u tundën xhamat.</i>
krahasore	Përgjithësisht ndahen me presje.	<i>Nuk është aq e vështirë, sa ç'duket.</i>
kushtore	Ndahen me presje kur nuk lidhen ngushtë me fjalinë drejtuese.	<i>Nuk do të ndodhte e gjithë kjo, po të ishte këtu.</i>

	Nuk ndahen me presje kur janë të lidhura shumë ngushtë me fjalinë drejtuese.	<i>Ne jemi mirë vetëm po të jesh mirë ti.</i>
lejore	Përgjithësisht ndahen me presje.	<i>Nuk hoqëm dorë, ndonëse hasëm shumë vështirësi.</i>
Në mes të fjalisë drejtuese	Përgjithësisht, vihet midis presjesh fjalia e varur që hyn në mes të fjalisë drejtuese. Për fjalitë përcaktore kufizuese presja vihet pas tyre.	<i>Ai, që të mos ndihej, ecte majë gishtave. Ai që doli, është Arbri.</i>

Rregulla për përdorimin e presjes te fjalitë e ndërmjetme dhe të ndërkallura

Llojet e fjalisë	Pikësimi	Shembuj
Fjalitë e ndërmjetme	Ndahen rregullisht me presje nga fjalia ose gjymtyra së cilës i referohen. Vihen midis dy presjesh kur janë në mes të fjalisë ku shfaqen.	Ne nuk e dinim, <i>të them të drejtën</i> . <i>Të them të drejtën</i> , ne nuk e dinim. Ne, <i>të them të drejtën</i> , nuk e dinim.
Fjalitë e ndërkallura	a) Ndahen nga fjalitë, në të cilat shfaqen, me vizë pushimi intonacionore kur shqiptohen si diçka që, për nga rëndësia, nuk qëndron aq larg nga fjalia së cilës i shtohet. Nuk këshillohet përdorimi i presjeve për këto raste.	Anash parqeve – <i>si zor ta besojë njeriu</i> – ende priten pemë e ngrihen tulla.
	b) Vihen mes kllapave, kur kanë më së shumti karakter shtesor, veçim dhe mëvetësi më të madhe nga teksti, lidhje të dobët kuptimore me fjalinë së cilës i bashkohen etj.	Aso kohe (e mban mend ti?) zgjoheshe me cicërima zogjsh e jo me bori shurdhuese.
	c) Për fjalitë e ndërkallura jashtë kufijve të fjalisë, përdoren vetëm kllapat.	Na pritën mirë. (Të them të drejtën, më mallëngjeu mirësia e tyre).

Punë në grup

Nxënësit/et në grupe dyshe vendosin shenjat e pikësimit dhe thonë rregullën përkatëse në fjalitë e dhëna në ushtrimin 1, faqe 168.

Vlerësimi:

Nxënësit/et vlerësohen për:

- analizimin dhe ndërtimin e fjalive të ndërkallura;
- krahasimin e fjalive të ndërkallura me fjalitë e ndërmjetme;
- përdorimin drejt të presjes në fjalitë e ndërmjetme dhe shenjat e pikësimit në fjalitë e ndërkallura.

Detyrë shtëpie:

– Sillni shembuj fjalish të ndërkallura nga një tekst letrar ose joletrar. (Usht. 5, fq.159.)

PLANIFIKIMI ORËS MËSIMORE 5, 6


Fusha: Gjuha e komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: VI	Klasa: XII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Leksikologji Ora I Tema mësimore: Përsëritje për drejtshkrimin Ora II Tema mësimore: Punë me projekt. “Manuali mësimor i maturantit”		Situata e të nxënit: - F. Konica “Vepra 1”; - R. Dibra “Stina e Ujikut”; - K. Blushi “Më shiko në sy”.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore 1: Nxënësi/ja: - përdor drejt shenjat e pikësimit në fjalitë e ndërkallura; - përdor drejt presjen të fjalitë e ndërmjetme dhe shenjat e pikësimit në fjalitë e ndërkallura. Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore II: Nxënësi/ja: - realizon një manual ku paraqiten në mënyrë të përmbledhur njohuritë themelore të marra në lëndën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë, të marra gjatë tre viteve të gjimnazit; - menaxhon punën për realizimin e këtij manuali mësimor; - kurorëzon aftësitë vetjake në një produkt pune, i cili do t'i shërbejë përgatitjes për maturën shtetërore.		Fjalët kyçe: - ligjërime të thjeshta; ligjërime bisedore; ligjërime librorë; tipare.	
Burimet: - tabelë, video-projektor, fragmente tekstesh letrare, Gramatika e gjuhës shqipe II, Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - TIK.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Stuhi mendimi, Pemë mendimi, Diagrame Veni, Punë e pavarur/ në grup.

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT**Pjesa e parë e orës (45 minuta)****Veprimtari paraprake: Diagrame Veni**

Mësuesi/ja së bashku me nxënësit/et kujtojnë rregullat për përdorimin e presjes te fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditura, rregullat për përdorimin e presjes te fjalitë e ndërmjetme dhe të ndërkallura, si dhe shenjat e pikësimit te fjalitë e ndërkallura.

**Punë në grupe dyshe**

U shpërndahen nxënësve/eve disa tekste letrare, nga ku duhet të dallojnë shenjat e pikësimit në fjalitë e ndërkallura dhe presjen te fjalitë e ndërmjetme dhe të ndërkallura.

ANËS LIQENIT

Nata po afrohet. Drita e ditës tretet dalngadalë, e, mbi tjegullat e shtëpive, mbi dërrasat e rrugëve, mbi fletët e pemëve, mbi trupat e epër të çupave, që shkojnë, një ngjyrë manushaqeje – një ngjyrë gushëpëllumbi, si thonë në ca male tona – shtrihet e i mbështjell. Mbasandaj, pak nga pak manushaqet shfletohen, ngjan. Hijet bëhen më të dendura, më të zeza. Njëri pas tjetrit, yjtë shpojnë qiellin e pikëlojnë dritë. Nata u afrua. Nata erdhi.

E kur afrohen nata, kur vjen nata, më pëlqen të vete të rri anës liqenit. S'është liqeni i Ohrit, me ujëra të kulluara si të një rrëkeje, si liqeni i Janinës, që shkëlqen si një fushë e shtruar me pasqyra, si liqeni i Shkodrës, det i vogël, i rrahur tej-këtej nga lundra të motshme sa Shkodra e në anë të cilit gjallojnë malësorë të rreptë. Është një liqen nuk m'ë madh se një kopsht, në mes të një pylli të punuar, liqen i ndryrë e i bukur, i ndyrë me ujë të qelbët, i bukur se pemët që e rrethojnë varin degët e tyre gjer mbi faqe të tij, edhe mbi faqe të tij hëna ndrit e lot. Në pushim të natës bretkosat këndojnë. Herë-herë një peshk, e një tjetër, e një tjetër, shumë peshq tingëllojnë ujën. Uji përsëri pushon e fle. Po një erë e ngadaltë (oh, shumë e ngadaltë!) unjet mbi liqen e zhbravit faqen.

(Faik Konica, *Vepra letrare I*, f. 88)

REFERATI

Profesori i mirënjohur, mbajtës i shumë artikujve e gradave shkencore, anëtar nderi i dhjetë akademive më të përmendura të botës, është ftuar të referojë në një konferencë ndërkombëtare që ka për temë ardhmërinë e shoqërisë njerëzore. Gjatë gjithë asaj jave në të cilën profesori i nderuar u përgatit për referim, pati një status të mrekullueshëm fizik e shpirtëror (ose shpirtëror e fizik), harmoni të shkëlqyer me bashkëshorten, mirëkuptim të plotë me fëmijët dhe një rritje të ndjeshme të të ardhurave personale e familjare. Në rrethana të tilla, në referatin e profesorit të nderuar, e ardhmja e shoqërisë njerëzore paraqitej tepër optimiste dhe me perspektivë.

Një ditë para se të dorëzonte referatin, profesori i nderuar ndjeu dobësi të përgjithshme fizike e shpirtërore (ose shpirtërore e fizike), nga burime të sigurta mësoi se gruaja e tradhtonte prej kohësh me asistentin e tij, njëri prej fëmijëve e braktisi shtëpinë për shkaqe krejt absurde, ndërsa të ardhurat personale e familjare pësuan një rënie të papritur.

Në rrethana të tilla, profesori e grisi referatin e parë që iu duk krejt i stisur e aspak realist, dhe brenda po asaj dite hartoi një tjetër ku e ardhmja e shoqërisë njerëzore paraqitej tepër e zymtë dhe pa perspektivë.

(R. Dibra, *Stina e ujkut*, f. 113)

Edhe darka festive do të kish mbetur deri në fund e tillë.

Ngaqë donte të çlirohej edhe fizikisht nga përndjekja e fytyrave të njohura, fshiu shpejt e shpejt fytyrën me peshqir dhe vendosi të shihte në apartamentin e vajzës përballë. Ndoshta Kimetja ishte aty. Jo rrallë ajo vinte në apartamentin e tyre për ndonjë gatim ose për të çuar psonisjet. Edhe sikur të mos jetë Kimetja, mund të gjej dhëndrin (sikur kish marrë një muaj leje krijuese, më duket), ose Suzin...

Komunikimi me një njeri të gjallë me siguri do ta detyronte të shkëputej nga grindjet, mosmarrëveshjet, keqkuptimet dhe inatet e vjetra, me njerëz që tani ishin bërë pothuaj irealë, pasi ishin shkëputur marrëdhëniet me ta, pra, ringjallja e tyre jo vetëm që ishte pa asnjë vlerë, po i prishte humorin kotekot. Me një fjalë, nuk ia vlente.

Mirë e thashë, nuk ia vlen të vras mendjen kaq shumë.

I ra disa herë ziles. Askush.

Ndoshta i tillë do të jetë pensioni: ta ndiesh vazhdimisht veten të ndjekur nga kujtimet. Të mos shpëtosh dot prej tyre, përkundrazi, të bëhesh rob i tyre. T'i biesh ziles në një shtëpi ku s'ka njeri.....

(K. Blushi, *Më shiko në sy*, f. 110.)

Nxënësit/et në grupe dyshe në fragmentet e dhëna dallojnë shenjat e pikësimit në fjalitë e ndërkallura dhe presjen të fjalitë e ndërmjetme dhe të ndërkallura.

Ata/ato specifikojnë rastet e përdorimit të shenjave të pikësimit dhe thonë rregullën përkatëse.

Material ndihmës për këtë temë mësimore për mësuesit/et.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe II*, Tiranë, 1997, f. 658.

Shenjat e pikësimit në fjalitë e ndërkallura

Kllapat ndryshe nga **vizat e pushimit** janë shenja që nënvizojnë më shumë karakterin shtesor, e ndërkallur, veçimin më të madh nga teksti rrethues mëvetësinë më të madhe, lidhjen më të dobët kuptimore të fjalisë.

Periudhat e ndërkallura të ndërlikuara ndahen zakonisht me kllapa, sepse kllapat japin mundësi që të ndërkallurat të dallohen më qartë në shkrim. Vetëm me kllapa ndahen të ndërkallurat jashtë kufijve të fjalive të tjera.

Fjalitë e ndërkallura komentuese ndahen rregullisht me vizat e pushimit.

Presja në fjalitë e ndërmjetme

Fjalja e ndërmjetme, kur është në mes të fjalisë, vihet midis dy presjeve, kur është e paravendosur ose e prapavendosur, ndahet rregullisht me presje nga fjalja ose gjymtyrës së cilës i referohet.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2002, f. 96.

Shenjat e pikësimit në fjalitë e ndërkallura

- Kur **fjala** a **fjalja e ndërkallur** ndodhet në fund të fjalisë a të periudhës, shenja e pikësimit që i takon fjalisë a periudhës, vihet pas kllapës:

Gjenerali, si zuri vend mirë, ngaqë s'kish ç'të bënte, hapi fletoren. Fleta e parë mungonte (në shumicën e ditarëve që kishin gjetur, mungonin gjithmonë fletët e para).

- Kur **fjalja e ndërkallur** në kllapa është pyetëse ose thirrmore, në fund të saj, vihet shenja përkatëse e pikësimit, pikëpyetja ose pikëçuditja; nëse kjo lloj fjalie është në fund, pas kllapës vendoset pika:

Nga ky çast (*a i kishte mbushur 17 vjeçët vallë?*) tek ai mbiu fara e tolerancës.

Ai pohon me këmbëngulje që natën e kaluar (*e pabesueshme!*) një objekt i madh i shndritshëm u ul në kopshtin e tij.

Presja te fjalët a togjet e fjalëve të ndërmjetme

Sidoqoftë, ty të shkon më shumë fjala.

Madje, ishin të bindur për këtë që po bënin.

Unë, *për veten time*, ja ku po jua them copë se s'do të kisha guxim as t'i dilja në sy!

Shih më gjerë, f. 48, 73

Pjesa e dytë e orës (45 minuta)

Punë me projekt: Realizimi i një manuali

Partnerët:

- nxënës/e të grupeve bashkëpunuese;
- mësues/e të gjuhës dhe të letërsisë;
- punonjës të arkivave, bibliotekave, video-fonotekave të ndryshme.

Fazat e projektit

Faza I

Prezantimi i projektit nga mësuesi/ja: synimi, qëllimet etj.

Ndarja e punës për secilin grup.

Përcaktimi i anëtareve për secilin grup.

Caktimi i afateve për kontrollin e ecures së punës.

Faza II

Vëzhgimi i punës së kryer.

Sugjerime, vërejtje ndihmëse.

Përzgjedhja e materialeve të vlefshme për manualin.

Udhëzime për përgatitjen e *slide*-ve (programi *PowerPoint*), të cilat do të jenë pjesë e manualit

Faza III dhe Faza IV

Prezantimi i manualit mësimor sipas grupeve.

Vlerësimi i nxënësve/eve nga vetë nxënësit/et dhe mësuesi/ja.

Shënim: Këtu janë shtjelluar të tria fazat e projektit, por ato do të realizohen sipas planifikimit vjetor.

Veprimtaritë kryesore të projektit:

- Realizimi i projektit lëndor sipas këndvështrimit individual.

- Përbushja e objektivave të projektit me përpikëri.
- Ndarja e punës mes anëtarëve të grupit.
- Kërkimi i literaturës.
- Integrimi i njohurive në disa fusha të nxëni, si: gjuhë shqipe, letërsi, informatikë etj.
- Menaxhimi dhe prezantimi i projektit, duke reflektuar kompetencat e fituara nga të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit, të shkruarit dhe të vëzhguarit.

Nxënësi/ja do të hulumtojë në:

- tekstet shkollore, materiale të ndryshme informuese, vepra letrare, artikuj të ndryshëm vlerësues për letërsinë dhe gjuhën etj. për të realizuar përmbledhjet e njohurive sipas kompetencave kyçe dhe atyre të fushës, në përputhje me programin e maturës shtetërore.

Njohuritë e përfutuara prej materialeve do të ndërthurin:

- teknika të shkrimit dhe karakteristikat strukturore, gjuhësore dhe stilistike të teksteve përshkruese, rrëfyese, argumentuese, udhëzuese, informuese-paraqitëse.
- përvetësim të rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit;
- morfologji dhe fjalëformim;
- sintaksë;
- leksikologji;
- drejtshkrim dhe pikësim;
- shkrimin e një eseje argumentuese, përshkruese, rrëfyese, informative-shpjeguese, tekstin udhëzues;
- listën e veprave nga do të përzgjidhet fragmenti i tekstit letrar në testimin kombëtar, sipas programit orientues për përgatitjen e provimit kombëtar të maturës shtetërore për gjimnazin.

Vlerësimi:

Nxënësit/et vlerësohen për:

- përdorimin e drejtë të shenjave të pikësimit në fjalitë e ndërkallura;
- përdorimin e drejtë të presjes të fjalitë e ndërmjetme dhe shenjat e pikësimit në fjalitë e ndërkallura.

Detyrë shtëpie:

- Gjeni në tekste letrare raste të përdorimit të presjes të fjalitë e ndërmjetme dhe të shenjave të pikësimit të fjalitë e ndërkallura.

TESTOJMË NJOHURITË GRAMATIKORE

Tremujori III

Qarkoni alternativën e saktë.

(Për përdorimin e presjes tek fjalitë e ndërmjetme)

1. a. Me sa më kujtohet ti, ke qenë me ta atë ditë.
b. Me sa më kujtohet, ti ke qenë me ta atë ditë.
2. a. U mor vesh, në këtë punë ne fitojmë ai humbet.
b. U mor vesh, në këtë punë ne fitojmë, ai humbet.
3. a. Mua më vinte keq, ç'është e drejta.
b. Mua, më vinte keq ç'është e drejta.
4. a. Madje, ishin të bindur për këtë që po bënin.
b. Madje ishin të bindur, për këtë që po bënin.
5. a. Sidoqoftë ty, të shkon më shumë fjala.
b. Sidoqoftë, ty të shkon më shumë fjala.
6. a. Unë, për veten time, ja ku po jua them copë se s'do të kisha guxim as t'i dilja në sy!
b. Unë për veten time, ja ku po jua them copë se s'do të kisha guxim as t'i dilja në sy!
7. a. Me thënë të drejtën, kjo punë qëndron ndryshe.
b. Me thënë të drejtën kjo punë, qëndron ndryshe.
8. a. Unë të them të drejtën, kisha dëshirë të rrija me të.
b. Unë, të them të drejtën, kisha dëshirë të rrija me të.
9. a. Të them të vërtetën edhe unë lëkundem.
b. Të them të vërtetën, edhe unë lëkundem.
10. a. Dhe kishte disa arsye, sipas mendjes sime, që të veproje kështu.
b. Dhe kishte disa arsye sipas mendjes sime, që të veproje kështu.

Qarkoni alternativën e saktë.

(Për përdorimin e shenjave të pikësimit tek fjalitë e ndërkallura)

1. a. Nga ky çast (*a i kishte mbushur 17 vjeçët vallë*) tek ai mbiu fara e tolerancës.
b. Nga ky çast (*a i kishte mbushur 17 vjeçët vallë?*) tek ai mbiu fara e tolerancës.
2. a. Ai pohon me këmbëngulje që natën e kaluar (*e pabesueshme!*) një objekt i madh i shndritshëm u ul në kopshtin e tij.
b. Ai pohon me këmbëngulje që natën e kaluar (*e pabesueshme*) një objekt i madh i shndritshëm u ul në kopshtin e tij.

3. a. Gjenerali, si zuri vend mirë, ngaqë s'kish ç'të bënte, hapi fletoren. Fleta e parë mungonte (në shumicën e ditarëve që kishin gjetur, mungonin gjithmonë fletët e para.)
b. Gjenerali, si zuri vend mirë, ngaqë s'kish ç'të bënte, hapi fletoren. Fleta e parë mungonte (në shumicën e ditarëve që kishin gjetur, mungonin gjithmonë fletët e para).
4. a. Po një erë e ngadaltë (oh, shumë e ngadaltë!) unjet mbi liqen e zhubravit faqen.
b. Po një erë e ngadaltë (oh, shumë e ngadaltë) unjet mbi liqen e zhubravit faqen.
5. a. Më priti me përzemërsi (sidoqoftë pa buzëqeshje të tepruara) dhe më ftoi të hyja.
b. Më priti me përzemërsi (sidoqoftë pa buzëqeshje të tepruara), dhe më ftoi të hyja.
6. a. Ai më tha ato gjëra, që sonte (*mos vallë vetëm sonte!*) do të më lënë pa gjumë.
b. Ai më tha ato gjëra, që sonte (*mos vallë vetëm sonte?*) do të më lënë pa gjumë.
7. a. Një mbrëmje, – ishte më të rënë të diellit, – unë kisha dalë te dera e kasolles...
b. Një mbrëmje – ishte më të rënë të diellit – unë kisha dalë te dera e kasolles...
8. a. Edhe kur dilte jashtë, – kjo ndodhte rrallë, nuk e ndiente veten as në dhe, as në qiell.
b. Edhe kur dilte jashtë, – kjo ndodhte rrallë, – nuk e ndiente veten as në dhe, as në qiell.
9. a. Arti, – dhe këtë të vërtetë e dinë të gjithë, – në të gjitha format e shfaqjes së tij, as që mund të ekzistojë jashtë jetës.
b. Arti – dhe këtë të vërtetë e dinë të gjithë – në të gjitha format e shfaqjes së tij, as që mund të ekzistojë jashtë jetës.
10. a. Kam edhe unë mjetet e mia për të njohur njerëzit (aq sa mund të njihen).
b. Kam edhe unë mjetet e mia, për të njohur njerëzit, (aq sa mund të njihen).

Qarkoni përgjigjen e saktë me Po/Jo.

- | | | |
|--|----|----|
| 1. Të gjitha fjalitë që futen ndërmjet një fjalie tjetër, quhen fjali të ndërmjetme. | Po | Jo |
| 2. Fjalitë e ndërmjetme prihen gjithnjë nga lidhëzat. | Po | Jo |
| 3. Fjalitë e ndërmjetme nuk hyjnë në lidhje gramatikore me fjalinë në të cilën shfaqen. | Po | Jo |
| 4. Fjalitë e ndërmjetme mund të përdoren në fjali të thjeshta dhe të përbëra. | Po | Jo |
| 5. Fjalitë e ndërmjetme mund të qëndrojnë vetëm në mes të fjalive të tjera. | Po | Jo |
| 6. Si fjalitë e ndërmjetme, ashtu dhe ato të ndërkallura, nuk janë të lidhura organikisht me fjalinë së cilës i referohen. | Po | Jo |
| 7. Fjalitë e ndërkallura shprehin vetëm kuptime modale dhe emocionale. | Po | Jo |
| 8. Fjalitë e ndërkallura kanë rend të lirë: ato dalin në fillim, në mes e në fund fjalisë së cilës i shtohen. | Po | Jo |
| 9. Fjalitë e ndërkallura mund të dalin edhe jashtë kufijve të fjalisë së cilës i referohen, ashtu si fjalitë e ndërmjetme. | Po | Jo |
| 10. Fjalitë e ndërkallura mund të ndahen nga pjesa tjetër me kllapa ose me vizë pushimi. | Po | Jo |

- | | | |
|---|----|----|
| 11. Kur fjala a fjalia e ndërkallur ndodhet në fund të fjalisë a të periudhës, shenja e pikësimit që i takon fjalisë a periudhës, vihet pas kllapës. | Po | Jo |
| 12. Kur fjalia e ndërkallur në kllapa është pyetëse ose thirrmore, në fund të saj, vendoset pika. | Po | Jo |
| 13. Kur fjalia e ndërkallur në kllapa është pyetëse ose thirrmore, në fund të saj, vihet shenja përkatëse e pikësimit, pikëpyetja ose pikëçuditja; nëse kjo lloj fjalie është në fund, pas kllapës vendoset pika. | Po | Jo |
| 14. Kur fjala a fjalia e ndërkallur ndodhet në fund të fjalisë a të periudhës, shenja e pikësimit që i takon fjalisë a periudhës, vihet para kllapës. | Po | Jo |
| 15. Fjalitë e ndërkallura komentuese ndahen rregullisht me vizat e pushimit. | Po | Jo |
| 16. Fjalia e ndërmjetme, kur është në mes të fjalisë, vihet midis dy presjeve. | Po | Jo |
| 17. Fjalia e ndërmjetme, kur është e paravendosur ose e prapavendosur, ndahet rregullisht me presje nga fjalia ose gjymtyrës së cilës i referohet. | Po | Jo |
| 18. Fjalitë e ndërmjetme të të njëjtit tip kuptimor mund të jenë pa mjete lidhëse ose me mjete lidhëse. | Po | Jo |
| 19. Fjalitë e ndërkallura përdoren mjaft si në ligjërimin e folur ashtu edhe në ligjërimin e shkruar. | Po | Jo |
| 20. Të dhënat plotësuese të fjalive të ndërkallura kanë natyrë të njëjtë. | Po | Jo |
| 21. Vendi i fjalive të ndërkallura është i kushtëzuar nga kuptimi e ndërtimi. | Po | Jo |
| 22. Të ndërkallura nuk mund të dalin ndërtimet me trajta foljore të pashtjelluara, funksionalisht sinonimike me fjalitë e ndërkallura pa lidhëza. | Po | Jo |

❖ Plotësoni.

- Ndërtoni fjali të thjeshta apo të përbëra të cilat të dalin fjali të ndërmjetme:
 - të shkallës së vërtetësisë së një fakti _____
 - të vlerësimit emocional _____
 - të burimit të kuptimit _____
 - të karakterit të thënies _____
 - të tërheqjes së vëmendjes _____
 - të lidhjes së kuptimeve _____
- Ndërtoni nga një shembull me fjali të ndërkallura:
 - pa lidhëza _____
 - me lidhëza bashkërenditëse _____
 - me lidhëza nënrenditëse _____
 - me fjalë lidhëse _____
 - që dalin jashtë kufijve të fjalisë _____
- Përdorni foljen *di*, *flas*, *shoh*, *jam* si pjesë përbërëse të fjalive të ndërmjetme.

di _____

flas _____

shoh _____

jam _____

❖ Qarkoni përgjigjen e saktë.

1. Në fjalinë: “Në krijime të kësaj natyre bëjnë vend simbolet: realiteti konceptohet në formë simbolike – duke kaluar gjer në simbolizëm – kurse trajtimi i motiveve i nënshtrohet konvencionalitetit simbolik.”, pjesa e nënvizuar është:

a. fjali e ndërmjetme;

b. fjali e ndërkallur.

2. Në fjalinë: “Më priti me përzemërsi (sidoqoftë pa buzëqeshje të tepruara) dhe më ftoi të hyja.”, pjesa e nënvizuar është:

a. fjali e ndërmjetme;

b. fjali e ndërkallur.

3. Në fjalinë: “Kontrollova postën (asgjë) dhe u futa brenda pa e zgjatur.”, pjesa e nënvizuar është:

a. fjali e ndërmjetme;

b. fjali e ndërkallur.

4. Në fjalinë: “Megjithëse e lexova dy herë atë letër (dhe leximi i dytë ishte po aq i kujdesshëm sa i pari) disa pika i kam ende të errëta.”, pjesa e nënvizuar është:

a. fjali e ndërmjetme;

b. fjali e ndërkallur.

5. Në fjalinë: “Nga ky çast (a i kishte mbushur 17 vjeçët vallë?) tek ai mbiu fara e tolerancës.”, pjesa e nënvizuar është:

a. fjali e ndërmjetme;

b. fjali e ndërkallur.

6. Në fjalinë: “Në atë letër – që ishte e para pas largimit të tij nga Lezha – ai shkruante se ishte fare mirë.”, pjesa e nënvizuar është:

a. fjali e ndërmjetme;

b. fjali e ndërkallur.